



## REKURS

### NË GJYKATËN E LARTË TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**REKURSUES:** Partia Demokratike e Shqipërisë e përfaqësuar nga Enkelejd Alibeaj, i përfaqësuar në gjykim në apel nga Av.Indrit Sefa dhe Av.Rezart Kthupi sipas prokurës së posaçme numër 772 rep, numër 376 kol, datë 25.02.2023.

**KUNDËR:** Partia Demokratike e Shqipërisë e përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit

**OBJEKTI I REKURISIT:** Prishjen e vendimit numër 3, datë 23.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,  
Prishjen e vendimit numër 723, datë 11.06.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë  
Pushimin e gjykimit.  
Pezullimin e ekzekutimit të vendimit numër 3, datë 23.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 472, e vijues të Kodit të Procedurës Civile.

Të nderuar Gjyqtarë,

#### I. RRETHANAT DHE KRONOLOGJIA PROCEDURIALE-GJYQËSORE E ÇËSHTJES

- Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 15 dhjetor 2021, është depozituar një kërkesë, me kërkuar subjektin politik, Partia Demokratike e Shqipërisë. Si përfaqësues i këtij subjekti politik (personi juridik) është shfaqur i ashtuquajti "Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit" (KPR), një grupim prej 29 individësh. Kërkesa në pjesën fundore të saj shfaq si kërkuar "Komisionin e Përkohshëm të Rithemelimit". Kërkesa është nënshkruar nga "përfaqësuesi me autorizim i KPR". Autorizimi paraqitet në formën e një dokumenti të thjeshtë (shkresë të thjeshtë, pra jo prokurë) në të cilën secili nga këta 29 individë kanë nënshkruar personalisht dhe individualisht, për të autorizuar nënshkruar e kërkesës. Ky akt, është një shkresë e thjeshtë, pra jo në formën e prokurës (sipas kërkesave të Kodit Civil), e cila duhet të përpilohet dhe vërtetohet nga një noter publik. Nga këqyrja e kërkesës rezulton se kërkesa është "vulosur" sikurse edhe autorizimi i pretenduar, me një vulë e cila nuk është vula zyrtare e personit juridik PDSH.
- Objekt i kërkesës ishte: "Depozitim ndryshimesh staturore dhe vendimmarrje të Kuvendit Kombëtar". Çështja është shortuar për shqyrtim tek gjyqtari Agron Zhukri.
- I vënë në dijeni se në gjykatë po kërkohej të instauruhej një proces gjyqësor, në emër të personit juridik PDSH, me kërkesë të paraqitur nga një grupim individësh apo subjekt i panjohur në aspektin statutor, më datë 22.12.2021 Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha me shkresën numër 168/1 prot, i është drejtuar Z. Agron Zhukri në cilësinë e gjyqtarit të caktuar për shqyrtimin e çështjes, me kërkesë për pushimin e gjykimit çështjes, bazuar në nenin 90



paragafi 2 dhe 154/a të KPrC, duke arsyetuar se sipas ligjit dhe statutit të PDSH, askush tjetër nuk mund të përfaqësojë në këtë gjykim civil të drejtat e personit juridik PDSH, përveçse kryetarit të saj, e për këtë shkak asaj kërkesë i mungonte legjitimiteti formalo-juridik i “palës kërkuese” e gjithashtu dhe interesi i ligjshëm i Partisë Demokratike në një çështje të tillë në gjykim.

4. Me datë 23.12.2021 Gjyqtari Zhukri i drejtohet “Zyrës së OJF” me kërkesën për vënien në dispozicion të dosjes së regjistrimit të subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë.
5. Me datë 24.02.2022 Gjyqtari Zhukri me vendimin numër 1346/222 akti, datë 24.02.2022 me titull “Vendim për pezullimin e gjykimit” ka vendosur *“Pezullimin e gjykimit të çështjes civile numër 222 akti, datë 15.12.2021 regj me palë: Kërkuës: Partia Demokratike e Shqipërisë; Objekt: Depozitim ndryshimesh statute dhe vendimmarrje të Kuvendit Kombëtar; Bazë ligjore: Neni 9 e vijues të ligjit 8580, datë 17.02.2000 (i ndryshuar);...”* Në pjesën arsyetuese të këtij vendimi gjyqtari parashtron se: *“...Gjykata për shqyrtimin e kësaj kërkesë, kërkoj tërheqjen e praktikës së dosjes së regjistrimit fillestar të Partia Demokratike, dosja e regjistruar me Urdhrin nr.12 datë 19.12.1990 të Ministrisë së Drejtësisë pranë zyrës së OJF-ve. Me shkresën datë 28.12.2021 është kthyer përgjigje se dosja e regjistrimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë është tërhequr me datë 20.12.2021 nga gjyqtare Blerina Muça. Në këto kushte gjykata nuk mund të vijojë me gjykimin e kësaj kërkesë pa pasur dosjen e regjistrimit të statutit të zhvilluar në muajin Korrik të vitit 2021 të Partisë Demokratike...”*
6. Rreth 20 ditë më pas këtij vendimi, saktësisht më datë 18.03.2022, Gjyqtarja Blerina Muça me vendimin numër 1337/218, datë 18.03.2022 është shprehur me vendim për një kërkesë tjetër, e cila ishte me objekt *“Pasqyrimi i ndryshimeve në statutin e Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe të organeve të reja të zgjedhura në Kuvendin Kombëtar të datës 17.07.2021”* të depozituar nga Kryetari i Partisë Demokratike Lulzim Basha i përfaqësuar me autorizim.
7. Me datë 23.03.2022 përfaqësuesi i KPR, depoziton në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për rifillimin e shqyrtimit gjyqësor të çështjes së pezulluar si dhe 24 prova të tjera ndër të cilat provën 2 (listë e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të PDSH); provën 3 (listë delegatës dërguar nga LDG); provën 4 (listë e delegatëve të FRPD); provën 22 (listë e delegatëve të Kuvendit Kombëtar dërguar nga sekretari i Degës 3 Tiranë); provën 7 (listë me 1404 nënshkrime) provën 19 (filmime të Kuvendit Kombëtar me kohëzgjatje 7.56.56 orë); provën 18 (procesverbal i mbledhjes së Kuvendit Kombëtar); provën 23 (raport teknik për pjesëmarrjen e delegatëve në Kuvendin Kombëtar i shoqëruar me një listë me 4935 emra dhe provën 24 (4552 formularë kërkesë për mbajtjen e Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021). Në këtë kërkesë KPR parashtron se: *“...Në datën 24.02.2022 Gjykata ka vendosur: “Pezullimin e gjykimit të çështjes numër 222 akti, datë 15.12.2021” për shkak të shqyrtimit nga Gjyqtare Blerina Muça të çështjes me objekt “Pasqyrimi i ndryshimeve në statutin e Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe të organeve të reja të zgjedhura në Kuvendin Kombëtar të datës 17.07.2021” dhe pamundësisë së disponimit fizik të dosjes së regjistrimit fillestar të Partisë Demokratike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga organet mediatike jemi vënë në dijeni të faktit se në datë 18.03.2022 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë (gjyqtare Blerina Muça) ka shpallur vendimin në lidhje me kërkesën e mësipërme duke vendosur pranimin e saj. Në këto kushte ka rënë pengesa për të cilën ju vendosët pezullimin e gjykimit...”*

8. Me datë 23.03.2022 Gjyqtari Agron Zhukri me shkresën numër 1346/222 akti, i ridrejtohet “Zyrës së OJF-së” me kërkesën për vënien në dispozicion të dosjes së subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë.
9. Po më datë 23.03.2023 “Zyra e OJF-së” me shkresën pa numër protokolli, në përgjigje të kërkesës numër 1346/222 akti njofton Gjyqtarin Zhukri duke u shprehur se: *“Në përgjigje të shkresës tuaj numër 1346/222 akti, datë 23.12.2022, në të cilën kërkonti vënien në dispozicion të dosjes së Partisë Demokratike të Shqipërisë, regjistruar më urdhër të Ministrit të Drejtësisë numër 12, datë 19.12.1990. Ju bëj me dije se dosjen e regjistrimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë nuk mund t’ua vëmë në dispozicion pasi është tërhequr më datë 20.12.2021 nga gjyqtare Blerina Muça, në momentin që do të dorëzohet dosja nga gjyqtarja do t’ua vëmë në dispozicion. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin”.*
10. Me datë 24.03.2022 përfaqësuesi me autorizim i Partisë Demokratike Indrit Sefa ka depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqsor Tiranë ankimin ndaj vendimit numër 1337/2018, datë 18.03.2022 të Gjyqtarës Blerina Muça me të cilin ishte marrë në shqyrtim kërkesa *“Pasqyrimi i ndryshimeve në statutin e Partisë Demokratike të Shqipërisë dhe të organeve të reja të zgjedhura në Kuvendin Kombëtar të datës 17.07.2021”*
11. Më datë 24.03.2022 përfaqësuesi me autorizim i Partisë Demokratike, Indrit Sefa, i drejtohet më shkresë gjyqtarit Agron Zhukri me 2 kërtime. Së pari me kërkesën për mosvijimin e procesit gjyqsor në fjalë, për shkak të mosmarrjes formë të prerë të vendimit të dhënë për çështjen tjetër të sapogjykuar nga gjyqtarja Blerina Muça që kishte disponuar për regjistrimin e statutit të miratuar në Kuvendin Kombëtar të PDSH, të datës 17 korrik 2021. **Së dyti kjo shkresë përmbante edhe kërkesën për të marrë pjesë si palë në seancën gjyqsore në rast se kjo e fundit do të zhvillohej. Kjo kërkesë bazohej në nenet 193 dhe 390 të KPC, të cilët mundësojnë pjesëmarrjen e personit të interesuar në një gjykim që zhvillohet ndërkohë pa praninë e tij. Në kërkesë është shprehur edhe interesi i ligjshëm për të marrë pjesë në gjykim, me qëllim mbrojtjen e të drejtave të personit juridik PDSH, pasi nga përfundimi i gjyqit ekzistonte rreziku të cënoheshin këto të drejta të këtij personi juridik, të cilat mund t’i përfaqësonte ekskluzivisht vetëm kryetari i partisë dhe askush tjetër.**
12. Më datë 25.03.2021, në ora 10.30 fillon seanca gjyqsore me praninë e palës kërkuese për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur. Gjyqtari nuk thirri si person të interesuar, përfaqësuesin legjitim të PDSH, z.Lulzim Basha, edhe pse ka administruar në dosje kërkesën e tij për të marrë pjesë në gjykim. Në seancën gjyqsore kërkuesi i është përmbajtur pretendimeve të paraqitura në Gjykatë me datë 15.12.2021. Gjykata pasi shqyrton kërkesën, provat dhe bazueshmërinë ligjore të tyre, në ora 11.10 vendos të mbyllë procesin gjyqsor dhe të shpallë vendimin e pranimit të kërkesës (pra ndryshime në statutin e PDSH dhe vendime shkarkimi të organeve drejtuese legjitime të PDSH).
13. Kundër vendimit numër 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë ka ushtruar ankim subjekti (pala) Partia Demokratike e Shqipërisë e përfaqësuar me autorizim nga nënkryetari Enkelejd Alibeaj. Ky ankim është marrë në shqyrtim nga Gjykata e cila me vendimin numër 508, datë 22.04.2022 ka vendosur *“Pranimin ankimit të palës ankuese, Partia Demokratike e Shqipërisë përfaqësuar nga nënkryetari i saj z. Enkelejd Alibeaj, ndaj vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë”.*
14. Kjo dosje i është përcjellë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm e cila me vendimin numër 44, datë 03.03.2023 ka vendosur *“Prishjen e vendimit numër 3, datë*

*25.03.2022 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë, me një tjetër trupë gjyquese”.*

15. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ka ushtruar rekurs subjekti Partia Demokratike e Shqipërisë e përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit. Çështja është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë e cila me vendimin numër 768, datë 27.12.2023 ka vendosur *“Prishjen e vendimit nr. 44, datë 03.03.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim pranë asaj gjykate, me tjetër trup gjyqes”.*
16. Në datën 11.06.2024 Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka vendosur *“Mospranimin e ankimit të ushtruar kundër vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Kundër këtij vendimi mund të bëhet rekurs i veçantë në Gjykatën e Lartë brenda 5(pesë) ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit.”*
17. Me anë të këtyre argumentave që po Ju paraqesim në mënyrë të detajuar qëndrimet e subjektit ankues Partia Demokratike e Shqipërisë mbi vendimin numër 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë dhe vendimit nr.723 datë 11.06.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për të arritur në përfundimin që këto vendime janë marrë si pasojë e zbatimit të gabuar të ligjit procedural e material dhe vlerësimit të gabuar të provave e akteve provuese mbi të cilat bazohen pretendimet e palës kërkuese, që për pasojë diktojnë arritjen në përfundimin se vendimet duhen të prishet dhe çështja duhet të pushohet, siç edhe i kemi kërkuar në ankimin e paraqitur në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë kundër vendimit numër 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë.
18. Duke qenë se kjo çështje gjykohet për herë të dytë në Gjykatë të Lartë, si dhe faktin që Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nuk ka zbatuar udhëzimet dhe orientimet e përcaktuara nga kjo gjykatë në vendimin numër 768, datë 27.12.2023 siç ka urdhëruar në paragrafin 79, fjalia e parë. Këto udhëzime janë detyruese, jo vetëm për ne, por edhe për gjykatën rigjyquese siç parashikon neni 486 i KPC. Duke qenë në këto kushte në shkelje flagrante të detyrimeve ligjore nga Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ne do të kërkojmë që ky rekurs të gjykohet në themel në seancë gjyqësore në Gjykatën e Lartë në zbatim të nenit 482/a të Kodit të Procedurës Civile dhe më konkretisht: *“Gjykata, në dhomë këshillimi, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rast se: a) çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; b) vlerësohet e nevojshme nga Kolegji Civil thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, sipas shkronjave “b” dhe “c” të nenit 472, si dhe paragrafit të dytë të nenit 473/a të këtij Kodi.”*
19. Ne mendojmë që të dy kriteret e përcaktuara qartësisht në nenin 482/a pika 1 të Kodit të procedurës Civile janë të plotësuar në rastin konkret dhe se kjo çështje vjen për shqyrtim për herë të dytë në Gjykatën e Lartë dhe për faktin se Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dështoi të zbatonte udhëzimet dhe orientimet e Gjykatës së Lartë. Një rikthim për rigjykim përsëri në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nuk do të garantonte një zgjidhje përfundimtare dhe definitive të kësaj çështje si dhe nuk do të shërbente për njësimin e praktikës gjyqësore për raste të ngjashme.

## II. FAKTET DHE RRETHANAT MBI THEMELIN E ÇËSHTJES

20. Që të kuptohen drejt, pozicionet proceduriale në gjykimin e shkallës së parë, korrektësia e zbatimit të ligjit procedural, e mbi të gjitha t'iu jepet përgjigje udhëzimeve të vendimit të Gjykatës së Lartë të cilat nuk u morën kurrë në konsideratë nga gjykata e Apelit është e udhës të saktësohen korrektësisht dhe në mënyrë kronologjike të gjitha rrethanat e fakteve, që i paraprinë procesit gjyqësor që zhvilloi Gjykata e Shkallës së Parë. Këto rrethana e fakte iu referohen akteve të organeve dhe forumeve të subjektit politik PDSH (person juridik). Siç thotë edhe Gjykata e Lartë në paragrafët 25 dhe 27, kontrolli gjyqësor që bën gjykata ndaj akteve të një subjekti politik, me qëllim reflektimin e tyre në rregjistrin e partive politike, është një kontroll ligjshmërie, në kuptimin se në ç'masë janë respektuar parashikimet ligjore dhe statutorë në fuqi në kohën e paraqitjes së kërkesës. Gjykimi, pra që do duhej të zhvillohej nga gjykata e shkallës së parë dhe nga gjykata e apelit pas detyrave të lëna në VGJL duhet të ishte pikërisht homologimi i këtyre akteve partiake nëse kanë respektuar ligjin dhe statutin e kohës.
21. Nga aktet e dosjes gjyqësore në shqyrtim pranë këtij trupi gjykues rezulton një kronologji e saktë e fakteve dhe rrethanave.
22. Në datë 13 qershor 2021 sipas parashikimeve të statutit të PDSH, zhvillohen zgjedhjet periodike në PDSH për zgjedhjen e kryetarit e saj. Rezulton se kandidatë në garë ishin Agron Shehaj, Edit Harxhi, Fatbardh Kadilli dhe Lulzim Basha. Nga procesi zgjedhor rezultoi fitues z. Lulzim Basha.
23. Fakti i zgjedhjes së kryetarit të PDSH është pasqyruar në rregjistrin e partive politike, në datë 13 korrik 2021, me vendim nr.10, dhe 809 Regjistri Thmeltar datë 13.07.2021 të gjyqtarit Julian Haxhiu.
24. Në datën 17 korrik 2021, është zhvilluar mbledhja e njërit prej forumeve partiake të PDSH, Kuvendit Kombëtar. Në mbledhjen e këtij forumi u miratuan disa ndryshime në statut dhe zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Kombëtar. Kërkesa për pasqyrimin e këtyre ndryshimeve staturore, në rregjistrin e partive politike, është depozituar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, më 13 dhjetor 2021.
25. Pas zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar (17 korrik 2021), në datë 29 gusht 2021, është zhvilluar mbledhja e këtij të fundit (KK), i cili zgjodhi, sipas statutit, edhe organet e tjera partiake, përkatësisht, kryesinë e partisë, nënkryetarët dhe sekretarin e përgjithshëm.
26. Në vijim edhe të zhvillimeve politike të brendshme në PDSH, që filluan në datë 9 shtator 2021, filloi një lëvizje paralele, e që deklaroi publikisht, synimin e ndryshimeve staturore apo edhe shkarkime/emerime të funksionarëve dhe forumeve drejtuese të partisë, të sapozgjedhura.
27. Në datën 10 Nëntor 2021 një grup anëtarësh të Partisë Demokratike, të paidentifikuar në numër, nëpërmjet medias njoftuan pretendimin se kanë mbledhur një numër nënshkrimesh të anëtarëve të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë, që kërkonin thirrjen e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar të PDSH. Në emër të Kryesisë së Partisë, dhe si autoriteti përgjegjës statutor për organizimin e partisë, Sekretari i Përgjithshëm i Partisë i bëri thirrje këtyre anëtarëve ende të paidentifikuar, që sipas rregullave staturore, kërkesa e tyre, së bashku me nënshkrimet të depozitohet në Partinë Demokratike, me qëllim ndjekjen e procedurës staturore për thirrjen e Kuvendit Kombëtar.

28. Anëtarët e partisë, të paidentifikuar në numër, refuzuan të dorëzonin kërkesën pranë Partisë Demokratike, duke pretenduar se kërkesat ishin depozituar në zyrën e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike z. Edi Paloka. Theksojmë se sipas statutit, organi partiak i cili ka të drejtën dhe detyrimin për të administruar kërkesa të kësaj natyre organizative është Sekretari i Përgjithshëm. Kryetari i Këshillit Kombëtar, si një funksionar partiak nuk kishte të drejtë as t'i administronte e as t'i shqyrtonte kërkesa të kësaj natyre.
29. Më datë 11.10.2021 në ora 11.37 minuta në faqen e portalit Syri.net është publikuar një lajm në të cilin citohet fakti që në njoftimi për thirrjen e Kuvendit Kombëtar është depozituar në zyrën e Kryetarit të Këshillit Kombëtar së bashkur me 4200 formularë.
30. Më datë 11.11.2021 në ora 23.30 në Televizionin Kombëtar Klan, Edicioni i Lajmeve transmetohet një kronikë lidhur me zhvillimin e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike më datë 11.12.2021.
31. Më datë 11.11.2021 Kryetarja e Lidhjes Demokratike të Gruas, Albana Vokshi, i drejtohet me shkresën pa numër protokollit, pa lëndë, z. Edi Paloka, shoqëruar me një listë me 389 emra delegatësh.
32. Më datë 11.11.2021 Kryetari Forumit Rinor të Partisë Demokratike Belind Këlliçi i drejtohet me shkresën numër extra prot., pa lëndë, z. Edi Paloka, shoqëruar me një listë prej 363 delegatësh.
33. Më datë 11.11.2021 Sekretari i Degës së Partisë Demokratike Tiranë 3, me shkresën pa numër prot., me lëndë: "Lista e delegatëve të Kuvendit Kombëtar të PDSH" i dërgon këtij të fundit një listë me delegatë, të panumëruar duke saktësuar se kjo listë disponohet zyrtarisht nëpërmjet aksesit në sistem që nga Kuvendi i mëparshëm i Korrikut 2021.
34. Më datë 12.11.2021, në ora 9.30 në Televizionin Kombëtar Klan, Edicioni i Lajmeve transmetohet një kronikë lidhur me zhvillimin e pritshëm të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike më datë 11.12.2021.
35. Më datë 12.11.2021, Z. Sali Berisha ka publikuar në rrjetin social Facebook një status, me të cilin pretendonte se ishte "njoftim për zhvillimin e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike" më datë 11.12.2021.
36. Më datë 15.11.2021, duke konstatuar, kryerjen e këtyre akteve ekstrastatutore nga grupimi më sipër, (procedura e ndjekur nga pretenduesit e lëvizjes paralele nuk respektonte modalitetet statutore, si në përpilimin e kërkesës, në procedurën dhe afatin e thirrjes së mbledhjes, administrimin e nënshkrimeve, depozitimin e akteve dhe shqyrtimin e kërkesës për thirrje të Kuvendit Kombëtar), si dhe refuzimin sistematik të tyre për të kanalizuar këtë pretendim në hullitë statutore, kryetari i partisë z.Lulzim Basha, vendosi me iniciativë e tij, brenda kompetencës që i njihet statuti, edhe për të akomoduar brenda hullisë statutore një kërkesë të tillë (deri në atë moment thjesht e artikuluar publikisht), të mbledhë ai vetë Kuvendin Kombëtar, duke njoftuar edhe datën e mbledhjes më 18 dhjetor 2021.
37. Më datë 09.12.2021 një grup deputetësh i janë adresuar me shkresë Kryetarit të Partisë Demokratike Z.Lulzim Basha me kërkesën për ushtrimin e funksioneve statutore dhe propozimin e anëtarëve të Komisionit të Drejtimit të Punimeve të Kuvendit Kombëtar.

38. Me këtë shkresë me nr. 150/1 Prot., datë 09.12.2021, marrë në dorëzim nëpërmjet zyrës së protokollit nga z. Edi Paloka, në emër të njoftuesve, është insistuar të thirrej Kuvendi Kombëtar në datë 11 dhjetor 2021. Kryetari i Partisë, pasi ka konstatuar nga kërkesa se vetëm 10 anëtarë të Kuvendit Kombëtar ishin nënshkrues, dhe se ky nuk është numër i mjaftueshëm për thirrjen e Kuvendit Kombëtar, (sepse nuk përbën ¼ e numrit të anëtarëve të Kuvendit), i ka sqaruar se kërkesa e tyre nuk ishte e rregullt dhe e vlefshme për mbledhje të Kuvendit Kombëtar në datë 11 dhjetor, porse megjithatë e kishte marrë ndërkohë vendimin për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike i cili do zhvillohej 10 ditë më pas, pra me datë 18 dhjetor 2021.
39. Pavarësisht të sa më sipër, më datë 11.12.2021 zhvillohet një tubim individësh, i pretenduar si “mbledhje e Kuvendit Kombëtar” të PDSH. Nuk ka një listë zyrtare të delegatëve të “Kuvendit” dhe asnjë autoritet të përcaktuar për hartimin e kësaj liste. Hyrja dhe regjistrimi i delegatëve bëhet nëpërmjet një mandati me QR code për të cilin nuk ka të dhëna se nga cili autoritet dhe as një listë zyrtare të delegatëve ku të bazohet lëshimi i këtyre mandateve.
40. Punimet e “Kuvendit” çelen nga z. Edi Paloka në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Kombëtar. Ky i fundit propozon emërimin nga “Kuvendi” të Komisionit të Drejtimit të punimeve dhe Sekretariatit Teknik. Në dokumentat e administruara nuk gjendet procesverbal numërimi i votave të marra për miratimin e Komisionit dhe Sekretariatit.
41. Komisioni i drejtimit të punimeve caktoi një trupë prej 72 anëtarësh për verifikimin e ligjshmërisë së formularëve të nënshkruar me kërkesën për thirrjen e “Kuvendit Kombëtar”. Kjo trupë, e cila nuk u zgjodh me votim nga “Kuvendi” përfundimisht deklaroi se formularët e verifikuar janë të ligjshëm dhe se “thirrja e Kuvendit Kombëtar është e ligjshme dhe konform statutit”. Nuk ka një procesverbal vendimarrës në lidhje me rezultatet e arritura nga ky grupim.
42. Komisioni administroi propozimin numër 1 të paraqitur sipas tyre, nga ¼ e anëtarëve të Këshillit Kombëtar për ndryshimin e statutit. Komisioni pretendon në procesverbal se ky propozim mbështetet nga 15% e delegatëve të Kuvendit duke administruar për këtë qëllim një listë me 1404 firmëtarë të cilët në fletën e nënshkruar parashetrojnë kërkesën për shkarkimin e kryetarit të Partisë Demokratike z. Lulzim Basha. Komisioni vijoi me procedurën e miratimit të propozimeve për ndryshimin e Statutit por procesverbali i punimeve të Kuvendit nuk paraqet në asnjë nga votimet (në parim, nen për nen dhe në tërësi) numrin e delegatëve që kanë votuar pro, numrin e delegatëve që kanë abstenuar dhe numrin e delegatëve që kanë votuar kundër. “Statuti” i miratur sipas tyre, i cili pretendohet se ka hyrë në fuqi me miratimin e tij përcakton në nenin 42 që numri i përgjithshëm i delegatëve të Kuvendit Kombëtar është 1100 (njëmijë e njëqind) anëtarë të cilët do të duhet të zgjidheshin nga kuvendet e degëve sipas një numri të përcaktuar për secilën degë.
43. Ndonëse numri, përbërja dhe mënyra e zgjedhjes së delegatëve të “Kuvendit Kombëtar” ka ndryshuar, dhe megjithëse Komisioni administron propozime për vendimarrje bazuar në Statutin e ndryshuar (sipas tyre), Komisioni vijoi punimet e Kuvendit duke miratuar edhe vendimet e mëpasshme sipas objektit të kërkesës së depozituar në Gjykatë.
44. Më datë 13.12.2021, është paraqitur kërkesë nga ana e kryetarit të partisë, z. Lulzim Basha, pranë gjykatës së shkallës së parë, për të depozituar ndryshimet statutore, të Kuvendit të saj të mbledhur në 17 korrik 2021.

45. Më datë 15.12.2021 përfaqësi i Komisionit të Rithemelimit depoziton në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë kërkesën për regjistrimin e vendimmarrjeve të “Kuvendit Kombëtar” të datës 11.12.2021. Bashkëlidhur kësaj kërkesë janë vetëm vendimet nga 1 – 7 të Kuvendit Kombëtar.
46. Më datë 18 dhjetor 2021, siç ishte njoftuar, është zhvilluar Kuvendi Kombëtar i PDSH, i thirrur në mënyrë statutore nga kryetari i partisë.
47. Zhvillimet përgjatë procesit gjyqësor, të hapur me kërkesë të “Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit” janë sqaruar më sipër në pjesën e parë të këtyre shpjegimeve.
48. Më datë 21 mars 2022, kryetari i partisë Lulzim Basha, ka dhënë dorëheqje nga detyra. Drejtimin e partisë pas këtij momenti e ka marrë sipas rregullave statutore, nënkryetari Enkelejd Alibeaj. Gjatë gjithë kohës në regjistrin e partive politike, ka rezultuar si kryetar i partisë z. Lulzim Basha (sipas regjistrimit të datës 13 korrik 2021). Partia ka vazhduar veprimtarinë politike dhe marrëdhëniet institucionale me të tretët në mënyrë vijuese nën *drejtimin e nënkryetarit Enkelejd Alibeaj me detyrën e Kryetarit të Komanduar të Partisë Demokratike fakt ky i vërtetuar ligjërisht nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve me vendimin numër 27, datë 16.03.2023 dhe është lënë në fuqi nga Kolegji Zgjedhor me vendimin numër 5, datë 27.03.2023.*
49. Në zgjedhjet vendore të vitit 2023, PDSH është regjistruar si subjekt politik. Kërkesa për regjistrim me nr 1337 Prot, datë 06.03.2023 është bërë nga zoti Indrit Sefa, përfaqësues i kësaj partie në KQZ, i autorizuar për paraqitjen e kërkesës nga kryetari Lulzim Basha. Autorizimi mban datën 18 mars 2022. Fillimisht kjo kërkesë është refuzuar nga Komisioneri Shtetëror me vendimin numër 172, datë 14.03.2023, por është pranuar nga Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve me vendimin numër 27, datë 16.03.2023 dhe është lënë në fuqi nga Kolegji Zgjedhor me vendimin numër 5, datë 27.03.2023. Theksojmë se në këtë procedurë administrative dhe gjyqësore ka qënë palë në proces edhe kërkuuesi në këtë gjykim.
50. Në zgjedhje është regjistruar në formën e koalicionit edhe subjekti “Bashkimi për Fitore”. Në kërkesën respektive për regjistrim ka figuruar në formën fillestare edhe subjekti politik “Partia Demokratike”. Në fakt PDSH e përfaqësuar nga Enkelejd Alibeaj nuk ka bërë asnjë marrëveshje/koalicion me partitë e tjera dhe se shfaqja e siglës “PDSH” në atë kërkesë dhe marrëveshje, ishte abuzim ligjor. Për këtë shkak Komisioneri Shtetëror e korrigjoi duke saktësuar përfundimisht se BF ishte një kolacion i përbërë nga partitë: Partia e Lirisë, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut dhe Partia Demokratiane. Pra Partia Demokratike, në zgjedhjet e 14 majit 2023, u regjistrua si subjekt më vetë, e përfaqësuar prej Nënkryetarit Enkelejd Alibeaj. Edhe kjo çështje iu nënshtruar shqyrtimit administrativ në KAS, i cili u shpreh me vendimin numër 27 datë 16.03.2023. *Çështja u bë konflikt administrativ në KAS, e më pas në Kolegjin Zgjedhor të cilët detyruan Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve të regjistrojë Partinë Demokratike të Shqipërisë si subjekt zgjedhor me Kryetar i Komanduar Z.Enkelejd Alibeaj. Edhe në këtë procedurë administrative dhe gjyqësore kanë qënë palë në proces kërkuuesi dhe ankuesi në këtë gjykim.*
51. Në zgjedhjet e pjesshme vendore për Kryetarin e Bashkisë Kukës, të shpallura me dekretin e Presidentit të Republikës numër 186, datë 11.08.2023, Partia Demokratike është regjistruar si subjekt zgjedhor me kryetar z. Lulzim Basha. Me anë të kërkesës numër 6721 prot., datë 01.09.2023, është kërkuar regjistrimi i “Partisë Demokratike e Shqipërisë” si subjekt zgjedhor në zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkinë Kukës, të datës 24 Shtator 2023. Kjo kërkesë është marrë në shqyrtim nga Komisioneri Shtetëror për Zgjedhjet i cili me vendimin numër



745, datë 04.09.2023, ka vendosur regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë, përfaqësuar nga z. Lulzim Basha si subjekt në zgjedhjet e pjesëshme vendore të datës 24.09.2023. Ky vendim i është nënshtruar shqyrtimit administrativ nga KAS i cili me vendimin 182, datë 07.09.2023 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Komisionerit Shtetëror.

### III. RREGULLAT PROCEDURIALE TË RIGJYKIMIT QË NUK U ZBATUAN NË SHQYRTIMIN NË APEL

52. Gjykojmë të nevojshme, të japim shkurtimisht edhe disa sqarime të aspektit procedural, për shkakun se kjo çështje u gjykua për herë të dytë në Apel, pas prishjes së vendimit nga Gjykata e Lartë. Këto sqarime, kanë rëndësi sepse jo vetëm përcaktojnë kufijtë e shqyrtimit të çështjes, por edhe sepse udhëzojnë edhe llojin e vendimmarrjes që gjykata e Apelit ishte e detyruar të merrte në fund të shqyrtimit. Për këtë shkak, nga ana jonë, jemi fokusuar, jo vetëm tek sqarimi i arsyeve të ngritur në rekurs, por këmbëngulim tek sqarimi i çështjeve procedurale dhe materiale të nënvizuara nga udhëzimet që Gjykata e lartë ka lënë si orientim dhe për të cilat gjykata e Apelit nuk dha asnjë përgjigje.
53. Vlerësojmë të sjellim në vëmendje, edhe nenin neni 493/4 – “Detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë janë të detyrueshme për gjykatën që rishqyrton çështjen, e cila, pasi zbaton këto detyra, vendos sipas bindjes së saj”. Ne vlerësojmë se dhënia përgjigje të gjitha udhëzimeve apo çështjeve që ka nënvizuar vendimi i Gjykatës së Lartë është e mjaftueshme për të dhënë një zgjidhje në themel, të çdo dyshimi, detyrë të cilën Gjykata e Apelit dështoi ta realizonte. Ndaj e udhës është që të bëjmë edhe një përmbledhje të grupçështjeve kryesore që Gjykata e Lartë ia kishte lënë Gjykatës së Apelit për detyrë t’i sqaronte dhe të cilat kjo gjykatë nuk i dha një përgjigje, duke i renditur ato edhe sipas një linje logjike, çështjet procedurale në fillim dhe ato materiale në vijim.
54. Për ne, nga leximi i vendimit të Gjykatës së lartë, rezulton se çështjet thelbësore që duhet të sqaroheshin nga Gjykata e Apelit janë si më poshtë të renditura:
- a- të riverifikohet, nëse ankuesi PDSH, përfaqësuar nga nënkryetari Enkelejd Alibeaj me autorizim legjitimohet të bëjë ankim ndaj vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë (paragrafët 36; 41; 51 fjalia e dytë, e VGJL).
1. të verifikohet se cili është organi/forumi partiak i cili ka patur në vijimësi të drejtën e përfaqësimit të personit juridik PDSH (paragrafi 36; 39; 40; 55; 58).
  2. efekti ligjor dhe rëndësia juridike e vendimeve për shkarkimin e Lulzim Basha në 11.12.2021 (paragrafi 53 i VGJL).
  3. të merret në shqyrtim dhe të analizohet nga pikëpamja e ligjit dhe e faktit se, çfarë vlere provueshmërie dhe juridike kanë: (i) aktet e miratuara në Kuvendin Kombëtar të PDSH në datën 11.12.2021 në lidhje me organet drejtuese të PDSH, për të cilat kërkohet regjistrimi në regjistrin e partive politike; (ii) aktet e prodhuara nga organet zgjedhore KQZ dhe KAS për aq sa ato mund të konsiderohen se ndikojnë në mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi; si dhe (iii) vendimet e marra nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, i cili është gjykatë dhe vendimet e dhëna prej tij janë vendime gjyqësore të formës së prerë (paragrafët 60 dhe 61 i VGJL).
- b- të verifikohet nëse Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, legjitimohej t’i drejtohej gjykatës me kërkesë.

c- a ka bërë kërkesë për të marrë pjesë në gjykim kryetari i PDSH Lulzim Basha dhe a është thirrur kryesisht nga gjykata? (paragrafët 38; 57).

d- shqyrtimi i provave, procesverbalit, seancës gjyqësore dhe vendimit nr.3 datë 25.03.2022.

55. Në rigjykimin e çështjes në apel Gjykata do të duhet t'i përgjigjej të gjithë çështjeve të ngritura nga VGJL të listuara më sipër (paragrafi 79 i VGJL) dhe siç duket fare qartë në vendimin numër 723 datë 11.06.2024 ka dështuar t'i japë përgjigje. Gjykata e Apelit jo vetëm ka dështuar të japë përgjigje por në mënyrë të vetëdijëshme nuk ka relatuar në asnjë moment argumentat dhe parashtrimet e palës ankuese pavarësisht se ky ka qenë dhe detyrim i lënë në VGJL.

#### IV. MBI PLOTËSIMIN E PARAKUSHTEVE FORMALE TË ANKIMIT QË DUHET TË SHQYRTONTE GJYKATA E APELIT

56. Një nga detyrat e lëna nga vendimi numër 768, datë 27.12.2023 i Gjykatës së Lartë (në vijim VGJL) është evidentimi nga ana e Gjykatës së Apelit të plotësimit të parakushteve formale të ankimit të parashikuara nga neni 450 i Kodit të Procedurës Civile. Në pikat 41 dhe 42 të VGJL kjo e fundit përcvaktën se:

“... 41. Gjykata rishikuese përpara se të fillojë shqyrtimin e çështjes së paraqitur para saj, ka detyrimin ligjor që të vlerësojë fillimisht nëse mjeti i ankimit të paraqitur, plotëson ose jo parakushtet formale të pranueshmërisë për shqyrtim, dhe më pas, të vijojë shqyrtimin e çështjes duke i dhënë zgjidhje shkaqeve të ankimit brenda kufijve të shqyrtimit të tyre (shiko vendimin nr.00-2022-3488, datë 23.11.2022 të Kolegjit Civil). Ky fakt rezulton të jetë përcaktuar qartësisht në nenin 450 të KPC, e cila, përbën dispozitë ligjore me karakter të përgjithshëm dhe si i tillë, gjen zbatim për të gjitha mjetet proceduriale që parashikon KPC (ankim, rekurs, ankim i veçantë apo rekurs i veçantë), si dhe në të gjitha shkallët e gjykimit.

42. Kolegji e çmon të arsyeshme për të vënë theksin tek fakti se, në miratimin e nenit 450 të KPC, ligjvënësi ka pasur si qëllim që të kufizojë shqyrtimin e mjeteve të ankimit pranë gjykatave më të larta, fillimisht tek plotësimi i elementëve formalë të tyre, të cilët, janë të nevojshme për tu plotësuar përpara se gjykata rishikuese të marrë në shqyrtim shkaqet ligjore për të cilat është paraqitur mjeti procedural i ankimit. Një gjykatë rishikuese, nuk mund të marrë në shqyrtim shkaqet e paraqitura në një mjet ankimi procedural, nëse ky mjet nuk plotëson parakushtet formale të pranueshmërisë, të cilat kanë të bëjnë me: (i) respektimin e afatit të paraqitjes së tij; (ii) nuk janë plotësuar të metat brenda afatit të caktuar nga gjykata dhe ligji; (iii) është ushtruar ndaj një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet ankim; (iv) është bërë nga një person që nuk legjitimohet të bëjë ankim; (v) është hequr dorë nga ankimi. Vetëm pasi janë plotësuar këto elementë, hapet rruga që gjykata rishikuese të marrë në shqyrtim dhe të vlerësojë pranueshmërinë e shkaqeve ligjore të paraqitura në ankim...”

57. Në aspektin e legjitimitimit formal- procedural Partia Demokratike e Shqipërisë e përfaqësuar me autorizim të Kryetarit të Partisë nga nënkryetari Enkelejd Alibeaj ose nëse vlerësohet se ky autorizim ka mbaruar fuqinë ligjore të tij Partia Demokratike e Shqipërisë përsëri përfaqësohet në këtë rast nga Enkelejd Alibeaj si Kryetar i Komanduar në zbatim të vendimit nr numër 27

datë 16.03.2023 të Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, dhe është lënë në fuqi nga Kolegji Zgjedhor me vendimin numër 5, datë 27.03.2023, gëzon legjitimitetin e ankimit ndaj vendimit numër 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë.

58. Neni 442/a i KPrC parashikon se: *“Ankimi është akti me të cilin palët ose pjesëmarrësit e tjerë në proces parashitajnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës dhe veprimeve të përmbareshit gjyqësor, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre”*. Në vendimin e saj Gjykata e Lartë, duke e konsideruar të drejtë edhe përfundimin e arritur nga Gjykata e Apelit, arsyeton se e vetmja palë në proces është “PDSH” duke konstatuar se kërkuesi dhe ankuesi janë i njëjti subjekt i së drejtës dhe i njëjti subjekt juridik. Neni 90 i Kodit të Procedurës Civile parashikon se: *“Palë në një gjykim janë personat fizikë ose juridikë, në emër dhe kundër të cilëve zhvillohet gjykimi. Askush nuk mund të përfaqësojë në një gjykim civil të drejtat e të tjerëve, përveç kur ligji parashikon ndryshe”*. Neni 91 i KPrC parashikon se: *“Kanë zotësi për të vepruar në një gjykim civil personat që ushtrojnë lirisht të drejtat, të cilat duhet të respektohen nga të tjerët. Personat që nuk kanë zotësi për të vepruar në një gjykim civil mund të marrin pjesë në gjykim vetëm kur përfaqësohen sipas dispozitave që rregullojnë zotësinë e tyre”*.
59. Subjekt të së drejtës materiale janë personat fizikë ose personat juridikë, të cilët gëzojnë të drejta dhe detyrime, duke qenë të pajisur si me zotësinë juridike, ashtu edhe zotësinë për të vepruar në kuptim të ligjit material. Këto subjekte që njihen si të tillë dhe rregullohen nga e drejta materiale mund të shfaqen në pozitën e “palës” në procesin civil, si subjekte “në emër” apo “kundër” të cilave zhvillohet gjykimi, duke gëzuar kështu secili zotësinë juridike procedurale për të qenë “palë” ndërgjyqëse si dhe zotësinë për të vepruar në procesin civil. “Palë” në procesin civil konsiderohet ai subjekt i së drejtës që përmbush dy kushte ligjore të njëkohshme, a) është personi fizik ose juridik në emër apo kundër të cilit zhvillohet gjykimi; b), është personi fizik apo juridik ndaj të cilit shtrin efektet e tij juridike dhe fuqinë ligjore vendimi gjyqësor i disponuar nga ai proces gjyqësor.
60. Subjekti i së drejtës në emër të të cilit është zhvilluar gjykimi në shkallë të parë, përfunduar me vendimin nr. 3, datë 25.03.2022 objekt ankimi, është personi juridik “PDSH”. Kjo e fundit përbën person juridik të regjistruar në regjistrat e partive politike, miratuar me Urdhërin nr. 12, datë 19.12.1990 të Ministrit të Drejtësisë. Është pikërisht ky subjekt i së drejtës, ndaj të cilit synon të sjellë efekte juridike dhe fuqi ligjore vendimi numër 3, datë 25.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Ndodhemi para të njëjtit subjekt të së drejtës, që shfaqet në pozitën e “kërkuesi” dhe të “ankuesi”, si pasojë e faktit se përfaqësimin e tij e synojnë në procesin civil, si Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, ashtu edhe nënkryetari i Partisë pajisur me autorizim nga Kryetari i Partisë dhe në funksionin e tij si Kryetar i Komanduar në zbatim të vendimit numër 27 datë 16.03.2023 të Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, dhe është lënë në fuqi nga Kolegji Zgjedhor me vendimin numër 5, datë 27.03.2023.
61. Nuk ndodhemi para dy subjekteve të ndryshme të së drejtës apo para dy personave të ndryshëm juridik, por para të njëjtit person juridik, subjekt në lidhje me të cilin paraqiten para gjykatës dy pretendues të ndryshëm për pozicionin procedural “të përfaqësuesit” të tij. Ndërsa Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit pretendon të drejtën e përfaqësimit të PDSH bazuar në ndryshimet statutoare të Kuvendit Kombëtar të datës 11 Dhjetor 2021 ende të pavlerësuara këto të fundit në vlefshmërinë dhe ligjshmërinë e tyre me vendim gjyqësor të formës së prerë, nga ana tjetër nënkryetari i PDSH autorizuar nga kryetari i partisë pretendon tagrin e përfaqësimit të PDSH, bazuar në dispozitat e Statutit të PDSH të regjistruar në regjistrin e

partive politike për këtë subjekt politik si dhe në nenin 14 të Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike".

62. Vlerësojmë se ankuesi PDSH gëzon legjitimitim në paraqitjen e ankimit ndaj vendimit nr. 3, datë 25.03.2021 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi rezultoi të jetë personi juridik në emër të të cilit është zhvilluar gjykimi në shkallë të parë, konform përcaktimit që neni 442/a të Kodit të Procedurës Civile realizon. Në ankimin e paraqitur PDSH parashtron kundërshtimet e saj në lidhje me vendimin e disponuar në shkallë të parë, pasi ky vendim ka prekur drejtpërdrejtë të drejtat dhe interesat ligjore të PDSH-së. Ky konkluzion për sa më sipër u referua, rezultoi të jetë në koherencë edhe me përcaktimet në nenin 90 dhe 91 të Kodit të Procedurës Civile mbi nocionet "**palë**" në gjykimin civil dhe "**zotësi juridike për të vepruar në gjykimin civil**", cilësi të cilat i atribuohen në këtë gjykim vetëm një subjekti të vetëm të së drejtës, Partisë Demokratike të Shqipërisë.
63. Personi juridik që paraqitet si palë në këtë proces PDSH është "parti politike", si i tillë rregullimi i tij realizohet me ligj të posaçëm, ligji numër 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike". Për këtë arsye legjitimitimi i PDSH-së në ushtrimin e ankimit ndaj vendimit numër 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, vlerësohet jo vetëm në raport me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, por edhe në raport me parashikimin në ligjin e posaçëm "Për partitë politike". Rezultoi se legjitimitimi i PDSH për të ushtruar ankim ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka disponuar për regjistrimin e ndryshimeve statutore për subjektin PDSH, buron përveçse nga dispozitat e Kodit të Procedurës Civile edhe nga parashikimet e nenit 15 të Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", ku përcaktohet se: "*Vendimi i Gjykatës për regjistrimin apo mosregjistrimin e partive politike në regjistrin e partive politike mund të ankimohet në gjykatën e apelit të Tiranës, brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së vendimit*".ç
64. Në analizë të këtij parashikimi ligjor rezultoi se shprehimisht legjislatori në këtë dispozitë parashikon të drejtën e ankimit edhe ndaj të vendimit "**për regjistrimin**", krahas vendimit "**për mosregjistrimin**" e ndryshimeve statutore. Ky parashikim i shprehur dhe i qartë, parashikon mundësinë që të kundërshtohet edhe vendimi i regjistrimit në regjistrat e partive politike, për sa potencialisht një vendimarrje e tillë mund të prekë apo çenojë të drejtat e subjektit politik. Në këtë parashikim ligjor të nenit 15 të ligjit "Për partitë politike", nuk përcaktohet dhe as nuk kufizohet rrethi i subjekteve që legjitimohen të ushtrojnë ankim ndaj vendimit të regjistrimit ose mosregjistrimit.
65. Bazuar në këtë parashikim të posaçëm ligjor nuk evidentohen pengesa apo ndalime ligjore në ushtrimin e së drejtës së ankimit nga PDSH pikërisht ndaj një vendimi gjyqësor regjistrimi ndryshimesh statutore për subjektin politik PDSH, vendimarrje për të cilën PDSH parashtron se ka çenuar të drejtat dhe interesat e ligjshme të saj si subjekt politik, ndaj të cilit ka synuar të sjellë efekte të drejtpërdrejta ky vendim. Për sa më sipër, rezultoi edhe në zbatim të nenit 15 të Ligjit "Për partitë politike", se PDSH legjitimohet në paraqitjen e ankimit ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka disponuar për regjistrimin e ndryshimeve statutore pikërisht për këtë subjekt politik.
66. Nënkryetari i PDSH z. Enkelejd Alibeaj pajisur me autorizim nga Kryetari i PDSH si dhe në detyrën e tij si Kryetar i Komanduar i PDSH-së në zbatim të vendimit numër 27, datë 16.03.2023, të Komisioni i Ankimeve dhe Sanksioneve, dhe është lënë në fuqi nga Kolegji Zgjedhor me vendimin numër 5, datë 27.03.202, gëzon legjitimitim procedural në përfaqësimin e ankuesit PDSH në gjykim, ashtu edhe legjitimitim procedural në paraqitjen dhe nënshkrimin

e aktit "Ankim" të ushtruar ndaj vendimit numër 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Neni 92 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: "*Personat juridikë marrin pjesë në gjykim me anë të atij që i përfaqëson, sipas dispozitave ligjore.*" Neni 96/c të Kodit të Procedurës Civile parashikon: "*Si përfaqësues të palëve me prokurë mund të jenë: c) juristët dhe punonjësit e tjerë të autorizuar të institucioneve shtetërore ose të personave juridikë;*"

67. Kodi i Procedurës Civile përcakton rregullin e përgjithshëm të përfaqësimit të një personi juridik. Referuar këtij përcaktimi që realizojnë nenet 92 dhe 96/c i K.P.C. rezulton se edhe pse personi juridik operon përmes organeve të tij, jo çdo organ i tij mund ta përfaqësojë atë në gjykim, por vetëm ai organ që sipas legjislacionit në fuqi ka të drejtë ta përfaqësojë kundrejt të tretëve. Ky nocion i neneve 92 dhe 96/c të KPrC derivon nga neni 31 i Kodit Civil. Ky nen parashikon se: "*Neni 31 – Personi juridik vepron me anë të organeve të veta të parashikuara në ligj, në aktin e krijimit ose në statut, të cilët shprehin vullnetin e tij. Veprimet juridike të kryera nga organet e personit juridik, brenda kompetencave të tyre, quhen si të kryera nga vetë personi juridik*". Nga interpretimi sistematik i neneve 31 të KC dhe 92 e 96/c të KPrC rezulton se në një proces gjyqësor subjekti juridik përfaqësohet nga një organ i parashikuar në aktin e krijimit ose në statut i cili (sipas parashikimeve të statutit) ka tagrat e përfaqësimit të subjektit juridik në raport me palët e treta (përfshirë edhe gjykatën).
68. Personi juridik që paraqitet si palë në këtë proces PDSH është parti politike, prandaj edhe ligji i posaçëm nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike" që gjen zbatim ndaj saj, ndër të tjera parashikon si vijon: Neni 14 i Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike" parashikon: "*Dispozitat e këtij ligji për rregjistrimin e partive politike janë njëloj të vlefshme për ndryshimet dhe fshirjet në rregjistrimet e mëparshme. Kërkesa për ndryshime në rregjistrin e partive politike bëhet nga organi i partisë që ka në kompetencë përfaqësimin e saj ndaj të tretëve.*"
69. Gjithashtu në nenin 9 të Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike" parashikohet: "*Rregjistrimi i partive politike bëhet në gjykatën e shkallës së parë të rrethit të Tiranë, e cila mban rregjistrin e partive politike. Në rregjistrin e partive politike shënohet numri rendor i rregjistrimit, numri i aktit, numri i vendimit gjyqësor, data e shpalljes, dispozitivi i vendimit, emri i plotë i partisë, inicialet e partisë, stema e partisë, përshkrimi i konfiguracionit të vulës, emri i kryetarit, shënime për ndryshimin e emrit, konfiguracione të vulës ose të kryetarit të partisë, fshirjes ose mbarimit të veprimtarisë së subjektit, data e bërjes së shënimit, emri si dhe nënshkrimin i nëpunësit kompetent. organizimin e saj, siç janë sidomos thirja e zhvillimi i mbledhjes së themeluesve dhe zgjedhja e organeve drejtuese, por nuk mund të kryejnë veprimtari si parti politike.*" Partia njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë. Deri në datën e regjistrimit, themeluesit e partisë mund të kryejnë veprime që janë të nevojshme për organizimin e saj por nuk mund të kryejnë veprimet që si rregull ligji u njeh subjekteve që kanë personalitet juridik.
70. Nga këto dispozita, ashtu edhe nga parashikimi në nenin 14 të ligjit, konkludohet se Partia politike fiton zotësi për të përfutur të drejta dhe për të marrë përsipër detyrime nga çasti i regjistrimit të saj dhe jo nga momenti i krijimit apo themelimit të saj. Ligji i posaçëm vendos si kusht ligjor shprehimisht, faktin se partia duhet të regjistrohet në rregjistrin e partive politike, në mënyrë që ajo të njihet nga të tretët si person juridik. Partia politike fiton zotësinë juridike dhe zotësinë për të vepruar nga momenti i regjistrimit të saj sipas ligjit material dhe po ashtu zotësinë juridike procedurale për të qenë palë në gjykim dhe për vepruar sipas ligjit procedural.

71. Efektet njohëse ndaj të tretëve në lidhje me partitë politike, sipas Ligjit "Për Partitë Politike", vijnë vetëm nga momenti i regjistrimit të ndryshimit statutor apo ndryshimeve të organizimit të brendshëm të partisë në regjistrin e partive politike, pasi janë miratuar këto ndryshime me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në këtë logjikë, as krijimi i Partisë dhe as ndryshimet statutorë apo organizative që mund të lidhen me të, nuk njihen nga të tretët para momentit të regjistrimit të tyre në regjistrin e partive politike.
72. Referuar parashikimeve në legjislacionin e posaçëm Ligji nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", rezulton se të drejtën e paraqitjes së kërkesave në gjykatë me objekt regjistrimin e ndryshimeve statutorë të Partisë Politike, e ka ai organ, i cili ka kompetencë përfaqësimit e partisë në raport apo ndaj të tretëve. Në këtë parashikim ligjor, rezulton se i autorizuari nga Kryetari i Partisë së PDSH, ku ky i fundit rezulton i regjistruar në regjistrin e partive politike si organ përfaqësues i PDSH, ka të drejtë të paraqesë ankim në emër të PDSH ndaj një vendimi gjyqësor që prek drejtëpërdrejt të drejtat dhe interesat ligjore të PDSH.
73. Vërtetohet nga provat në dosje, konkretisht "Vërtetim" datë 06.04.2022 të Zyrës së Rregjistrimit të Partive Politike, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, lëshuar bazuar në Rregjistrin e Partive Politike, se PDSH në momentin e depozitimit të ankimit ka pasur kryetar të saj të regjistruar z.Lulzim Basha. Rezulton se regjistrimet statutorë në regjistrin e partive politike për subjektin PDSH kanë identifikuar si organ përfaqësues ndaj të tretëve për PDSH Kryetarin e saj z. Lulzim Basha. Në regjistrin e partive politike nuk ka asnjë rregullim të ri statutor që të ketë sjellë ndryshim në drejtim të organit të përcaktuar si përfaqësues për PDSH ndaj të tretëve.
74. Duke marrë në analizë kërkesat ligjore të nenit 450 të KPrC, të cituara edhe në pikën 42 të VGL rezulton se:
- (i) ankimi është paraqitur me datë 04.04.2022 e për pasojë është brenda afatit 15 ditor të parashikuar nga KPrC dhe nga vetë vendimi numër 3, datë 25.03.2022;
  - (ii) nga ana e Gjykatës e cila ka disponuar mbi ankimin nuk janë konstatuar të meta të cilat duhet të plotësoheshin, apo kanë mbetur të paplotësuara përpara shqyrtimit gjyqësor të ankimit;
  - (iii) ankimi është ushtruar ndaj një vendimi ndaj të cilit lejohet ankim. Vetë vendimi numër 3, datë 25.03.2022 parashikon të drejtën e ankimit ndaj vendimit, e drejtë që sanksionohet edhe nga nenet 442 e vijues të KPrC;
  - (iv) ankimi është bërë nga një person (juridik në rastin objekt shqyrtimi) i cili legjitimohet të bëjë ankim.
  - (v) nuk është hequr dorë nga ankimi.
75. Pika e debatueshme në analizën e plotësisimit të kërkesave të parashikuara në neni 450 i KPrC është ajo (iv) e cila shtron për diskutim nëse subjekti që ka bërë ankimin është një subjekt që legjitimohet në kuptimin formalo procedural që të ushtrojë ankim ndaj vendimit numër 3, datë 25.03.2022. Gjykata e Lartë në pikën 29 të vendimit të saj arsyeton se: "29. Sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore të mësipërme, si dhe rregullave të sanksionuara në Kodin e Procedurës Civile (më poshtë do të citohet KPC), i cili, është ligji procedural bazë që aplikohet nga gjykata në shqyrtimin e këtyre lloj çështjeve, gjykata investohet nga subjekti juridik, partia politike, nëpërmjet paraqitjes së kërkesës, së bashku me të gjitha aktet shkresore mbështetëse që provojnë procedurat e kryera dhe vendimet e marra, të cilat kërkohet që të pasqyrohen në regjistrin përkatës të partive politike". Në analizë të këtij arsyetimi të Gjykatës së Lartë dhe të vendimit numër 3, datë 25.03.2022 rezulton se subjekti kërkues për të cilin është shprehur Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë është subjekti politik PDSH, subjekt i regjistruar në Gjykatën e Tiranës i cili ka fituar personalitet juridik që në vitin 1990. Ankimi mbi të cilin është

disponuar nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin numër 508 dhe mbi të cilin është investuar edhe Gjykata e Apelit është nënshkruar nga zoti Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e Nënkyetarit të Partisë Demokratike të Shqipërisë. Autorizimi/Akti i Përfaqësimit i datës 15.09.2021, lëshuar nga Kryetari i PDSH-së për zotën Alibeaj, i ka dhënë këtij të fundit tagra të përgjithshme përfaqësimi të subjektit politik PDSH në të gjitha proceset gjyqësore. Ky autorizim përmbush kushtet dhe kriteret e përcaktuara në paragrafin e dytë të nenit 72 të KPC. Po kështu, nënshkrimi i z. Alibeaj në ankimin në shqyrtim, shoqërohet me vulën e subjektit ankues, element ky i domosdoshëm në dhënien e fuqisë juridike akteve të një subjekti/personi juridik në një proces gjyqësor civil, i cili është i barazvlefshëm me fuqinë juridike të vërtetimit të nënshkrimit të individëve përpara noterit publik. Në dritën e këtyre fakteve rezulton që ankimi për vendimin numër 3, datë 25.03.2022 është ushtruar nga i njëjti subjekt juridik i cili ka depozituar kërkesën fillestare në gjykate dhe ndaj të cilit është dhënë edhe vetë vendimi i gjykatës.

76. Pretendimi i ngritur në ankimin ndaj vendimit 508/2022, në shqyrtimin gjyqësor në Gjykatën e Apelit dhe në rekursin ndaj vendimit 44/2023 nga ana e Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit është se:

*“...Deputeti Enkelejd Alibeaj ka pretenduar se e ka ushtruar të drejtën e ankimit në cilësinë e Nënkyetarit të Partisë Demokratike të Republikës së Shqipërisë, cilësi të cilën ai e ka fituar nga ndryshimet statusore dhe organeve të krijuara në Kuvendin Kombëtar të Partisë Demokratike në datën 27.07.2021, ndryshime të cilat, po sipas këtij subjekti nuk kanë hyrë në fuqi, pasi vendimi me të cilën janë urdhëruar regjistrimi i këtyre ndryshimeve është ankimuar nga vetë ky subjekt. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk e ka mbajtur në konsideratë dhe madje as e ka evidentuar këtë fakt në vendimin e dhënë prej saj.*

*Z. Alibeaj nuk legjitimohej në paraqitjen e ankimit objekt shqyrtimi, pasi ai nuk gëzon tagra përfaqësimi të PDSH, me asnjë nga statutet e fundit të saj, as ai objekt i vendimmarrjes nr. 3, datë 25.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, as statuti i 17 korrikut 2021, paraardhës i statutit në fuqi të PDSH-së. Gjykata e Rrethit Gjyqësor ka gabuar rëndë kur ka pranuar ankimin e paraqitur nga Deputeti Enkelejd Alibeaj, pasi ashtu sikurse arsyeton kjo gjykatë, ka rezultuar se autorizimi për z. Enkelejd Alibeaj është nënshkruar nga Kryetari i PDSH z. Lulzim Basha në datën 15.09.2021, ndërkohë që ankimi i paraqitur nga z. Alibeaj mban datën 04.04.2022, pra kohë në të cilën z. Basha kishte dhënë dorëheqjen nga kreu i PDSH. Konkretisht, z. Basha ka dhënë dorëheqjen në datën 21.03.2022....*

*Deputeti Alibeaj ka përdorur një autorizim të datës 15.09.2021 të lëshuar nga z. Lulzim Basha, i cili në kushtet që Kuvendi Kombëtar kishte shkarkuar z. Basha, dhe më pas i dorëhequr ky publikisht, e bën të pavlefshëm këtë autorizim...*

*Ndryshe nga qëndrimi që ka mbajtur Gjykata e Apelit, KQZ dhe KAS, konfirmuar ky qëndrim i tyre edhe nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, është arritur në përfundimin se autorizimi i Lulzim Bashës para dorëheqjes së tij publike nuk kishte më vlerë juridike pas datës 21.03.2022, duke e regjistruar PDSH në zgjedhje vetëm pasi kërkesën për regjistrim e ribëri nga e para z. Alibeaj me nënshkrimin e tij personal (pa autorizim). Madje për herë të parë në historinë e procesit zgjedhor, një parti politike u shënuar jo me emër të kryetarit, por me emër të nënkryetarit. Pra në këtë mënyrë, të gjithë organet zgjedhore KQZ, KAS dhe Kolegji Zgjedhor Gjyqësor nuk mbajtën parasysht*

*regjistrimin e pasqyruar në regjistrin e partive politike, por mbajtën në konsideratë elementin e faktit të dorëheqjes së z. Basha.*

*Në kundërshtim me këtë qëndrim, i cili, konfirmuar edhe nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor që është gjykatë, gjykata e apelit ka injoruar tërësisht aktin e heqjes dorë të z.Basha dhe ka legjitimuar në shkelje të rëndë të ligjit, subjektin ankues mbi bazën e nënshkrimit të z.Alibeaj, duke legjitimuar dhe duke i dhënë vlerë një autorizimi nul dhe pa asnjë vlerë ligjore....”*

77. Statuti i Partisë Demokratike në fuqi në kohën e shqyrtimit gjyqësor të çështjes (statuti i miratuar në vitin 2018) në nenin 56 në të cilin përcaktohet se: *“Neni 56 - Nënkrjetarët e Partisë - 1. Nënkrjetarët e PDSH-së zgjidhen sipas përcaktimeve të këtij Statuti. 2. Në mungesë të zgjatur të kryetarit dhe me autorizim të tij, njëri prej tyre zëvendëson Kryetarin. Në mungesë të këtij autorizimi (dorëheqje, etj.), Sekretari i Përgjithshëm mbledh Këshillin Kombëtar, i cili komandon nënkryetarin që do të drejtojë Partinë deri në vendimin përfundimtar të Kuvendit Kombëtar. 3. Njëri prej nënkryetarëve është kryetar i Grupit Parlamentar”.*
78. Bazuar në dispozitën e mësipërme statutore Kryetari i Partisë me anë të Autorizimit të datës 15.09.2021, ka ngarkuar Nënkrjetarin Enkelejd Alibeaj që të përfaqësojë Partinë Demokratike në çështje gjyqësore. Ky autorizim përcakton se: *“...autorizoj Enkelejd Alibeaj me detyrë Nënkrjetar i PD dhe/ose Gazment Bardhi me detyrë Sekretar i Përgjithshëm i PD, që të ndjekë të gjithë hapat e nevojshëm institucionalë dhe ligjorë për përfaqësimin e subjektit “PDSH” në të gjitha çështjet gjyqësore (penale, civile apo administrative) ku kjo e fundit tërheq interesa të ligjshëm. Ndjekja e këtyre çështjeve mund të bëhet nga të autorizuarit personalisht bashkë ose veç e veç apo duke autorizuar me vullnetin e tyre një avokat tjetër. Ky autorizim është i vlefshëm për çdo fazë gjyqësore dhe çdo pozitë procedurale, duke përfshirë edhe të drejtën për të kundërshtuar akte administrative apo gjyqësore, që janë rezultat i proceseve gjyqësore. Të autorizuarit kanë të drejtë së bashku ose veç e veç: ... të ankimojnë vendimet e ndërmjetme të gjykatës, - të ankimojnë vendimin përfundimtar të gjykatave, si dhe çdo vendim tjetër jo përfundimtar, që i jep fund hetimit gjyqësor, pa u zgjidhur çështja në themel; - të hartojnë, nënshkruajnë, depozitojnë Ankimin para Gjykatës së Apelit, si dhe të përfaqësojë PD para çdo gjykate të të gjitha niveleve së bashku ose veç e veç....”. Në kuptim të dispozitave statutore funksioni i përfaqësimit të subjektit politik PDSH, ndaj të tretëve, në fushën specifike të përfaqësimit gjyqësor është deleguar me autorizimin e sipërpërmendur autorizim i cili mbetet i vlefshëm edhe pas dorëheqjes së Kryetarit të Partisë Demokratike.*
79. Në zbatim të dispozitave dhe të argumentave të sipërcituara, rezulton se nënkryetari i Partisë z. Enkelejd Alibeaj është "i autorizuari" nga kryetari i PDSH për realizimin e përfaqësimit të PDSH në proceset gjyqësore ku palë është PDSH. Autorizimi i datës 15.09.2021 rezulton të mos jetë revokuar. Autorizimi i datës 15.09.2021 është akt që lidhet vetëm me përfaqësimin e PDSH në proceset gjyqësore dhe në ndërmarrjen e akteve apo veprimeve procedurale në gjykime. Tagrat e njohura të përfaqësimit rezultojnë të jenë të përgjithshme, pra për të gjitha proceset gjyqësore, duke përmbushur kështu kriteret ligjore sipas nenit 92 të K.P.C.
80. Neni 76 i Kodit Civil parashikon se: *“Neni 76 – Mbarimi i prokurës – Prokura mbaron kur: a) përfaqësuesi ka kryer veprimet juridike për të cilat ajo ishte dhënë; b) është plotësuar afati për të cilin ajo ishte dhënë; c) kur ka vdekur përfaqësuesi apo i përfaqësuari, ose kur njeri prej tyre ka humbur zotësinë për të vepruar; ç) ka mbaruar personi juridik përfaqësues apo*



*i përfaqësuar; d) kur i përfaqësuari ka shfuqizuar prokurën ose përfaqësuesi ka hequr dorë prej saj. Pas mbarimit të prokurës përfaqësuesi, me kërkesën e të përfaqësuarit duhet t'i kthejë atij aktin e prokurës*". Në rastin objekt shqyrtimi nuk jemi në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 76 i Kodit Civil. Veprimet që janë kryer dhe vazhdojnë të kryhen në përmbushje të tagrave të autorizimit jo vetëm nuk kanë përfunduar, por sikurse me të drejtë konstatohet edhe KAS dhe Kolegji, kanë vazhduar të kryhen para dhe pas datës së depozitimit të ankimit në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë. Autorizimi i dhënë nga Kryetari i Partisë Lulzim Basha nuk ka një afat kohor dhe si tillë vijon të jetë i vlefshëm për sa kohë nuk është revokuar nga Kryetari i Partisë. Në kuptim të gërms (c) *nuk rezulton që subjekti juridik Partia Demokratike e Shqipërisë (në cilësinë e të përfaqësuarit) të ketë pushuar së ekzistuari apo të ketë humbur zotësinë për të vepruar, fakt i cili rezulton i njëjtë edhe për përfaqësuesin. Vijimësia e ekzistencës juridike të personit juridik Partia Demokratike e Shqipërisë përjashton edhe mundësinë e zbatimit të gërms (ç) të nenit 76. Gërma (d) e nenit 76 parashikon mundësinë e përfundimit të prokurës (autorizimit) në rastin e shfuqizimit të prokurës apo të heqjes dorë prej saj. Autorizimi i datës 15.09.2021 i lëshuar nga Kryetari i Partisë Demokratike është një autorizim që ka për objekt të tij jo përfaqësimin e shtetasit Lulzim Basha në cilësinë e Kryetarit të Partisë Demokratike, por përfaqësimin e subjektit juridik "Partia Demokratike e Shqipërisë" si i tillë. Në këtë këndvështrim ky autorizim nuk lidhet me fatin apo me ushtrimin e detyrës nga shtetasi Lulzim Basha por me ushtrimin e të drejtës së përfaqësimit të subjektit juridik. Për të qenë në rastin e parashikuar nga gërma (d) e nenit 76 do të duhet të që autorizimi të shfuqizohej me akt të shkruar nga organi që ka tagrin e përfaqësimit të subjektit juridik ndaj të tretëve. Rasti i parashikuar në gërmen (d) është ai i revokimit/shfuqizimit të prokurës (autorizimit) akt i cili bëhet në mënyrë aktive dhe në formë të shkruar, për të tretët. Për sa kohë nuk ka një akt të shkruar me të cilin është revokuar autorizimi i datës 15.09.2021 ky i fundit vijon të prodhojë efekte juridike. Rezulton se edhe përfaqësuesi i subjektit juridik "Partia Demokratike e Shqipërisë", Enkelejd Alibeaj nuk ka hequr dorë nga tagrat e dhëna me autorizimin e datës 15.09.2021, përkundrazi në vijimësi ai ka ushtruar këto tagra të funksionit të Kryetarit të Komanduar të Partisë Demokratike të Shqipërisë, fakt i konfirmuar ky edhe nga vendimi numër 27, datë 16.03.2023 i KAS dhe vendimi numër 5, datë 27.03.2023 i Kolegjit Zgjedhor.*

81. Në vendimin numër 508 Regj. Them. datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë, Gjykata arsyeton se: *"Ankimi është nënshkruar nga Z. Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e Nënkyetarit të Partisë Demokratike të Shqipërisë. Autorizimi / Akti i përfaqësimit i datës 15.09.2021, lëshuar nga Kryetari i PDSH-së për z. Alibeaj, i ka dhënë këtij të fundit tagra të përgjithshme përfaqësimi të subjektit politik PDSH në të gjitha proceset gjyqsore. Ky autorizim përmbush kushtet dhe kriteret e përcaktuara në paragrafin e dytë të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile."* Nga formulimi i mësipërm rezultojnë se gjykata në shqyrtimin e disponimit të ankimit ka arsyetuar lidhur me autorizimin e përfaqësimit, si nga ana formale (plotësimi i kushteve të parashikuara nga neni 72 i K.Pr.C) ashtu edhe nga ana substanciale duke vlerësuar si tagrat e lëshuesit të autorizimit ashtu edhe tagrat e deleguara me autorizim.
82. Nga aktet e dosjes gjyqsore rezultojnë se më datë 13.07.2021 në dosjen e regjistrimit të Partisë Demokratike është regjistruar zgjedhje e kryetarit të ri z. Lulzim Basha. Kryetari në ushtrim të tagrave të tij dhe zbatim të dispozitave statutore ka lëshuar autorizimin e datës 15.09.2021, autorizim me të cilin ka kaluar një pjesë të tagrave të tij në drejtim të z. Enkelejd Alibeaj në cilësinë e nënkryetarit dhe z. Gazment Bardhi në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm. Më datë 21.03.2022 kryetari i partisë me një akt politik publik ka dhënë dorëheqjen nga ushtrimi i funksioneve të Kryetarit të Partisë. Vakanca institucionale është mbuluar me komandimin në detyrë të Nënkyetarit Enkelejd Alibeaj. Kjo vijimësi institucionale e ushtrimit të tagrave të

pozicionit të Kryetarit të partisë është ushtruar në vijimësi (nga data 13.07.2021 – deri ditën e këtij shqyrtimi gjyqësor) fillimisht nga Lulzim Basha e më pas nga Enkelejd Alibeaj (person i cili rezultoi që të jetë edhe nënshkruesi i ankimit të depozituar kundër vendimit numër 3, datë 25.03.2022 Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë).

83. Pretendimet e ngritura nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit vënë në diskutim pikërisht përmbushjen e parakushtit formal të parashikuar nga gërma (ç) e nenit 450 të KPrC (ankimi është bërë nga një person që nuk legjitimohet të bëjë ankim). Në mbështetje të këtij argumenti pala rekursuese ka referuar vendimin numër 27, datë 16.03.2023 të KAS, vendim i konfirmuar nga vendimi numër 5, datë 27.03.2023 i Kolegjit Zgjedhor. Ndryshe nga sa pretendon Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit arsyetimi i KAS dhe më pas i Kolegjit Zgjedhor mbështet argumentin e ankuesit në lidhje me tagrat e z. Alibeaj në momentin e ushtrimit të ankimit. KAS në vendimi numër 27, datë 16.03.2023 arsyeton se:

*“...15.Drejtimi i partisë politike kryhet sipas rregullave statutores të partisë, të cilat zbatohen dhe mbikëqyren nga anëtarësia e partisë dhe/ose instancat kompetente statutores të saj. Kryetari i partisë i ushtron funksionet nga momenti i zgjedhjes së tij në krye të saj, pavarësisht nga momenti kur ky akt regjistrohet në gjykatë. Ai e përfaqëson partinë në marrëdhëniet me të tretët pa pasur nevojë (pa prituri) që të kryejë më parë regjistrimin e faktit në gjykatë.*

*16.KAS-i është në dijeni të faktit se legjitimiteti i nënkryetarit, z. Enkelejd Alibeaj si kryetar i komanduar i Partisë Demokratike është kontestuar publikisht nga formacioni rival brenda Partisë Demokratike. Por kontestimi i zgjedhjes në detyrë të kryetarit, apo i caktimit të kryetarit të komanduar bëhet gjithashtu sipas rregullave statutores dhe shqyrtohet nga instancat kompetente statutores. Të tretët nuk kanë asnjë zë në këtë kapitull dhe nuk mund të zgjedhin t’u njohin apo të mos t’u njohin kryetarin e zgjedhur apo të komanduar të partisë. Në dijeninë e KAS-it nuk ka asnjë procedurë kontestimi statutor për drejtimin e Partisë Demokratike nga z. Enkelejd Alibeaj, as ndonjë procedurë kontestimi gjyqësor. Kjo do të thotë se nuk ka asnjë shkak ligjor për KQZ-në për të dyshuar në vazhdimësinë institucionale nga ish kryetari Basha tek kryetari i komanduar Alibeaj.*

*17.Vazhdimësia institucionale nga Kryetari Basha tek kryetari i komanduar Alibeaj provohet nga autorizimi i përgjithshëm i lëshuar nga Kryetari i PD-së z. Lulzim Basha më datë 18.03.2022, kur ishte në ushtrim të plotë të tagrave të veta, sikurse provohet nga shkresa e Sekretarit të PD për Çështjet Ligjore dhe Zgjedhore me nr. 27/3 prot., datë 14.03.2023, protokolluar në KQZ me nr.1650 prot., datë 14.03.2023, nga vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr.508 Regj.Them., datë 22.04.2022, si dhe nga vendimi i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm nr.44, datë 03.03.2023.*

*18.Prandaj Kryetari i komanduar i Partisë Demokratike z. Enkelejd Alibeaj ka tagra të plota të nënshkruajë, me këtë cilësi, kërkesën për regjistrim dhe gjithë dokumentacionin deklarativ që kërkon pika 2 e nenit 64 të Kodit Zgjedhor. Ky dokumentacion duhet të jetë i azhurnuar, pavarësisht se regjistri gjyqësor mund të mos jetë i tillë. Autorizimi i përgjithshëm i lëshuar nga z. Lulzim Basha e ka humbur fuqinë nga momenti që ai ka dhënë dorëheqjen dhe është zëvendësuar në detyrë nga Kryetari i komanduar i Partisë, z. Enkelejd Alibeaj dhe është i panevojshëm për procedurën e regjistrimit të Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor...”*

84. Ky arsyetim i KAS (lënë në fuqi nga Kolegji Zgjedhor (duke i dhënë fuqinë e *gjësë së gjykuar*)) përcakton se autorizimet e dhëna nga Kryetari i Partisë e humbin fuqinë e tyre në rastin kur plotësohen në mënyrë kumulative 2 rrethana (i) kryetari ka dhënë dorëheqjen dhe (ii) është zëvendësuar në detyrë. Ky përfundim i arritur nga KAS është në harmoni edhe me praktikën e gjerë administrative dhe ligjore, sipas së cilës akti i dorëheqjes nuk është i barabartë me pushimin e ushtrimit të tagrave dhe se këto të fundit përfundojnë në momentin kur kryhet edhe zëvendësimi i të dorëhequrit me kryetarin e ri. Autorizimi i lëshuar nga z. Basha i datës 15.09.2021 (dhe ai i datës 18.03.2022, i analizuar nga KAS) ndryshojnë vetëm në cilësinë e tagrave që delegojnë, por mbeten esencialisht të njëjtë në elementët e tjerë. Për sa kohë kemi një vendim gjyqësor të formës së prerë në të cilin është pranuar arsyetimi i KAS për vijimësinë institucionale të ushtrimit të tagrave të Kryetarit të Partisë Demokratike të Shqipërisë, si organi që ka të drejtën e përfaqësimit të këtij subjekti juridik me të tretët, nuk mundet që kjo gjykatë të mbajë një qëndrim të ndryshëm ligjor. Theksojmë se vendimi numër 27, datë 16.03.2023 i KAS është lënë në fuqi me vendimin numër 5, datë 27.03.2023 të Kolegjit Zgjedhor duke i dhënë formën e gjësë së gjykuar dhe për pasojë të detyrueshme për çdo Gjykatë.
85. Në lidhje me përmbushjen e parakushteve formale – procedurale dhe pranueshmërinë e ankimit të PDSH, sipas kritereve ligjore që renditen në nenin 450/1 të K.P.C., rezulton se nuk ka shkaqe të tjera ligjore nga ato që mund të shkaktojnë papranueshmëri të ankimit, përtej "legjitimitit" të ankuesit, që u analizua më lart.
86. Neni 450 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: "1. Gjyqtari i vetëm i gjykatës që ka dhënë vendimin, në dhomë këshillimi, menjëherë pas paraqitjes së ankimit, vendos mospranimin e ankimit kur: a) është paraqitur jashtë afatit; b) nuk ndreqen të metat në afatin e caktuar sipas nenit 455 të këtij Kodi; c) është bërë kundër një vendimi ndaj të cilit nuk lejohet ankim; ç) është bërë nga një person që nuk legjitimohet të bëjë ankim; d) është hequr dorë nga ankimi, 2. Kundër vendimit të mospranimit të ankimit mundet të bëhet ankim i veçantë. 3. Mospranimi i ankimit mund të deklarohet në çdo shkallë gjykimi."
87. Neni 450 i K.P.C. referon në nenin 455, dhe ky i fundit referon edhe në nenet 453 dhe 454 të K.P.C., në të cilët respektivisht parashikohet se: Neni 453 i Kodit të Procedurës Civile: "Nënshkrimi i ankimit Ankimi që i drejtohet gjykatës së apelit duhet të nënshkruhet nga vetë pala, avokati ose përfaqësuesi i pajisur me prokurë." Neni 454 i Kodit të Procedurës Civile. "Përmbajtja e ankimit Në ankim duhet të tregohen: a) palët ndërgjyqëse; b) vendimi kundër të cilit bëhet ankimi; c) shkaqet për të cilat bëhet ankimi; ç) çfarë kërkohet me ankimin." Neni 455 i Kodit të Procedurës Civile: "Dokumentet që i bashkëngjiten ankimit Bashkë me ankimin duhet të paraqiten: a) kopje të ankimit dhe të dokumenteve të tjera, aq sa janë personat që marrin pjesë në çështje si palë; b) prokura kur ankimi paraqitet nga avokati ose përfaqësuesi i palës. Në rast se ankimi nuk plotëson kushtet e mësipërme, si dhe ato të neneve 453 dhe 454 të këtij Kodi, gjykata njofton palën që të ndreqë të metat brenda 5 ditëve, në të kundërt ankimi kthehet."
88. Konkretisht rezulton se:
- Ankimi ndaj vendimit nr. 3, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është paraqitur brenda afatit ligjor për ankimin e vendimit, të përcaktuar në nenin 15 të Ligjit "Për partitë politike". Vendimi i ankimit është shpallur më datë 25.03.2022, ndërsa ankimi i PDSH ndaj tij është rregjistruar më datë 04.04.2022, pra brenda afatit 15 ditor, referuar parashikimit në nenin 15 të Ligjit "Për partitë politike".

- Ankimi nuk ka të meta, referuar parashikimeve në nenet 453, 454 dhe 455 të Kodit të Procedurës Civile. Ankimi është paraqitur i nënshkruar nga personi i autorizuar nga Kryetari i Partisë PDSH si më sipër analizuar, ashtu sikurse është i pajisur me vulën e personit juridik PDSH, konfiguracioni i së cilës është ai i regjistruar në regjistrin e partive politike. Në ankim identifikohen elementët e përmbajtjes sipas nenit 454 të K.P.C. Bashkëlidhur ankimit është autorizimi i datës 15.09.2021 i Kryetarit të PDSH, ashtu edhe aktet e tjera provuese në mbështetje të tij, të cilat janë bërë pjesë e fashikullit të gjykimit që i përket vendimit nr. 508 akti, datë 22.04.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që ka disponuar në shkallë të parë për "pranimin e ankimit të PDSH",
- Ankimi është ushtruar ndaj një vendimi për të cilin lejohet ankim, sikurse më sipër u analizua. Neni 15 i Ligjit "Për partitë politike" parashikon se: "Vendimi i Gjykatës për regjistrimin apo mosregjistrimin e partive politike në regjistrin e partive politike mund të ankimohet në gjykatën e apelit të Tiranës, brenda 15 ditëve nga data e shpalljes së vendimit" duke cilësuar shprehimisht si të ankimeshëm edhe vendimin për regjistrimin në regjistrin e partive politike.
- Ankimi është paraqitur nga personi juridik PDSH, i vetmi person juridik në gjykim, përfaqësuar ky i fundit në ankim nga organi që ka kompetencën e përfaqësimit të PDSH ndaj të tretëve referuar në nenin 14 të Ligjit "Për partitë politike" dhe nenit 92 të K.P.C.

89. Konstatohet në përfundim, se ankimi ka përmbushur gjithashtu kriteret ligjore për pranueshmërinë e tij, sipas përcaktimit të nenit 450/1 të Kodit të Procedurës Civile.

90. Me të drejtë Gjykata e Lartë e cila në vendimin e saj arsyeton se: *"36. Duke iu rikthyer mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se, referuar natyrës së mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, si dhe përcaktimit të interesit të ligjshëm për t'ju drejtuar gjykatës dhe për të iniciuar këtë proces gjyqësor, me të drejtë Gjykata e Apelit ka arritur në konkluzionin se, palë e interesuar në këtë gjykim është personi juridik PDSH, i cili, tërheq të drejtat e ligjshme nga ky proces..."* arrin në përfundimin se në çështjen objekt gjykimi ka vetëm një palë e cila është subjekti juridik PDSH dhe se konflikti gjyqësor është se cilët përfaqësues të subjektit juridik kanë tagrat e përfaqësimit të këtij të fundit në Gjykatë. Në vendimit 44, datë 03.03.2023 të Gjykatës së Apelit Tiranë, faqet 68-77 analizohet në mënyrë të detajuar edhe përfundimi i konsideruar si i drejtë nga Gjykata e Lartë në raport me përfaqësimin si palë e subjektit juridik Partia Demokratike e Shqipërisë.

91. Ky përfundim i Gjykatës së Lartë, i cili ka zgjidhur në thelb edhe çështjen e legjitimitetit formalo – procedural dhe plotësimin e kushteve për marrjen në shqyrtim të ankimit, provohet edhe nga vijimi i arsyetimit të Gjykatës së Lartë në pjesën e orientimeve që i jepen Gjykatës së Apelit për zgjidhjen e çështjes. Në pikën 60 të pjesës arsyetuese të vendimit Gjykata e Lartë shprehet se: *"...60. Kolegji vlerëson se, në arritjen e konkluzionit se kush është organi kompetent që përfaqëson në këtë rast PDSH, gjykata e apelit nuk duhet ta kufizonte dhe ngushtonte shqyrtimin gjyqësor, duke vlerësuar faktin nëse dorëheqja e kryetarit të PDSH z. Lulzim Basha është kryer në formën shkresore dhe a ka gjetur pasqyrim në regjistrin e partive politike. Për të pasur një gjykim të drejtë dhe të gjithëanshëm të çështjes, si dhe për të kuptuar drejtë natyrën e këtij gjykimi, Gjykata e Apelit duhet të merrte në shqyrtim dhe të analizonte nga pikëpamja e ligjit dhe e faktit se, çfarë vlere provueshmërie dhe juridike kanë: (i) aktet e miratuara në Kuvendin Kombëtar të PDSH në datën 11.12.2021 në lidhje me organet drejtuese të PDSH, për të cilat kërkohet regjistrimi në regjistrin e partive politike; (ii) aktet e prodhuara nga organet zgjedhore KOZ dhe KAS për aq sa ato mund të konsiderohen se ndikojnë në mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi; si dhe (iii) vendimet e*

marra nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, i cili është gjykatë dhe vendimet e dhëna prej tij janë vendime gjyqësore të formës së prerë. Vetëm pasi të merren në analizë të gjitha faktet dhe provat e nevojshme të administruara në dosje, gjykata do të kishte mundësi për të konkluduar definitivisht se kush është organi që përfaqëson juridikisht tek të tretët PDSH-në, i cili është subjekti juridik që tërheq të drejtat në këtë gjykim...". Bazuar në këtë arsyetim të Gjykatës së Lartë vlerësojmë se është përcaktuar se cili është thelbi i konfliktit që shtrohet për zgjidhje përpara Gjykatës së Apelit, duke orientuar llojin e provave që duhet të merren në shqyrtim nga kjo gjykatë (prova që janë krijuar pas dhënies së vendimit 44/2023).

92. Duke u nisur nga konstatimi i Gjykatës së Lartë lidhur me thelbin e konfliktit gjyqësor, atë të përfaqësuesve të subjektit juridik PDSH, si e vetmja palë në proces, konflikti i cili mund të zgjidhet vetëm nga shqyrtimi në themel i çështjes, rezulton se kjo gjykatë e ka pranuar legjitimitetin formal – procedural të palës ankuuese në gjykim. Zgjidhja e konfliktit për legjitimitetin e përfaqësuesve të subjektit juridik nuk mund të zgjidhet para fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, kjo edhe për faktin se pretendimet mbi legjitimitetin janë të ndërlidhura me njëri – tjetrin dhe se aktet provuese të tyre janë pjesë e shqyrtimit të themelit të çështjes. Jo më kot Gjykata e Lartë e orienton Gjykatën e Apelit që të vlerësojë aktet e miratuara nga Kuvendi Kombëtar, KAS dhe Kolegji Zgjedhor, jo më në këndvështrimin e akteve provuese për elementin formal – procedural të ankimit, por për vlerën e tyre provuese në lidhje me themelin dhe zgjidhjen përfundimtare të çështjes.
93. Në pikën 53 të vendimit Gjykata e Lartë arsyeton se: “53. Në arsyetimin e vendimit të saj, Gjykata e Apelit ka arritur në konkluzionin se z. Lulzim Basha vijon të jetë kryetar i PDSH, duke e kufizuar arsyetimin e saj ligjor në faktin se, kërkesa për heqje dorë nga funksioni i Kryetarit të PDSH nga ana e z. Lulzim Basha nuk është formalizuar me shkrim, si dhe nuk është depozituar në regjistrin e partive politike. Megjithatë, kjo gjykatë nuk ka vlerësuar dhe nuk ka marrë në analizë të detajuar faktin nëse ndryshimet statutore të miratuara nga Kuvendi Kombëtar i datës 17.07.2021, në të cilin z. Lulzim Basha është rizgjedhur Kryetar i PDSH janë regjistruar në regjistrin e partive politike apo jo, si dhe nëse kanë prodhuar efekte juridike këto ndryshime. Gjithashtu, gjykata e apelit nuk ka vlerësuar dhe nuk ka konkluduar nga pikëpamja e faktit dhe e ligjit se, çfarë efekti ligjor dhe rëndësie nga pikëpamja juridike ka mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit Kombëtar të PDSH, si dhe vendimet e marra në këtë Kuvend, ku disa prej këtyre vendimeve kanë të bëjnë me shkarkimin e organeve drejtuese të PDSH (një prej të cilëve Kryetari i PDSH z. Lulzim Basha) dhe krijimin e organeve të reja drejtuese, sikurse është edhe Komisioni i Rithemelimit”. Ky arsyetim i Gjykatës së Lartë lidhet me nevojën e sqarimit të faktit nëse në datën e depozitimit të ankimit (04.04.2022) jemi në kushtet kur Kryetari i Partisë është shkarkuar sipas vendimit numër 6 të të pretenduarit “Kuvend i 11 dhjetorit” apo është dorëhequr. Rasti i dorëheqjes dhe pasojave të prodhuara prej saj është argumentuar gjerësisht më lartë, ndaj, në zbatim edhe të detyrave të lëna nga VGJL është e nevojshme të analizojmë pasojat ligjore të vendimit numër 6 të të pretenduarit “Kuvend i 11 dhjetorit” me të cilin pretendohet se është shkarkuar kryetari i PDSH Lulzim Basha.
94. Satuti i PDSH (i regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë në kohën e zhvillimit të të pretenduarit Kuvend i 11 dhjetorit) në nenin 48 përcakton si një nga kompetencat e Kuvendit Kombëtar atë të shkarkimit të Kryetarit të Partisë. Pika 4 e nenit 48 përcakton se: “4. vendos për shkarkimin e Kryetarit të Partisë mbi bazën e një mocioni mosbesimi të miratuar nga më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit Kombëtar;”. Nga analiza e kësaj dispozite statutore rezulton se për fillimin e procedurës statutore të shkarkimit të kryetarit të partisë është si fillim i nevojshëm hartimi i një mocioni mosbesimi, mocion i cili paraqitet dhe miratohet nga Këshilli

Kombëtar. Togfjalëshi “më shumë se gjysma e anëtarëve të Këshillit Kombëtar” nënkupton që jemi në kushtet e një votimi me shumicë të cilësuar, 50% +1 e të gjithë anëtarëve të Këshillit Kombëtar. Procedura e zakonshme e parashikuar në statut për adresimin e propozimeve dhe kërkesave drejtuar Kuvendit Kombëtar parashikohet nga pika 5 e nenit 47 të Statutit i cili përcakton se “5. Të drejtën për t’i bërë kërkesa dhe propozime Kuvendit Kombëtar, për çështje që janë në kompetencë të tij, përveç rasteve kur ky Statut përcakton ndryshe, e kanë: a) Kryetari i Partisë; b) Këshilli Kombëtar; c) Kryesia e PDSH-së; d) Jo më pak se pesëmbëdhjetë për qind e anëtarëve të Kuvendit me të drejtë vote, të shpërndarë në të paktën pesë Degë të PDSH-së. Kërkesat për propozim kandidaturash sipas kësaj germe, duhet t’i nënshtrohen të njëjtave procedura si të tre germave të para”. Kjo dispozitë parashikon rregullin e përgjithshëm e adresimit të propozimeve dhe kërkesave, duke parashikuar gjithashtu edhe rregullin kufizues të rasteve kur statuti parashikon ndryshe. Pika 4 e nenit 48 është rasti përjashtimor që përcakton se për shkarkimin e kryetarit të partisë nuk ndiqet rregulli i përgjithshëm i parashikuar nga pika 5 e nenit 47 por nga rregulli i posaçëm i parashikuar nga vetë kjo pikë.

95. Nga analiza e akteve të fashikullit gjyqësor rezulton se në procesverbalin numër extra prot, datë 11.12.2021 me titull “Procesverbal i mbledhjes së Kuvendit Kombëtar të PDSH-së” relatohet: “Më pas Komisioni i drejtimit të punimeve të Kuvendit administroi një kërkesë të paraqitur sipas neneve 42 dh 43 të Statutit të PDSH-së si më poshtë: 1 – Kërkesë “propozim për vendimmarrje Kuvendit Kombëtar të PDSH” e propozuar nga 7 deputetë të Kuvendit të Shqipërisë përfaqësues të Partisë Demokratike të Shqipërisë” së bashku me 6 projekt vendime bashkëlidhur e cila u regjistruar nga Komisioni me numër 2, datë 11.12.2021”.
96. Nga procesverbali i punimeve të Kuvendit të pretenduar të 11 dhjetorit, nga formulimi dhe depozitimi i propozimit për projekt vendimin dhe nga baza ligjore e vetë vendimit numër 6 rezulton që nuk janë respektuar dispozitat statutore në lidhje me propozimin dhe miratimin e mocionit të mosbesimit të parashikuar nga statuti i vitit 2018 në fuqi në momentin e zhvillimit të punimeve të Kuvendit të pretenduar të 11 dhjetorit. Mosrespektimi i dispozitave statutore në lidhje me procedurën e kërkuar për marrjen e vendimit nga ana e Kuvendit Kombëtar në raport me shkarkimin e kryetarit të partisë sjell pavlefshmërinë e këtij vendimi e për pasojë rezulton se me datë 11 dhjetor nuk ka pasur asnjë vendim të vlefshëm për shkarkimin e kryetarit Basha.
97. Nga ana tjetër rezulton se vendimi numër 6 është një vendim i cili nuk është në vetvete një vendim shkarkimi por një vendim i cili parashikohet të ratifikohet nga një votim i të gjithë anëtarësisë. Në kronologjinë e ngjarjeve të relatuar nga Procesverbali i punimeve rezulton se fillimisht është miratuar vendimi numër 6 e më pas është realizuar procedura e votimit për shkarkimin e kryetarit Lulzim Basha. Vendimi numër 6 njëkohësisht parashikon se ky vendim do të ratifikohet nga anëtarësia e Partisë më datë 18.12.2021. Me vendimin numër 1, datë 16.12.2021 rezulton të jetë ngritur “Komisioni i organizimit dhe kontrollit të operacioneve elektorale” i cili parashikohet të zhvillonte procedurat referendare për ratifikimin e vendimit numër 6, datë 11.12.2021 të të pretenduarit Kuvend Kombëtar. Ky Komision më datë 19.12.2021, me vendimin numër 5 ka miratuar rezultatet e referendumit për ratifikimin e vendimit numër 6 të Kuvendit të pretenduar të datës 11.12.2021.
98. Nga aktet e cituara më lartë arrijmë në përfundimin që vendimi numër 6 i Kuvendit të pretenduar Kombëtar nuk ka hyrë në fuqi me miratimin e tij nga Kuvendi por me ratifikimin e tij nga anëtarësia, pra me datë 19.12.2021. Kërkesa drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nga KPR rezulton që të jetë depozituar me datë 15.12.2021 dhe regjistruar nga kjo Gjykatë me datë 16.12.2021 pra përpara se vendimi i pretenduar për shkarkimin e kryetarit Basha të hynte

në fuqi. Në këto kushte rezulton se edhe në këtë rast palë kërkuese nuk kishte legjitimitetin aktiv për të adresuar Gjykatën, pasi edhe sipas akteve (gjithësesi të pavlefshme të saj) deri më datë 19.12.2021 Kryetari i PDSH rezulton të ishte Lulzim Basha.

## V. MBI LEGJITIMIMIN E KËRKUESIT - KOMISIONI I PËRKOHSHËM I RITHEMELIMIT

99. Nga kërkesa e paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqsor Tiranë (faqe 1 e fashikullit gjyqësor) rezulton se si kërkues është prezantuar partia politike (person juridik) PDSH, i pretenduar se është i përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit. Nga ana tjetër është pretenduar se vetë Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, është i përfaqësuar nga Z. Ivi Kaso, sipas autorizimit numër 1, datë 13.12.2021 (faqe 5 e fashikullit gjyqsor). Kërkesa është nënshkruar nga shtetasi Ivi Kaso dhe është depozituar po nga ai në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (faqe 55 e fashikullit gjyqësor). Në formularin e standartizuar të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë për depozitim të kërkesave dhe kërkesë padive, depozituesi Ivi Kaso ka relatuar si kërkues partinë politike (personin juridik) “PDSH”.
100. Në këtë fazë është e detyrueshme për t’u sqaruar, nëse përfaqësimi zinxhir (PDSH – Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit – shtetasi Ivi Kaso), është në përputhje me rregullat ligjore dhe statute apo jo (Kodi Civil, Ligji për partitë politike, statuti në fuqi i PDSH). Saktësimi i kësaj çështje do t’i jepte përgjigje faktit nëse ata që ka pretenduar të përfaqësojnë PDSH, para gjykatës së shkallës së parë, kishin legjitimitim formalo-procedural. Pra t’i jepte përgjigje pyetjes nëse kërkesa e paraqitur para gjykatës plotësonte parakushtet formalo-juridike. Me fjalë të tjera, duhet bërë i njëjti trajtim juridik, si edhe në rastin e trajtimit të parakushteve formalo-juridike që u bënë për rastin e ankimit ndaj vendimit të gjykatës, të paraqitur nga nënkryetari Enkelejd Alibeaj. Gjykata e Lartë në vendimin e saj, ka orientuar Gjykatën e Apelit, që të trajtojë në mënyrë simetrike, qoftë ankimin (ndaj vendimit) e qoftë edhe kërkesën (që çoi te vendimi) përse i përket plotësimi të parakushteve formalo-juridike. Me fjalë të tjera nëse ato subjekte (KPR dhe shtetasi Ivi Kaso) kishin aftësitë ligjore procedurale të përfaqësonin PDSH, e në këtë mënyrë të zgjidhet çështja nëse kishin aftësinë juridike të investonin Gjykatën e Shkallës së Parë të hapte atë proces gjyqësor. Bëhet fjalë këtu, për të analizuar korrektësinë e zbatimit të nenit 90 paragrafi 2 të KPC që parashikon se: *“Askush nuk mund të përfaqësojë në një gjykim civil të drejtat e të tjerëve, përveç kur ligji parashikon ndryshe”*. Nëse do rezultojë se nuk kanë patur të drejtë të përfaqësojnë PDSH, pra nuk patur të drejtë, ndër të tjera ta përfaqësojnë as para gjykatave duke paraqitur kërkesa, atëherë ndodhemi para hipotezës se kërkesa është ngritur nga një subjekt (individ apo grup individësh) pa tagra përfaqësimi, siç parashikon neni 158/a paragrafi i parë dhe vendimi i gjykatës do duhej të ishte ai i parashikuar nga neni 297/ç dhe neni 298 paragrafi i parë i KPrC. Është saktësisht ajo çfarë thotë Gjykata e lartë në paragrafin 49 të vendimit të saj. Me fjalë të tjera do të duhet të kishte konstatuar, se ata që pretendonin se përfaqësonin PDSH në këtë kërkesë, në fakt nuk e përfaqësonin atë dhe se çështja ose do duhej pezulluar duke kërkuar të thirrej përfaqësuesi i vertetë ligjor i saj, (e që ishte dhe ka qënë gjithnjë kryetari i PDSH, Lulzim Basha) ose do duhej të pushohej si një gjykim që nuk mund të vazhdonte (madje as mund të fillonte).
101. Më konkretisht akoma, gjykata do duhej të analizonte të gjithë “zinxhirin” përfaqësues të kaluar “dorë pas dore”, që është treguar në kërkesë. Pra së pari nëse PDSH përfaqësohej në mënyrë të vlefshme nga një entitet i ashtuquajtur si “Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit” dhe së dyti nëse shtetasi Ivi Kaso përfaqësonte dot në mënyrë të vlefshme entitetin “KPR”.

102. Për të përcaktuar nëse PDSH përfaqësohej nga KPR, e më pas nëse KPR përfaqësohej në mënyrë derivative nga z. Ivi Kaso, që t'i drejtoheshin gjykatës për të kërkuar pasqyrim të ndryshimeve statutores të një partie, duhet përcaktuar në radhë të parë se cila është baza ligjore që aplikohet në këtë rast. Përgjigja gjendet në nenin 14 të ligjit Për Partitë Politike, në të cilin është parashikuar shprehimisht se: *“Dispozitat e këtij ligji për regjistrimin e partive politike janë njëlloj të vlefshme për ndryshimet dhe fshirjet në regjistrimet e mëparshme. Kërkesa për ndryshime në regjistrin e partive politike bëhet nga organi i partisë që ka në kompetencë përfaqësimin e saj ndaj të tretëve”*. Nga kjo dispozitë ligjore del qartë, se kërkesa drejtuar gjykatës bëhet nga një organ partie i cili e ka në kompetencë këtë përfaqësim ndaj të tretëve. Nje kompetence e tillë, për partitë politike, parashikohet në statutin e tyre. Thënë ndryshe, duhet marrë në analizë statuti në fuqi i PDSH në rastin konkret, për të konkluduar se cili organ partiak e ka patur këtë kompetencë përfaqësimi. Nga ana tjetër për të sqaruar, se cili është “statuti në fuqi” i PDSH, duhet saktësuar se cili është momenti kohor ku duhet bërë referimi (sepse mund të kenë ndodhur ndryshime në statut ndërkohe). Sigurisht duhet edhe sqaruar ligjërisht se çfarë kuptohet me “statut me fuqi”. Lidhur me momentin kohor se kur duhet “gjetur” ai “statut me fuqi juridike”, nga fjalia e fundit e nenit 14 të ligjit të partive politike, ky moment është koha kur “paraqitet një kërkesë për ndryshime në regjistrin e partive”. Pra në këtë moment procedural, apo me saktë akoma në momentin kur gjykata në veprimet paraprake, është e detyruar të shohë legjitimitimin e palës kërkuese, është e detyruar paraprakisht të marrë në analizë jo vetëm ligjin për partitë politike (ligj kuadër) por edhe statutin e tyre, tashmë të depozituar dhe regjistruar në regjistër (shih nenin 31 të Kodit Civil). Në mënyrë figurative, gjyqtari duhet të ketë domosdoshmërisht në tryezë, ligjin Për Partitë Politike nga njëra anë, dhe statutin e asaj partie, të cilin e merr nga zyra e regjistrimit të partive politike (prandaj edhe përdoret praktika e tërheqjes së dosjes së partisë politike, që administrohet nga vetë gjykata, që siç u sqarua me lart, gjyqtari në fjalë nuk e ka kryer këtë veprim, por e ka shqyrtuar çështjen pa e tërhequr dosjen e PDSH !!!). Vetëm duke analizuar statutin e partisë politike në fjalë, që është në fuqi në atë moment, do mund të arrijë në konkluzionin nëse kërkesa është bërë *“nga organi i partisë që ka në kompetencë përfaqësimin e saj ndaj të tretëve”*, siç urdhëron neni 14 i ligjit Për Partitë Politike. Thënë thjesht, duke parë statutin e PDSH, të depozituar në regjistrin e gjykatës, sipas përmbajtjes më të fundme të tij, do duhej të gjente në të nëse ekzistonte ndonjë organ partiak i PDSH me emërtimin “KPR” dhe nëse do ta gjente do duhej të shihte nëse kishte kompetencë statutores për ta përfaqësuar PDSH në mënyrë të vlefshme para të tretëve. Kaq e thjeshtë ka qenë detyra e gjykatës. Së dyti, vlen të saktësohet edhe koncepti i “statutit me fuqi” në atë moment. Kjo për faktin se në atë moment, kishte një tekst statutor të vetëm të vlefshëm dhe me fuqi juridike, e që ishte statuti i PDSH i miratuar dhe regjistruar në regjister në vitin 2018. Por kishte edhe disa ndryshime statutores të bëra në Kuvendin e PDSH të datës 17 korrik 2021 (për të cilin ishte paraqitur kërkesë në gjykatë për regjistrimin e tyre porse çështja ndodhej në dore të një gjyqtari tjetër që ende nuk e kishte dhënë vendimin për regjistrimin e tyre) dhe kishte madje edhe nje pretendim, për “nje statut” tërësisht tjetër, të prodhuar në “Kuvendin Kombëtar” të datës 11 dhjetor, ( e që ishte pikërisht ky që kërkohej të regjistrohej nga KPR (apo z. Ivi Kaso)). Gjykata pra duhet të saktësonte se cili nga këta tre tekste ishte ai që kishte fuqi juridike e që ishte i zbatueshëm. Përgjigja në këtë rast është e thjeshtë dhe e qartë. Tekst statutor që merr fuqi juridike dhe shtrin efektet e veta edhe ndaj të tretëve (pra edhe për gjykatën), është ai statut që në instancë të fundit pas regjistrimit nga gjykata, reflektohet (depozitohet) në zyrën e regjistrimit të partive politike në Gjykatën e shcallës së parë Tiranë. Kjo zyrë pra shërben edhe si “banka e dokumentacionit” autentik për dokumentacionin e partive politike. Çdo akt tjetër, qoftë edhe statut tjetër, i draftuar, apo i miratuar por ende i paregjistruar me vendim gjykate apo edhe i pa depozituar nuk përbën akt juridik me fuqi zbatuese. Ato janë thjesht “projekt amendamente staturore” nëse do huazonim praktikën e miratimit të ligjeve nga Kuvendi i Shqipërisë (dihet se momenti final i hyrjes në



fuqi të një ligji, është jo kur ai votohet në Kuvend, as kur depozitohet për dekretim te Presidenti i Republikës, as kur ky i fundit e shpall ligjin me dekret, as kur ligji i shpallur botohet në Fletoren Zyrtare, por në rastin kur kalon koha e caktuar (zakonisht prej 15 ditësh) nga botimi i ligjit në Fletoren Zyrtare). E njëjta logjikë vepron edhe në rastin e miratimit të një amendamenti statutor apo nje statuti të ri, nga një parti politike (ka një moment të parë të iniciativës, ka një moment të dytë të miratimit nga Kuvendi Kombëtar, ka një moment të tretë të paraqitjes së kërkesës në gjykatë, ka një moment të katërt të pranimit me vendim të gjykatës, dhe ka një moment të pestë kur vendimi i gjykatës merr formë të prerë dhe amendamenti statutor apo statuti tërësisht i ri, merr fuqi juridike për të tretët). Para se të shyrtojmë se a janë zbatuar këto detyrime të domosdoshme ligjore dhe statutore, më poshtë po paraqesim se si gjykata e Tiranës ka aplikuar këto parashikime ligjore dhe statutore në vendimin e saj.

103. Në paragrafin e parë të faqes 1 të vendimit Gjykata shprehet se: *“Pala kërkuese “PDSH” i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesën objekt shqyrtimi, e cila është regjistruar në datën 16/12/2021 dhe në vijim nënshtruar procedurave të shortit elektronik dhe kalimit të dosjes te Gjyqtari i çështjes.”*. E referojmë këtë paragraf të gjykatës për të vënë theksin në faktin që përveç citimit të palës kërkuese në pjesën relatuese të palëve dhe objektit të padisë është çmim i gjykatës, që kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve në statut dhe depozitimin e vendimeve, është paraqitur nga subjekti juridik “PDSH”.
104. Në lidhje me legjitimitetin e përfaqësuesit “Komisioni i përkohshëm i Rithemelimit” të kërkesës “PDSH” gjykata në faqet 2 dhe 3 të vendimit arsyeton se:
- *Gjykata vëren se kërkesa është paraqitur nga Komisioni i Rithemelimit i Partisë Demokratike, (nëpërmjet përfaqësuesit të saj të autorizuar) organ i cili cilësohet si organi i përkohshëm drejtues i Partisë Demokratike të Shqipërisë, zgjedhur dhe miratuar nga vendimarrjet e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë të datës 11.12.2021.*
  - *Gjykata sqaron se verifikimi i legjitimitetit të palëve, në përputhje me nenin 176 të K.Pr.Civile është detyrim thelbësor i procesit civil dhe në përmbushje të këtij detyrimi Gjykata pasi kreu verifikimin e aspektit formal të akteve të përfaqësimit duke i gjetur ato të rregullta dhe në përputhje me ligjin procedural.*
  - *Për sa i përket të drejtës aktive të Komisionit të Rithemelimit për t’iu drejtuar gjykatës si organi drejtues dhe përfaqësues i PDSH, Gjykata thekson se në përputhje me dispozitat e ligjit “Për Partitë Politike”, neni 9, 10 e vijues, si dhe bazuar në praktikën gjyqësore të regjistrimeve të ndryshimeve në partitë politike, Gjykata nuk ka rol aktiv në emërimin/ndryshimet apo shkarkimet e organeve drejtuese apo të zgjedhurve në partitë politike, por ushtron vetëm kontrollin formal të ligjshmërisë së ndryshimeve statutore dhe verifikimin e respektimit të kërkesave të ligjit apo të statutit në proceset vendimarrëse të cilat pasqyrohen në regjistrin e partive politike.*
  - *Thënë ndryshe, nuk është vendimi gjyqësor që u jep të drejtën organeve të partisë apo të emëruarve në postet partiake për të ushtruar funksionet e tyre, por gjykata kontrollon dhe çertifikon a posteriori, të drejtën e tyre për të ushtruar kompetencat organike dhe statutore që nga momenti i konstituimit.*
  - *Sa më sipër përbën një fakt gjerësisht të njohur, të mbështetur në praktikën ndër vite të partive politike (duke përfshirë edhe palën kërkuese), në dispozitat statutore të cilat hyjnë në fuqi menjëherë me miratimet e tyre në forumet vendimarrëse të partisë si edhe mbi të*

*gjitha në vetë disponimet e nenit 9 të Ligjit nr.8580 dt.17.02.2000 "Për Partitë Politike" të ndryshuar i cili shprehet se: "Partia politike njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë. Deri në datën e regjistrimit, themeluesit e partisë mund të kryejnë veprime që janë të nevojshme për organizimin e saj, siç janë, sidomos, thirrja e zhvillimi i mbledhjes së themeluesve dhe zgjedhja e organeve drejtuese, por nuk mund të kryejnë veprimtari si parti politike".*

- *Dispozita e sipërcituar e interpretuar për analogji edhe në rastet e regjistrimeve të mëvonshme (sipas nenit 14 të Ligjit nr.8580 dt.17.02.2000 "Për Partitë Politike" të ndryshuar) - sqaron qartazi që veprimtaria e brendshme organizative (zgjedhja e organeve drejtuese) e partive politike nuk kushtëzohet nga miratimi dhe regjistrimi gjyqësor, por ky i fundit nevojitet detyrimisht për çertifikimin e ligjshmërisë në këto procese dhe legjitimimin ndaj të tretëve.*
- *Bazuar në sa më sipër, në analizë të rastit objekt shqyrtimi, Komisioni i Rithemelimit legjitimohet në aspektin paraprak formal të paraqitjes së kërkesës dhe vënies në lëvizje të gjykatës si organ i zgjedhur dhe i emëruar nga Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike të Shqipërisë, por legjitimimi substancial bëhet nga verifikimi material nga ana e gjykatës i ligjshmërisë dhe i respektimit të normave statutore në thirrjen, mbledhjen dhe vendimarrjen e Kuvendit Kombëtar të PDSH të datës 11.12.2021.*

105. Nga analiza e arsytimit të mësipërm konstatojmë se nga ana e gjykatës është relativ fakti që kërkesa në emër e për llogari të subjektit juridik "PDSH" është paraqitur nga një organ i këtij subjekti i quajtur "Komisioni i Përkohëshëm i Rithemelimit". Ndonëse gjykata pretendon se ka analizuar legjitimitetin e këtij organi në përputhje me parashikimet e nenit 176 të Kodit të Procedurës Civile vlerësojmë se arsytimi, zbatimi i dispozitave ligjore dhe përfundimet e arritura nga gjykata janë të gabuara.
106. Ajo çfarë gjykata me dashje ka neglizhuar, ka qenë fakti, nëse një entitet i quajtur "KPR" kishte të drejtë t'i drejtonte një kërkesë gjykatës për ta investuar atë apo jo, në emër e për llogari të PDSH, siç kërkon neni 90/2 i KPC dhe neni 31 i Kodit Civil. Për këtë çështje gjykata as që e ka marrë parasysh e nuk ka analizuar statutin e PDSH, që ishte në fuqi në atë moment. Këtu pra bëhet fjalë pikërisht për parakushtet formalo-juridike të paraqitjes së kërkesës, në mënyrë që nëse gjendej se ekzistonin atëherë të kalonte në fazën pasardhëse, pra të shqyrtonte rregullshmërinë e thirrjes së Kuvendit, vlefshmërinë e mbledhjes së tij, vlefshmërinë e produktit të tij e me radhë.
107. Statuti i PDSH, i depozituar në gjykatën e Tiranës, në atë moment, parashikonte se i vetmi organ partiak, që kishte të drejtë të përfaqësonte PDSH para të tretëve pra edhe para gjykatës, duke paraqitur kërkesa, ishte vetëm kryetari i partisë dhe askush tjetër! Vetëm një kërkesë e bërë nga kryetari i partisë do të plotësonte këto parakushte formalo-juridike që bën fjalë Gjykata e Lartë në vendimin e saj. Përndryshe kërkesa do të ishte e paplotë sepse kërkuesi (kushdo të ishte ai, individ apo organ partiak, i ndryshëm nga kryetari i partisë) nuk do legjitimohej formalisht të paraqiste kërkesën dhe as të fillonte një gjykim prej gjykatës. Detyra e vetme e gjykatës në këtë moment do ishte të konstatonte, që vetëm një organ partiak i PDSH kishte të drejtë të përfaqësonte dhe të bënte kërkesa para gjykatës, dhe ky ishte Kryetari i saj, dhe të verifikonte se kush ishte kryetar i PDSH në atë moment! Asgjë më shumë. Ky verifikim kyç nuk është bërë!

108. Vetëm nëse do dilte e sukseshme analiza, që KPR ishte një organ partiak që ekzistonte paraprakisht në statut (në statutin në fuqi, pra të depozituar më parë në gjykatë) dhe se nëse do kishte edhe kompetenca për të paraqitur kërkesa në gjykatë, atëherë gjykata duhej të kishte analizuar më pas themelin e kërkesës (objektin e saj) pra vlefshmërinë e “statutit të ri” që kërkohej të regjistrohej dhe të vendimeve të tjera. Në fakt këtu qëndron edhe paradoksi logjik dhe ligjor, që në mënyrë figurative mund të shprehet si: “fëmija ende nuk kishte lindur juridikisht e kështu që nuk mund të paraqitej (as të paraqiste) një kërkesë për regjistrimin e lindjes së vet”. Për këtë shkak, kërkesës i mungojnë parakushtet formale – juridike, siç kërkon neni 90/2 i KPC i kombinuar me nenin 31 të KC. Mjafton ky shkak për të arritur në konkluzionin se kërkuesi nuk legjitimohej në aspektin procedural.
109. Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit është ngritur dhe miratuar me një vendim me numër 4, datë 11.12.2021 të një mbledhje që pretendohet se është “Kuvend Kombëtar i Partisë Demokratike”. Ky fakt nënkupton që gjykata përpara se të vlerësonte legjitimitetin e përfaqësuesit të palës kërkuese ishte e detyruar (në referencë edhe të kërkesës së paraqitur në gjykim) të vlerësonte fillimisht nëse:
- procedura për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar ishte në zbatim dhe konform parashikimeve statutore, në lidhje me procedurën e mbledhjes, numrin e kërkuësve, cilësinë e kërkuësve, afatet e njoftimit etj;
  - mbledhja, punimet dhe vendimarrjet e Kuvendit Kombëtar ishin në zbatim dhe konform parashikimeve statutore, në lidhje me numrin e pjesëmarrësve, cilësinë e pjesëmarrësve, procedurat e votimit, etj;
  - baza statutore mbi të cilën është propozuar dhe më pas marrë vendimi për ngritjen e Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit,
  - tagrat vendimarrëse të Kuvendit Kombëtar në zbatim të dispozitave të Statutit të miratuar me 17 korrik 2021, apo dispozitave të statutit që pretendohet se është miratuar në 11 dhjetor 2021;
  - momentin kohor të hyrjes në fuqi të statutit të pretenduar të miratuar më 11 dhjetor 2021 dhe përbërjen e Kuvendit Kombëtar pas hyrjes në fuqi të këtij statutit, tagrat e Kuvendit Kombëtar të mbledhur më 11 dhjetor 2021 pas miratimit të Statutit sipas vendimit numër 1 të këtij Kuvendi.
110. Mungesa e analizës së pikave të sipërcituara ka çuar në legjitimitimin e përfaqësuesit të kërkuësit, ose e thënë në kontekstin e kërkesës së paraqitur në gjykatë (pika 2 e dispozitivit të vendimit numër 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë), të pranimit apriori të objektit të padisë dhe certifikimit të vendimit numër 4, datë 11 dhjetor 2021 të Kuvendit Kombëtar përpara marrjes në shqyrtim të vetë objektit të padisë.
111. Legjitimiteti i përfaqësuesit të kërkuësit, sikurse referon edhe gjykata në nenin 176 të Kodit të Procedurës Civile, është parakusht për fillimin e procesit të gjykimit të themelit të kërkesës e duhet të provohet nga pala dhe të verifikohet nga gjykata përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Në rastin objekt gjykimi jemi në kushtet kur nga gjykata është pranuar legjitimiteti i përfaqësuesit të palës kërkuese, legjitimitet i provuar me anë të provave të depozituara si pjesë e kërkesës për shqyrtim gjyqësor, përpara se këto të fundit t’i nënshtroheshin shqyrtimit nga vetë gjykata nëpërmjet procesit.
112. Në rastin objekt shqyrtimi gjyqësor rezulton se organi kolegjal Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit është formuar në bazë të një vendimi të marrë nga një organ i cili nuk është formuar konform parashikimeve statutore.

113. Duke marrë në kronologji vendimet e marra nga Kuvendi Kombëtar i datë 11 dhjetor 2021 rezulton se vendimi numër 1 (faqe numër 8 e dosjes gjyqsore) i marrë nga ky kuvend është vendimi për miratimin e ndryshimeve në Statut. Në vendim përcaktohet se: *“Në mbështetje të nenit 60 dhe 43/3 të Statutit të Partisë Demokratike të Shqipërisë me propozim të një grupi anëtarësh të Këshillit Kombëtar të cilët përfaqsojnë ¼ e gjithë anëtarësisë së tij Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike VENDOSI: 1. Miratimin në parim të Statutit të Partisë Demokratike sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi. 2. Miratimin nen për nen të Statutit të Partisë Demokratike sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi. 3. Miratimin në tërësi të Statutit të Partisë Demokratike sipas aneksit bashkëlidhur këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.”*. Statuti i miratuar në Kuvendin Kombëtar të datës 17 korrik 2021 në nenin 43 të tij përcakton se: *“1. Kuvendi Kombëtar është organi më i lartë vendimmarrës i Partisë, që përbëhet nga: a) Kryetarët e seksioneve të Partisë Demokratike dhe sekretarët e grupseksioneve të Partisë Demokratike; b) Anëtarët e Kryesive të degëve, përfshirë anëtarët e Bordit të Këshilltarëve të Degës; c) Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike; ç) Anëtarët e Kryesisë së Partisë; d) Deputetët e Partisë Demokratike në Kuvendin e Shqipërisë; dh) Kryetarët e Bashkive, Prefekti, Kryetari i Qarkut, dhe këshilltarët vendorë, anëtarë të PDSH-së; e) koordinatorët tematikë apo koordinatorët e procesit zgjedhor në Degët e Partisë Demokratike, si dhe funksionarët e Selisë Qendrore të Partisë Demokratike; ë) Një numër i kufizuar përfaqësuesish të organizatave partnere në numër të barabartë jo më shumë se 5 për qind e numrit të anëtarëve të tjerë të Kuvendit Kombëtar.”*. Në statutin e miratuar me datë 11 dhjetor 2021 dispozita që rregullon përbërjen e Kuvendit Kombëtar është neni 42 i cili parashikon se: *“Kuvendi është organi më i lartë vendimmarrës i Partisë, që përbëhet nga 1100 (njëmijë e njëqind) anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendet e degëve të PDSH sipas një numri të përcaktuar për çdo degë nga Kryesia e PDSH. Lista e kandidatëve për delegatë në Kuvendin Kombëtar e paraqet në Kuvendin e Degës nga Kryesia e saj. Janë delegatë të Kuvendit Kombëtar: a) Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike; b) Anëtarët e Kryesisë së Partisë Demokratike; c) Deputetët e Partisë Demokratike në Kuvendin e Shqipërisë; ç) Anëtarët e qeverisë që janë anëtarë të Partisë Demokratike; d) Kryetarët e Bashkive, Prefekti, Kryetari i Qarkut, anëtarë të PDSH-së; dh) Një numër përfaqësuesish të organizatave partnere në numër të barabartë jo më shumë se 10 (dhjetë) për qind e numrit të anëtarëve të tjerë të kuvendit;”*. Statuti i miratuar me datë 11 dhjetor 2021 gjithashtu në fund të tij parashikon se: *“Ky statut hyn në fuqi menjëherë”*. Nga analiza e mësipërme, provat e depozituara në gjykim dhe pretendimet e përfaqësuesit të kërkuarit rezultojnë pretendimi se Kuvendi i datës 11 dhjetor 2021 është mbledhur duke pasur në përbërje të tij delegatë të zgjedhur dhe të caktuar në bazë të parashikimeve të Statutit të miratuar me datë 17 korrik 2021. Rezultojnë gjithashtu që Kuvendi i datës 11 dhjetor 2021 me vendimin numër 1 të tij ka miratuar ndryshimet në Statutin e Partisë Demokratike e për pasojë, për shkak të ndryshimeve të nenit 43 në nenin 42 ka ndryshuar edhe numrin e përgjithshëm dhe mënyrën e zgjedhjes së delegatëve (pjesëmarrësve me të drejtë vote) në Kuvendin Kombëtar. Me marrjen e vendimit numër 1 për miratimin e Statutit dhe hyrjen në fuqi të tij (hyrje në fuqi e cila ka ndodhur menjëherë me miratimin e Statutit, sikurse pretendohet edhe nga vetë Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit në Kërkesën për regjistrim dhe në Apelin Kundërshtues paraqitur përpara kësaj gjykate) të gjithë delegatët pjesëmarrës në Kuvendin e 11 dhjetorit e kanë humbur cilësinë e tyre si të tillë për shkak nga njëra anë të numrit të përgjithshëm të delegatëve dhe nga ana tjetër për shkak të ndryshimit të mënyrës së zgjedhjes së tyre. Me marrjen e vendimit numër 1 për miratimin e Statutit, Kuvendi Kombëtar duhet të shpërndahej dhe nuk mund të merrte më asnjë vendim të mëtejshëm. Për pasojë edhe vendimi numër 4 i Kuvendit të datës 11 dhjetor 2021 me të cilin është formuar, përfaqësuesi i kërkuarit, Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit është një vendim i pavlefshëm pasi i është marrë nga një organ që nuk ekzistonte më sipas

parashikimeve statutore. Hyrja e menjëhershme në fuqi të Statutit të miratuar me vendimin numër 1 të datës 11 dhjetor 2021 provohet edhe nga fakti që propozimet për marrjen e vendimeve nga 2 deri në 7, Shkresa me lëndë “Propozim për vendimarrje Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të datës 11.12.2021” (faqe 47 e dosjes gjyqësore) përdor si bazë ligjore nenet 42 dhe 43 të Statutit. Ky fakt provon që vendimi numër 4 i datës 11 dhjetor 2021 është një vendim që është marrë nga delegatë të cilët nuk e gëzon më cilësinë e delegatit për shkak të ndryshimeve të nenit 42 mbi numrin dhe mënyrën e formimit të Kuvendit Kombëtar.

114. Përpos sa relatuar më sipër nga dispozitat e Statuteve të 17 korrikut dhe 11 dhjetorit rezulton se Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit është një organ kolegjal që parashikohet në nenet 64 dhe 65 të Statutit të miratuar me datë 11 dhjetor 2021. Ky organ nuk ka ekzistuar më parë në strukturën statutore dhe organike të Partisë Demokratike. Si pasojë legjitimiteti i këtij organi mund të pranohej vetëm pas shqyrtimit gjyqësor të ligjshmërisë së vendimit numër 1 të Kuvendit Kombëtar të datës 11 dhjetor 2021 dhe jo përpara fillimit të shqyrtimit gjyqësor sikurse është bërë nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin numër 3, datë 25.03.2022.
115. Neni 64 i Statutit të miratuar me Kuvendin e datës 11 dhjetor 2021 parashikon se: “Neni 64 – Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit – 1. Menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Statuti dhe deri në përfundim të konstituimit të organeve të reja sipas tij, por jo më shumë se për katër muaj, drejtimi ekzekutiv i partisë bëhet nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit. 2. Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit përbëhet nga 29 anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendi Kombëtar, mes personaliteteve me kontribute dhe autoritet të padiskutueshëm në PDSH. Ky Komision ushtron të gjitha kompetencat të cilat sipas këtij statuti i takojnë organeve qendrore të PDSH, me përjashtim të atyre që i takojnë Kuvendit Kombëtar...”. Në analizë të këtyre parashikimeve rezulton që ka një kufizim të tagrave që i janë dhënë Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit përse i përket tagrave që ai ka në raport me të tretët. Në pikën 1 të nenit 64 përcaktohet se Komisioni do të ushtrojë vetëm kompetencat e drejtimit ekzekutiv të partisë dhe jo ato të përfaqësimit të saj me të tretët. Ky fakt provohet edhe nga vendimi numër 7 i Kuvendit i cili i ka kaluar Komisionit tagrat e për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave për regjistrimin e ndryshimeve statutore dhe vendimeve të Kuvendit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga analiza e akteve të mësipërme rezulton se tagrat e Komisionit për t’ju drejtuar Gjykatës së Tiranës nuk burojnë nga e drejta e përfaqësimit me të tretët, si një e drejtë ekskluzive e Kryetarit të Partisë por nga vendimi numër 7 i Kuvendit Kombëtar të datës 11 dhjetor 2021. Duke marrë në rend kronologjik të gjitha statutet e regjistruara të PDSH nuk rezulton që në asnjërin prej tyre Kuvendit Kombëtar t’i jenë njohur tagra të përfaqësimit me të tretët. Për pasojë autorizimi që KPR pretendon se ka, e me të cilin është vënë në lëvizje Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë është nul dhe i pavlefshëm dhe në shkelje të parimit mbi bazën e të cilit i përfaqësuarit nuk mund t’i kalojë përfaqësuesit tagra apo të drejta që ai vetë nuk i zotëron.
116. Duke qenë se KPR, rezulton se nuk ka qenë asfare një organ partiak i PDSH, (sipas statutit në fuqi të PDSH), dhe aq më pak të ketë patur kompetencë përfaqësimi për të tretët, pra edhe për gjykatën, rezulton për rrjedhojë se është nul edhe vetë “autorizimi” që KPR apo “nje grup prej 29 individësh” pretendojnë se i kanë dhënë z. Ivi Kaso, i cili është personi që ka nënshkruar kërkesën drejtuar Gjykatës. Kujtojmë këtu se “autorizimi” i pretenduar është një shkresë e thjeshtë e nënshkruar nga 29 individë, jo para noterit dhe e “vulosur” me një vule që nuk i përket dhe as identifikon PDSH. Pra pretendohet në këtë mënyrë se është një autorizim si ata që lëshon një person juridik (shih nenin 72/2 të Kodit Civil). Çështja e parë për analizim në këtë rast është se, a ishte në vetvete KPR një person juridik, apo thjesht një grupim informal individësh? Kjo çështje ka rëndësi, sepse nëse KPR është thjesht një grupim informal

individësh, pa personalitet juridik, atëherë akti i autorizimit duhet të ishte në formën e një prokure e cila sipas Kodit Civil përpilohet para noterit. Nëse pranohet se “KPR” është një person juridik dhe si tillë aktet e përfaqësimit i lëshon edhe në formën e autorizimit (sic parashikon Kodi Civil) atëherë do të konsiderohet i rregullt autorizimi i shtetasit Ivi Kaso. Por kjo alternativë kërkon që paraprakisht KPR të kishte qenë person juridik. Ose njëra ose tjetra alternativë është e vlefshme. Nëse KPR nuk rezulton të ketë personalitet juridik atëherë edhe në vetvete “autorizimi” jo noterial lëshuar z. Ivi Kaso është i pavlefshëm, e për këtë arsye kërkesa do duhej konsideruar me të meta në aspektin procedural dhe në aspektin substancial ai që ka paraqitur kërkesën nuk do kishte zotësinë juridike për ta paraqitur e për pasojë kërkesa do duhej pushuar në instancë të fundit edhe për këtë mangësi, veç të tjerave më lart. Po kështu do duhej të ishte vepruar, nëse KPR konsiderohet jo një “person juridik” por një grupim individësh. Në këtë rast që z. Ivi Kaso t’i përfaqësonte në mënyrë të vlefshme, së paku ata, do duhej të kishte jo “autorizim” por “prokurë” të përpiluar para noterit, që në fakt nuk e ka e për këtë shkak kërkesa përsëri do duhej të kthehej për plotësim apo në instancë të fundit të pushohej gjykimi.

## VI. MBI ZBATIMIN E NENIT 392 TË KPRC

117. Më datë 24.12.2021, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është protokolluar shkresa me numër 168/1, datë 22.12.2021 e Partisë Demokratike e Shqipërisë e përfaqësuar nga Kryetari Lulzim Basha. Me anë të kësaj shkrese drejtuar Gjyqtarit Agron Zhukri organi përfaqësues i Partisë Demokratike, Kryetari, vë në dijeni Gjykatën si vijon:

- *“Disa ish-funksionar të PDSH, kanë keqpërdorur simbolet dhe vulat e Partisë Demokratike, në kundërshtim me Statutin e Partisë dhe legjisllacionit në fuqi. Nisur nga njoftimi i bërë nga Gjykata e Tiranës, krijohet dyshimi i arsyeshëm që veprimtaria e tyre, është shtrirë edhe në paraqitjen e akteve të falsifikaura në Gjykatën e Tiranës. Sipas nenit 7 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike”, ndalohet regjistrimi i një partie në rastet kur me të njëjtin emërtim është regjistruar një parti tjetër.*
- *Gjithashtu ju bëj me dije, që shkelja e çdo procedure në shqyrtimin e “kërkesave” të tilla, si dhe mosrespektimi i këtij ndalimi sjell pasoja të rënda në drejtimet e mëposhtme:*
  - *Lirinë kushtetuese për t’u organizuar të çdo anëtari të PDSH-së, e cila është garantuar nga neni 46 i Kushtetutes së Republikës së Shqipërisë;*
  - *Lirinë kushtetuese të vetë PDSH-së për të ushtruar veprimtarinë e saj sipas nenit 9 të Kushtetutes të RSH-së.... (omississ)*
- *...Sipas statutit të Partisë Demokratike, asnjë grupim i papërkufizueshëm nuk kanë tagra përfaqësimi nga PDSH në bazë të nenit 14 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike” të ndryshuar dhe me anë të kësaj kërkesë, ju drejtohem për t’ju informuar se nuk kemi depozituar asnjë kërkesë dhe çdo pretendim i ndryshëm duhet të pushohet.*
- *Nëse një grup personash të paautorizuar kanë pretendime të çfarëdolloj natyre, sjell në vëmendje se ato duhen shqyrtuar dhe vendosur në gjykim themeli me palë paditëse dhe palë të paditur në zbatim të nenit 154 të Kodit të Procedurës Civile dhe jo nëpërmjet një procedure regjistrimi, e cila vihet në lëvizje vetëm nga organet e autorizuar të partisë politike. Rrjedhimisht, edhe për këtë shkak, gjykimi i çështjes duhet të pushohet.*
- *Për sa i përket përfaqësimit po i referohemi dhe dispozitave të nenit 92 të Kodit të Procedurës Civile në të cilën parashikohet se: “Personat juridikë marrin pjesë në*

*gjykim me anë të atij që i përfaqëson, sipas dispozitave ligjore”. Në zbatim të kësaj dispozite po i referohemi dhe përcaktimeve të nenit 65 të Kodit Civil në të cilën parashikohet ndër të tjera se “Tagret e përfaqësimit ligjor caktohen nga dispozitat e ligjit që i japin këtë cilësi, ndërsa tagret e përfaqësuesit të emëruar nga i përfaqësuari caktohen me prokurë”.*

- *Në rastin konkret, për tagrat e përfaqësimit duhet t’i referohemi nenit 14 të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar, në të cilën parashikohet se: “Dispozitat e këtij ligji për regjistrimin e partive politike janë njëlloj të vlefshme për ndryshimet dhe fshirjet në regjistrimet e mëparshme. Kërkesa për ndryshime në regjistrin e partive politike bëhet nga organi i partisë që ka në kompetencë përfaqësimin e saj ndaj të tretëve”.*
- *Për ta qartësuar më tej këtë dispozitë ligjore i referohemi dhe Statutit të PDSH-së i cili është miratuar në datën 17.07.2021, që më konkretisht neni 46 i tij që parashikon se: “I. Kryetari i Partisë kryeson organet qendrore të Partisë dhe siguron zbatimin e vendimeve të tyre. Ai përfaqëson Partinë në të gjitha veprimtaritë publike e politike, të brendshme dhe ndërkombëtare.”*
- *Për sa referuam më sipër rezulton se ky grupim personash që i janë drejtuar gjykatës nuk kanë asnjë tagër përfaqësimi si persona të autorizuar për të përfaqësuar PDSH-në dhe për të bërë kërkesa të tilla. Rrjedhimisht kjo kërkesë nuk duhet të merret në shqyrtim nga ana e kësaj gjykate pasi kërkuuesi nuk ka legjitimitet aktiv.*
- *Gjithashtu kjo kërkesë është nga ato kërkesa që gjykohen pa prezencën e palëve dhe ndjekin të njëjtën procedurë me atë të gjykimit të posaçëm të vërtetimit të faktit pasi gjykata vihet në lëvizje vetëm me kërkesë. Në këto kushte gjykata duhet t’i referohet nenit 392 të K.Pr. Civile që parashikon se: “Kur, gjatë shqyrtimit të kërkesës, lind një konflikt midis kërkuetit dhe një personi tjetër të interesuar, për të drejtën civile që ka lidhje me vërtetimin e faktit, gjykata vendos pushimin e shqyrtimit të çështjes. Në këtë rast palët mund t’i drejtohen gjykatës me padi sipas rregullave të përgjithshme”.*
- *Për sa më sipër si dhe në zbatim të nenit 7 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar, ndalohet regjistrimi i një partie në rastet kur me të njëjtin emërtim është regjistruar një parti tjetër.*
- *Duke qenë se dispozitat ligjore të referuara më lart ju ndalojnë të merrni në shqyrtim këtë kërkesë kërkojmë nga ana juaj që të vendosni pushimin e saj si një kërkesë e pabazuar në ligj. Nëse ky grupim personash pretendojnë cënimin e të drejtave ligjore dhe procedurale ata do të duhet që t’i drejtohen gjykatës me padi themeli me anë të së cilës të kërkojnë rivendosjen e të drejtave të pretenduara në një proces të rregullt ligjor.”.*

118. Paraqitja e kësaj kërkesë në gjykatë, nga organi përgjegjës sipas ligjit dhe Statutit, për përfaqësimin e partisë politike “PDSH”, e vendos gjykatën përpara dy çështjeve:

- a. Konfirmimit se për shqyrtimin e kërkesës një person tjetër e interesuar ka shfaqur pretendime mbi vërtetësinë e kërkesës dhe cilësinë e përfaqësimit;
- b. Konfirmimit se gjatë shqyrtimit të kërkesës, është paraqitur një kërkesë tjetër që provon lindjen e një konflikti midis kërkuetit dhe një personi tjetër të interesuar, për të drejtën civile që ka lidhje me vërtetimin e faktit.

119. Në këtë kuadër, gjykata kishte detyrimin ligjor të zbatonte nenin 392 të Kodit të Procedurës Civile.

120. Kërkesa me nr.168/1 Prot., datë 22.12.2021, e Partisë Demokratike të Shqipërisë, dërguar nga organi përfaqësues Kryetari i Partisë, sipas regjistrimit të partive politike, provon qartë se për

shqyrtimin e kërkesës kishte persona të interesuar që tërhiqnin interesa të ligjshëm dhe në këtë rast vetë organet legjitime të Partisë Demokratike të Shqipërisë. Për këtë shkak, ka patur detyrimin të thërrasë gjatë shqyrtimit të kërkesës “Partinë Demokratike të Shqipërisë”, përfaqësuar nga Kryetari i saj z. Lulzim Basha. Mirëpo, shqyrtimi i kërkesës u bë pa njoftuar dhe pa praninë e palës së interesuar me qëllimin e vetëm për t’i mohuar të drejtat dhe për të dhënë një vendim në kundërshtim të hapur me dispozitat ligjore dhe në kundërshtim të hapur me përcaktimet e ligjit 8580/2000 “Për Partitë Politike”. Gjykata nuk ka marrë në shqyrtim dhe nuk ka kthyer asnjë përgjigje lidhur me kërkesën nr. 168/1 Prot., datë 22.12.2021.

121. Gjithashtu me datë 24.03.2023, pasi ishim njohur me vendimin e Gjykatës për caktimin e seancës gjyqësore të datës 25.03.2023 me shkresën numër 2245 prot (faqe 102 dhe 116 e dosjes gjyqësore) PDSH ka vënë në dijeni gjyqtarin Zhukri për mosregjistrimin e ndryshimeve statutore të datës 17.07.2021, si dhe me kërkesën për t’u thirrur si subjekt i interesuar në procesin gjyqësor (faqe 103 e dosjes gjyqësore). Subjekti PDSH nëpërmjet përfaqësuesit të tij ka kërkuar shprehimisht thirrjen në procesin gjyqësor për shkak të interesit të ligjshëm. Bashkëlidhur kësaj kërkesë është ankimi i depozituar ndaj vendimit për regjistrimin e ndryshimeve statutore të datës 17.07.2021 si dhe autorizimet përkatëse të nënshkruesit të kërkesës. Në faqen e dytë të shkresës subjekti PDSH arsyeton se: *“Gjithashtu duke qënë se jemi palë që kemi interesa në shqyrtimin e kërkesës nga ana Juaj kërkojmë që të thërritemi në këtë proces si palë e tretë në këtë gjykim pasi tërheqim interesa të ligjshëm dhe kjo e fundit pretendohet se është bërë në emër të Partisë Demokratike”*. Pra rezulton e provuar që jo vetëm në mënyrë të tërthortë por edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë PDSH nga njëra anë ka vënë në dijeni Gjykatën për ekzistencën e një interesi të ligjshëm në procesin që zhvillohej, por edhe ka kërkuar përfshirjen në këtë proces në formë të shkruar. Pretendimi për shprehjen e interesit të ligjshëm dhe detyrimin e gjykatë së shkallës së parë për pushimin e gjykimit dhe orientimin e palëve drejt një gjykimi në themel të çështjes është arsyetuar edhe nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj ku në pikën 55 arsyeton se: *“55. Në rast se Gjykata e Apelit ka arritur në konkluzionin se në themel të këtij gjykimi, qëndron përcaktimi se kush është juridikisht organi ligjor që përfaqëson tek të tretët subjektin juridik PDSH, kjo gjykatë, duhet të kishte vendosur pushimin e gjykimit, duke orientuar palët që të zhvillojnë një gjykim themeli mes tyre (gjykim kontencioz).”*. Ky interpretim i Gjykatës së Lartë lidhet me interpretimin e saj se në këtë gjykim ka vetëm një palë e cila është subjekti juridik Partia Demokratike e Shqipërisë dhe se thelbi i konfliktit gjyqësor është e drejta e përfaqësimit të këtij subjekti. Në këtë drejtim, ky konflikt nuk mund të zgjidhet në kushtet e një gjykimi gracioz, shkak për të cilin me të drejtë gjykata arsyeton se gjykimi duhet të ishte pushuar dhe palët duhet të ishin orientuar kah një gjykim kontencioz të pretendimeve të tyre.

122. Gjykata e Lartë në vendimin 768 ka përcaktuar qartësisht se në rastin objekt shqyrtimi gjyqësor jemi në kushtet e një gjykimi gracioz në të cilin zbatohet nenet 388 – 392 të Kodit të Procedurës Civile. Neni 392 i KPrC parashikon se: *“Kur, gjatë shqyrtimit të kërkesës, lind një konflikt midis kërkuesit dhe një personi tjetër të interesuar, për të drejtën civile që ka lidhje me vërtetimin e faktit, gjykata vendos pushimin e shqyrtimit të çështjes. Në këtë rast palët mund t’i drejtohen gjykatës me padi sipas rregullave të përgjithshme”*. Ligjvënësi në formulimin e nenit 392 ka përdorur tofjalëshin “lind një konflikt” pa dhënë një referencë të qartë mbi mënyrën se si duhet të përkufizohet ky konflikt apo mbi aktet me të cilat gjykata duhet të vihet në dijeni të ekzistencës së konfliktit. Krijimi i një hapësire kaq të gjerë diskrecionare ndaj gjykatës është pikërisht për shkak të vetë llojit të gjykimit gracioz dhe të mjeteve të kufizuara procedurale që një palë e interesuar ka në raport me llojin e gjykimit. Në kushtet kur gjykata njoftohet në formë shkresore për pretendimet të ngritura nga një subjekt, i cili *prima facia*, duket se gëzon një interes të ligjshëm në raport me faktin që kërkohet të vërtetohet në gjykatë,



kjo e fundit ka detyrimin për zbatimin e nenit 392 të KPrC. Gjykata si e tillë dhe Gjyqtari Zhukri në veçanti janë njoftuar në mënyrë të përsëritur mbi interesin e ligjshëm të subjektit juridik PDSH, i njëjtë me subjektin që *prima facia* kishte depozituar edhe kërkesën objekt shqyrtimi, e për pasojë duhet të vlerësoje përmbushjen e kushtit të parashikuar nga neni 392 duke vendosur pushimin e gjykimit dhe orientimin e palëve për zgjidhjen e konfliktit me padi themeli.

## VII. MBI SEANCËN GJYQËSORE

123. Kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve statutove është zhvilluar me datë 25.03.2022. Sipas procesverbalit të seancës gjyqësore (faqet 348 – 350 të dosjes gjyqësore) kjo e fundit ka filluar në ora 10.30 minuta dhe ka përfunduar në ora 11.10 minuta për një kohëzgjatje totale prej 40 (dyzet) minutash.
124. Procesverbali i seancës gjyqësore mund të ndahet lehtësisht në disa pjesë. Pjesa e parë është ajo procedurale në të cilën bëhet verifikimi i pranisë së palëve, verifikimi i legjitimitetit të tyre dhe shpallja e trupit gjykues. Pjesa e dytë që është ajo e shqyrtimit gjyqësor të çështjes. Pjesa e tretë e administrimit të provave. Pjesa e katërt e mbylljes së shqyrtimit gjyqësor dhe paraqitjes së pretendimeve përfundimtare të palëve dhe Pjesa e pestë shpallja e vendimit.
125. Në pjesën e parë nga analiza e procesverbalit të seancës nuk rezulton që nga ana e trupës gjykuese të jetë bërë verifikimi i legjitimitetit të përfaqësuesit të kërkuarit. Gjykata relaton se: “U paraqit pala kërkuar përfaqësuar në gjykim me autorizimin numër 01 prot, datë 13.12.2021 nga Ivi Kaso”. Autorizimi i cili citohet nga gjykata është autorizimi i lëshuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit. Ky autorizim përcakton se: “*Autorizim me të cilin autorizojmë Z.Ivi Kaso dhe z. Çlirim Gjata, të cilët, të dy së bashku ose veç e veç, kanë të drejtë të depozitojnë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dokumentacionin përkatës dhe kërkesën me objekt: “Depozitim ndryshimesh statutove dhe vendimarrje të Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021”, si dhe të përfaqësojnë Komisionin e Përkohshëm të Rithemelimit të PD dhe Partinë Demokratike në shqyrtimin e kësaj çështje para gjykatave të të gjitha niveleve*”. Sikurse vihet re nga teksti i autorizimit ky i fundit është lëshuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit për përfaqësimin e këtij organi dhe të Partisë Demokratike. Ky autorizim është marrë nga trupi gjykues pa iu nënshtruar analizës lidhur me cilësitë e Komisionit, vlefshmërinë juridike të tij dhe tagrat e këtij të fundit për të përfaqësuar subjektin Partia Demokratike ndaj të tretëve. Neni 14 i ligjit 8580, datë 17.2.2000, “Për “Partitë Politike”, paragrafi i dytë përcakton se: “*Kërkesa për ndryshime në regjistrin e partive politike bëhet nga organi i partisë që ka në kompetencë përfaqësimin e saj ndaj të tretëve*”. Duhet të sjellim në vëmendje të trupit gjykues se nga ana Gjykatës ishte pezulluar gjykimi i çështjes për shkak të pamundësisë së tërheqjes së dosjes së subjektit politik Partia Demokratike nga Zyra e OJF në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Domosdoshmëria e pasjes së dosjes së subjektit politik i cili paraqet një kërkesë për regjistrimin e ndryshimeve është pikërisht që gjykata të ketë mundësinë të vërtetojë nëpërmjet akteve të dosjes se cili është organi i regjistruar që ka të drejtën e përfaqësimit me të tretët e për rrjedhojë edhe atë të paraqitjes së kërkesave në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga ana e Gjykatës, në zbatim të parashikimeve të nenit 176 të Kodit të Procedurës Civile, për verifikimin e legjitimitetit të përfaqësuesit duhet të ishte kontrolluar e cili ishte në kohën e gjykimit organi i Partisë Demokratike që kishte të drejtën e përfaqësimit ndaj të tretëve e më pas duhet të ishte verifikuar nëse personi që kishte depozituar kërkesën apo realizonte përfaqësimin në gjykatë kishte tagra të deleguara nga organi me të drejtë përfaqësimi ndaj të tretëve. Nga aktet e fashikullit gjyqësor rezulton se kërkesa drejtuar gjykatës është nënshkruar nga Z. Ivi Kaso në cilësinë e përfaqësuesit të Komisionit të

Rithemelimit të Partisë Demokratike. Në këto kushte Gjykata duhet të verifikonte nëse Komisioni i Rithemelimit ishte një organ me të drejtë përfaqësimi i regjistruar në regjistrin e partive politike të Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë. Regjistri i partisë politike PDSH i cili është pjesë e dosjes gjyqsore në këtë gjykim provon që në momentin e regjistrimit të kërkesës, datë 15.12.2021 dhe në momentin e shqyrtimit të saj nga Gjykata e Rrethit Gjyqsor Tiranë, Organi i vetëm me të drejtë përfaqësimi të partisë ndaj të tretëve ishte Kryetari i Partisë Demokratike.

126. Element tjetër që vlen të analizohet është autorizimi numër 1 prot, datë 13.12.2021 i lëshuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, me të cilin dhe në bazë të të cilit është bërë regjistrimi i kërkesës dhe përfaqësimi gjyqsor në Gjykatën e Rrethit Gjyqsor Tiranë. Pa çenuar arsyetimin e bërë më lart në lidhje me pavlefshmërinë e vendimit numër 4 të Kuvendit Kombëtar të datës 11 dhjetor 2021, po abstragojmë vetëm në lidhje me vlefshmërinë e autorizimi në bazë të zotësisë juridike të Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit. Për të marrë në analizë autorizimin është e nevojshme që më parë të analizojmë se cila është zotësia juridike, në kuptim të ligjit, e Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit. Referuar neneve 64 dhe 65 të Statutit të miratuar në Kuvendin e datës 11 dhjetor 2021 rezulton se Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit është një organ kolegjal. Pyetja që shtrohet është se cili është momenti në të cilin ky organ kolegjal fiton personalitet kundrejt të tretëve. Praktika gjyqsore ka provuar se personaliteti juridik për personat juridikë të cilët regjistrohen në regjistrat e Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë fitohet në momentin e regjistrimit të tyre në këtë regjistrë. Në rastin objekti shqyrtimi gjyqsor në momentin e paraqitjes së kërkesës për regjistrim Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit nuk ishte personalitet juridik. Në mungesë të personalitetit juridik Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit është një grupim qytetarësh i cili mund të përfaqësohej në gjykim vetëm me anë të një prokure, por në asnjë rast me anë të një autorizimi. Praktika gjyqsore (e konsoliduar në këtë drejtim) kërkon që në rastet e personave natyrorë e drejta e përfaqësimit dhe tagrat duhet të jepen me anë të prokurës. Autorizimi është një akt përfaqësimi i cili njihet si e drejtë vetëm personave juridikë. Për pasojë Gjykata e Rrethit Gjyqsor Tiranë gjatë shqyrtimit gjyqsor nuk mund të pranonte shqyrtimin e kërkesës si të paraqitur nga një subjekt që nuk ka zotësi juridike dhe tagra përfaqësimi ndaj të tretëve e aq më pak të legjitimonte përfaqësuesin e Komisionit të Rithemelimit në shqyrtimin gjyqsor.
127. Në pjesën e dytë të procesverbalit të seancës gjykata ka shpallur të hapur gjykimin dhe ka filluar shqyrtimin gjyqsor të çështjes duke i dhënë fjalën palës kërkuese. Pala kërkuese ka relatuar kërkesën e paraqitur me datë 15.12.2021 në Gjykatën e Rrethit Gjyqsor Tiranë si dhe provat bashkëlidhur kësaj kërkesë që janë vendimet nga 1 deri në 7 të Kuvendit Kombëtar të datës 11 dhjetor 2021. Më pas pala relaton se me datë 23.03.2021 ka depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqsor Tiranë edhe 24 prova të tjera. Përveç provave të depozituara nga pala kërkuese gjykata ka administruar edhe dosjen e subjektit politik Partia Demokratike të tërhequr nga Zyra e OJF në Gjykatën e Rrethit Gjyqsor Tiranë duke e bërë edhe këtë të fundit pjesë të shqyrtimit gjyqsor. Me administrimin e provave gjykata me kërkesë të palës ka vendosur mbylljen e hetimit gjyqsor dhe ka ftuar palën të paraqesë pretendimet përfundimtare. Nga leximi harmonik i kërkesës së paraqitur në gjykim nga pala kërkuese, provave të administruara nga gjykata, kohëzgjatjes së seancës gjyqsore dhe përmbajtjes së procesverbalit të seancës gjyqsore nuk rezulton që nga ana e trupës gjykuese të jetë bërë një hetim apo vlerësim i provave në lidhje me pretendimet e palës kërkuese. Sjellim në vëmendje të trupit gjykues që prova 19 përmban një material me filmime me një kohëzgjatje prej 7 orë, 56 minuta e 56 sekonda, prova 24 përmban 4552 formularë kërkesë, prova 7 përmban 1404 formularë dhe prova 6 përmban 138 nënshkrime. Këto janë vetëm provat më voluminoze të cilat do të duhet

së paku të shikoheshin në tërësinë e tyre nga gjykata. Ky fakt nuk relatohet të ketë ndodhur gjatë shqyrtimit gjyqësor.

128. Konkluzionet përfundimtare të palës kërkuese, të cilat janë në pjesën dërrmuese të njejta me kërkesën fillestare të regjistruar në gjykatë me datë 11 dhjetor 2021 nuk japin asnjë interpretim të provave, lidhur me fuqinë e tyre provuese në raport me parashikimet e ligjit material dhe atij procedural. Nga leximi sistematik i pretendimeve të palës kërkuese, procesverbalit të seancës gjyqësore dhe kohëzgjatjes së gjykimit të çështjes arrijmë në përfundimin se në marrjen e vendimit gjykata nuk ka shqyrtuar nga ana materiale provat dhe se nuk i ka analizuar në raport me kërkesën e depozituar për gjykim dhe kërkesat e ligjit material.

#### VIII. MBI PAVLEFSHMËRINË E AKTEVE TË KUVENDIT TË PRETENDUAR TË DATËS 11.12.2021

129. Përpara se të marrim në analizë aktet e thirrjes, mbledhjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të pretenduar të datës 11.12.2021 duhet të theksojmë se kjo analizë bazohet mbi statutin në fuqi (të regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë) në momentin e fillimit të procedurave për mbledhjen e tij dhe të përfundimit të vendimmarrjes së tij. Ky statut rezulton të jetë statuti i miratuar në mbledhjen e Kuvendit Kombëtar të datës 29.04.2018 dhe është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me datë 13.07.2021.
130. Procedura e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike fillon me plotësimin e formularëve kërkesë për mbledhjen e tij. Sipas provave të paraqitura në gjykim rezulton se janë depozituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë në cilësinë e provës 4552 (katër mijë e pesëqind e pesëdhjetë e dy) formularë kërkesë në total. Si fillim ky numër është më i madh se numri prej 4200 formularësh që pretendohet se janë depozituar me datë 10.11.2021 në zyrën e Kryetarit të Këshillit Kombëtar. E citojmë këtë fakt sepse depozitimi i formularëve kërkesë pas kalimit të afatit një muaj për njoftimin e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar dhe bashkimi i tyre me formularët fillestarë, mbi të cilët duhet të vërtetohej plotësimi i kushtit formal për arritjen e numrit prej  $\frac{1}{4}$  të anëtarësisë e bën të pamundur verifikimin nëse formularët fillestarë plotësonin kushtin e cituar më lartë.
131. Nga analiza e formularëve rezulton se këta të fundit kanë këto të dhëna: a) emrin; b) atësinë; c) mbiemrin; d) numrin e identifikimit personal; e) degën; f) seksionin; g) funksionin dhe h) nënshkrimin e me emër, mbiemër dhe firmë të personit. Në tekstin e formularit shkruhet se: *“Në bazë të nenit 43 pika 2 të Statutit të Partisë Demokratike të Shqipërisë KËRKOJ mbledhjen e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë me datës 11.12.2021, ora 10 me rend dite si më poshtë...”*. Fakti që vihet re në të gjithë formularët është se data dhe ora e mbledhjes së Kuvendit janë me vendosur me mjete mekanike dhe nuk janë pjesë e formatit fillestar të shkresës që është plotësuar nga ana e kërkuesit. Gjithashtu në formular mungon data e plotësimit të tij nga ana e kërkuesit duke e bërë të pamundur verifikimin e vërtetësisë kohore të plotësimit të formularit. Duke marrë në analizë faktin që data dhe ora e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, nuk janë pjesë e tekstit fillestar të shtypur, janë të vendosura mekanikisht dhe prima facia duken të njëjta në të gjithë formularët arrihet në konkluzionin se këta elementë janë vendosur a posteriori e nuk reflektojnë vullnetin fillestar të nënshkruesit të formularit. Gjithashtu referenca ligjore e përdorur në këtë akt është ajo e statutit të miratuar në 17.07.2021, statut i cili në ditën e hartimit të pretenduar të kërkesës dhe në datën e regjistrimit të kërkesës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk kishte hyrë ende në fuqi.

132. Përpos këtyre fakteve nuk rezulton që formularëve t'u jetë bashkëlidhur kopje e dokumentit të identifikimit të nënshkruesve, element që është i domosdoshëm për të provuar që formulari është plotësuar dhe nënshkruar nga personi të dhënat e të cilit mban. Depozitimi i formularëve kërkesë në formën e aktit noterial të Vërtetimit të Njësisë me Originalin nuk vërteton nënshkrimin e aktit nga personi por vetëm që kopja e aktit që po lëshohet nga noteri është e njejtë me atë që konsiderohet si origjinali.
133. Depozitimi i formularëve të cituar më lartë i është njoftuar Kryetarit të Partisë Demokratike me shkresën pa numër prot, datë 11.11.2021 të lëshuar nga Edi Paloka në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Kombëtar. Me këtë shkresë, drejtuar Kryetarit Lulzim Basha, ky i fundit njoftohet se: *"... në datën 10.11.2021, ora 20.00, pranë zyrës time, janë depozituar njoftimi dhe 4200 formularë kërkesë, të cilët informojnë mbi mbajtjen e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë në datën 11.12.2021 pranë Pallatit të Kongreseve, Tiranë. Formularët e kërkesës janë të gjithë të nënshkruar dhe përmbajnë të dhëna si emër, atësi, mbiemër, numër identifikimi, informacion për strukturën e Partisë Demokratike në të cilën aderojnë nënshkruesit dhe/ose funksioni që ata mbajnë në parti."* Sikurse konstatohet lehtësisht nga teksti i shkresës edhe pritësi dhe marrësi në dorëzim i formularëve nuk citon në asnjë rast se formularët janë paraqitur nga anëtarë të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike. Vetë Z. Paloka është kujdesur që të referojë vetëm numrin e formularëve dhe kërkesën e paraqitur në to por jo faktin nëse është bërë ndonjë verifikim lidhur me identitetin e nënshkruesve apo cilësinë e tyre si anëtarë të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike. Sipas fakteve dhe provave të cituara nuk rezulton që të jetë kryer nga asnjë entitet, fizik apo juridik, verifikimi i plotësimit të kushtit formal lidhur me numrin prej ¼ të anëtarëve të Kuvendit Kombëtar të cilët kërkojnë thirrjen e këtij të fundit.
134. Po me datë 11.11.2021 rezulton se Ilir Uka në cilësinë e Sekretarit të Degës 3 Tiranë i dërgon Kryetarit të Këshillit Kombëtar Edi Paloka, shkresën pa numër prot, me lëndë: "Lista e delegatëve të Kuvendit Kombëtar të PDSH. Në këtë shkresë Zoti Uka shprehet se: *"Pasi jemi vënë në dijeni të faktit që më shumë se ¼ e anëtarëve, delegatëve të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë kanë kërkuar mbledhjen e këtij Kuvendit në datën 11.12.2021, si dhe duke konsideruar faktin që pjesa më e madhe e delegatëve të degës tonë kanë firmosur për mbajtjen e tij në këtë datë, konsiderojmë të nevojshme që t'ju vëmë në dispozicion listën e plotë të delegatëve të Kuvendit Kombëtar të PDSH të cilën e administrojmë zyrtarisht nëpërmjet aksesimit në sistem që nga Kuvendi i mëparshëm i korrikut 2021"*. Kësaj shkrese i është bashkëlidhur një dokument prej 93 faqesh me përmbajtje të dhënash për ata që pretendohet se janë anëtarë/delgatë të Kuvendit Kombëtar të PDSH. Nga analiza e listës së bashkëlidhur shkresës nuk rezulton që kjo e fundit të paraqesë ndonjë element identifikues për autorin e saj, mënyrën e hartimit, kohën e hartimit, apo përputhshmërinë e të dhënave të paraqitura në të me të dhënat zyrtare të Partisë Demokratike. Shkresa përcjellëse nuk ka një numër të faqeve apo fletëve që përbëjnë listën dhe as një numër të përgjithshëm të të dhënave të paraqitura në listë. I vetmi element identifikues në listë është vula e me përmbajtjen "Partia Demokratike, Dega 3 Tiranë", vulë e cila është vendosur pas shtypshkrimit të listës në formën fizike të saj. Vetë depozituesi i listës deklaroi në shkresën përcjellëse se këtë listë e administrojnë nëpërmjet aksesit në sistem, por pa specifikuar se cila është vlera zyrtare e listës. Në deklarinë e tij nëpërmjet shkresës përcjellëse nuk përcaktoi se cili është momenti kohor në të cilin është garantuar aksesit në sistem, cili është subjekti që ka pasur aksesin në sistem e për më tepër nuk ka asnjë akt provues që lista e mësipërme është shkarkuar në ndonjë formë. Për sa më sipër, në kuptim të neneve 258 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, përmbajtja e shkresës përcjellëse edhe e materialit shoqëruar të saj kanë vlerë vetëm

për të provuar që ato janë hartuar dhe deklaruar nga shtetasi Ilir Uka por nuk mund të përbëjnë vlerë provuese për përmbajtjen e tyre.

135. Prova numër 9 e depozituar në gjykim është një lajm i nxjerrë nga portali Syri.net me të cilin pretendohet se është bërë njoftimi për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar. Në lajmin e publikuar portali shkruan: *“Zbardhet njoftimi për thirrjen e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike më 11 dhjetor. Njoftimi shoqëronte 4200 firmat e mblidhura për thirrjen e forumit më të lartë të PD. Në njoftim përcaktohet arsyeja e thirrjes së këtij forumi dhe rendi i ditës. Po ashtu theksohet se për shkak të ndjeshmërisë, firmat dhe të dhënat e atyre që kanë kërkuar thirrjen e Kuvendit Kombëtar duhen mbrojtur.”*. Vetë njoftimi nuk është pjesë e dosjes gjyqësore e për pasojë referimi ose marrja si provë e lajmit të publikuar në organet e media nuk mund të barazohet me vetë dokumentin e njoftimit. Për më tepër dokumenti i nxjerrë në lajmin, e për pasojë ajo që pretendohet të provohet, është pa nënshkrime dhe pa asnjë element identifikues, elementë që do të mund t'i jepnin këtij dokumenti të pretenduar cilësinë provuese të shkresës së thjeshtë.
136. Më tej lajmi vijon me publikimin e kopjes së njoftimit (që është depozituar në zyrën e Kryetarit të Këshillit Kombëtar së bashku me formularët) i cili në lajm rezulton të jetë pa nënshkrime. Në tekstin e njoftimit përveç të tjerave përcaktohet se: *“...Ky njoftim do të bëhet, me të njëjtat modalitete të njoftimit publik, edhe për pjesën e mbetur të delegatëve të Kuvendit Kombëtar...”*. Ky formulim lë të nënkuptosh që për pjesën e anëtarëve/delegatëve të Kuvendit Kombëtar të cilët nuk kanë nënshkruar formularë e për pasojë nuk janë në dijeni të datës së mbledhjes së Kuvendit njoftimi do të bëhet me anë të modaliteteve të njoftimit publik. Ajo që vlen për tu theksuar është se në formularin e publikuar gjendet paragrafi i fundit me këtë përmbajtje: *“Kompetencën për verifikimin e mandateve të delegatëve që thërrasin Kuvendin Kombëtar sipas statutit, si dhe të delegatëve që do të marrin pjesë në Kuvend, e ka drejtpërdrejt dhe vetëm Kuvendi Kombëtar i Partisë Demokratike nëpërmjet organizmave të tij.”*. Ky formulim lidhur me kompetencat e vetëkontrollit të Kuvendit Kombëtar nuk gjendet në formularët e nënshkruar nga anëtarët/delegatët kërkuar dhe nuk gjen asnjë mbështetje në Statutin e Partisë Demokratike.
137. Prova numër 8 e depozituar në gjykim është një njoftim i bërë nga Sali Berisha në rrjetin social facebook drejtuar të gjithë delegatëve të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike. Në këtë njoftim shkruhet se: *“Në vijim të njoftimit të bërë në dt 10.11.2021 para mediave dhe dje (dt 11.11.2011, në Tv Kombëtar Klan dhe portalin syri.net rikonfirmojmë për të gjithë delegatët njoftimin për thirrjen e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike ne dt 11.12.2021 ora 10 tek Pallati i Kongreseve Tiranë.”*. Sipas akteve të dosjes gjyqësore ky është njoftimi i parë publik drejtuar të gjithë delegatëve të Kuvendit Kombëtar. Pavarësisht referimit në brendinë e njoftimit për realizimin e këtij të fundit me datë 10.11.2021 dhe më pas në televizion dhe internet me datë 11.11.2021 sjellim në vëmendje të trupit gjykues se nga njëra anë në dosjen gjyqësore nuk ka asnjë akt provues për njoftimin e datës 10.11.2021 dhe nga ana tjetër lajmet e publikuara nga televizioni kombëtar Klan apo portali Syri.net nuk kanë modalitetin e njoftimit por të një lajmi e si të tillë nuk mund të konsiderohen si njoftime që respektojnë modalitetet e kërkuara nga vetë kërkuarët e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar.
138. Prova 23 e depozituar në gjykim është *“Raporti mbi prezencën e delegatëve pjesëmarrës në Kuvendin e Partisë Demokratike të Shqipërisë”*. Raporti përbëhet nga një material prej 186 fletësh me një pjesë shpjeguese në fillim dhe një listë delegatësh pjesëmarrës në vijim të pjesës shpjeguese. Në pjesën shpjeguese raporti në mënyrë të përmbledhur shpjegon procedurën për identifikimin dhe regjistrimin e delegatëve. Nga analiza e pjesës shpjeguese konstatohet se

subjektit raportues i është vënë në dispozicion një listë e të gjithë delegatëve të Kuvendit Kombëtar. Ky është momenti procedural që duam të sjellim në vëmendje të trupit gjykues. Në asnjë nga aktet provuese të depozituara në gjykim nuk tregohet se cili është organi, grupi i individëve apo individi i cili ka hartuar listën e delegatëve të Kuvendit Kombëtar të datës 11 dhjetor. Gjithashtu në këto akte nuk gjendet një listë e këtyre delegatëve e ndryshme nga ajo e dërguar nga Ilir Uka me shkresën e datës 11.11.2021. Nuk provohet se me çfarë procedure dhe cili është autoriteti i cili ka përfshirë listat e dërguara nga LDG dhe FRPD me listën e dërguar nga Dega 3 Tiranë. Nuk provohet se cili është organi apo individi që ka krahasuar listat për mungesë dublimesh apo pasaktësish, apo çdo veprimi tjetër i cili do të mund të prodhonte një listë përfundimtare të delegatëve të Kuvendit Kombëtar. Përpos kësaj rezultojnë se mbi bazën e një liste që nuk gjendet janë lëshuar token (mandate delegati) me kod unik QR i cili përmban të dhënat e delegatit. Nuk ka asnjë provë shkresore se cili është lëshuesi i mandateve të delegatëve, dhe me çfarë autoriteti janë lëshuar këto dokumenta.

139. Në raport raportohet se një ditë përpara eventit janë trajnuar personat përgjegjës për identifikimin e personave gjatë eventit, por nuk jepet një listë e këtyre personave, lidhja e tyre me organizatorët, apo raportuesin si dhe efektiviteti i punës së tyre në raport me rezultatin e pretenduar.
140. Përpos sa më lartë raporti ka mangësi për sa i përket të dhënave dhe informacioneve në raport me kohën. Në asnjë nga të dhënat e raportit nuk përcaktohet momenti i fillimit të regjistrimit dhe përfundimi i tij; momenti kohor kur secili nga delegatët është bërë pjesë e punimeve të Kuvendit apo largimi i tij i mundshëm. Në raport nuk ka asnjë të dhënë për delegatë të larguar përpara kohe, apo për praninë e tyre gjatë punimeve të Kuvendit.
141. Prova numër 18 depozituar në gjykim është Procesverbali i Mbledhjes së Kuvendit Kombëtar të PDSH-së. Në këtë procesverbal, faqja 2 paragrafi i parë raportohet se: *“Në përputhje me nenin 43 pika 2 të Statutit të PDSH, një përfaqësi e grupit nismëtar të delegatëve të cilët kërkonin mbledhjen e Kuvendit Kombëtar të PDSH i’u drejtuan Kryetarit të PDSH, nëpërmjet një shkrese, ku kërkonin që të ushtronte përgjegjësinë statutores dhe t’i propozonte Kuvendit Kombëtar përbërjen dhe miratimin e Komisionit Drejtues të Punimeve të Kuvendit dhe Sekretariatit Teknik, të cilët miratohen nga Kuvendi Kombëtar. Në mungesë të pjesëmarrjes së Kryetarit të PDSH në mbledhjen e Kuvendit Kombëtar të PDSH të datës 11.12.2021, si dhe në mungesë të një përgjigje shkresore nga ana e tij, me propozim të Kryetarit të Këshillit Kombëtar të PDSH z. Edi Paloka, i cili çeli edhe punimet e Kuvendit, u miratuan nga Kuvendi Kombëtar, me votim të hapur dhe me shumicë votash, në prani të më shumë se gjysmës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij si më poshtë: Komisioni Drejtues i Punimeve të Kuvendit...; Sekretariati Teknik...”*. Në analizë të këtij paragrafi dhe të shkresës pa datë, me titull “Njoftim për ushtrimin e detyrave statutores në funksion të mbarëvajtjes së Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë” rezultojnë se një grup deputetësh në cilësinë e vetëdeklaruar të përfaqësuesve të anëtarëve të cilët thërrasin Kuvendin Kombëtar i është drejtuar Kryetarit të Partisë me kërkesën për propozimin e 5 anëtarëve të Komisionit për drejtimin e punimeve të Kuvendit. Pretendimi i nënshkruesve se janë përfaqësues të anëtarëve të cilët thërrasin Kuvendin Kombëtar është tërësisht i pambështetur në asnjë akt apo provë. I vetmi tagër që nënshkruesit e formularëve për thirrjen e Kuvendit Kombëtar i kanë deleguar deputetit Sali Berisha është ai i përcaktuar në paragrafin e fundit të kërkesës me këtë formulim *“Kuvendi Kombëtar do të mbahet në ambientet e Pallatit të Kongreseve dhe në rast pamundësie në ambientet që do të përcaktohen në njoftim publik që do të kryhet për këtë qëllim nga anëtarë i Këshillit Kombëtar, deputeti Sali Berisha.”*. Sikurse konstatohet nga të gjithë provat pjesë e dosjes gjyqësore në shqyrtim, në asnjë moment kohor gjatë procedurës së

thirrjes së Kuvendit Kombëtar, anëtarësia kërkuese nuk ka deleguar kompetenca përfaqësimi nga një grupi të caktuar anëtarësh, pavarësisht cilësive apo hierarkisë së tyre. Si pasojë çdo njoftim apo kërkesë drejtuar Kryetarit të Partisë për ushtrimin e detyrimeve statutores nuk përmbush parakushtin e legjitimitetit të kërkuësve për tu konsideruar si një kërkesë e vlefshme.

142. Në fillimin e punimeve të Kuvendit Kombëtar, sipas Procesverbalit të punimeve të Kuvendit rezulton se është bërë zgjedhja e Komisionit për Drejtimin e Punimeve të Kuvendit dhe Sekretariatit Teknik. Në procesverbal relatohet se: *“Në mungesë të pjesëmarrjes së Kryetarit të PDSH në mbledhjen e Kuvendit Kombëtar të PDSH të datës 11.12.2021 si dhe në mungesë të një përgjigje shkresore nga ana e tij, me propozim të kryetarit të Këshillit Kombëtar të PDSH z.Edi Paloka, i cili çeli edhe Kuvendin, u miratuan nga Kuvendi Kombëtar, me votim të hapur, dhe me shumicë votash, në prani të më shumë se gjysmës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij si më poshtë Komisioni Drejtues i Punimeve të Kuvendit ... Sekretariati Teknik...”*. Së pari duhet theksuar se ky relativitet në procesverbalin e Kuvendit Kombëtar nuk përkon me ngjarjen e ndodhur. Nga analiza e provës numër 19 (USB me përmbajtjen e plotë filmike të Kuvendit) nuk rezulton që Edi Paloka të ketë bërë një propozim të tillë në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Kombëtar. Sipas provës filmike rezulton se propozimi për ngritjen e Komisionit Drejtues të Punimeve të Kuvendit të jetë shprehur në këtë formë: *“ fillimi minuta 01.30.50 – “Tani me propozim të përfaqësuesve të delegatëve që kanë kërkuar thirrjen e këtij kuvendi po Ju paraqes për miratim emrat e komisionit që do drejtojnë punimet e Kuvendit. Zonja Albana Voksi, Kryetare e Lidhjes Demokratike të Gruas. Z. Ervin Minarolli, Sekretar Organizativ i Partisë Demokratike. Z. Ivi Kaso, Sekretar Zgjedhor i Partisë Demokratike. Z. Edmond Spaho, ish nënkryetar i Partisë Demokratike dhe Z. Belind Këllici, Kryetar i Forumit Rinor të Partisë Demokratike, i cili do të jetë edhe drejtuesit e këtij komisioni. Ndërkohë për sekretariatit propozohen Znj. Minushe Lazaj, Zj. Nada Daullja dhe Z. Ledio Nuraj. Ju ftoj t’i votojmë me ngritje dore, kush është pro, kundër nuk ka. Ftoj Komisionin dhe Sekretarinë që të zejë vend në podium”. – fundi minuta 01.32.11”*. Pra propozimi për anëtarët e Komisionit Drejtues të Punimeve të Kuvendit Kombëtar i është përcjellë Kuvendit si propozim i përfaqësuesve të delegatëve dhe jo si propozim individual i Edi Palokës, në cilësinë e Kryetarit të Këshillit Kombëtar.
143. Neni 47 pika 5 e Statutit të PDSH përcakton se: *“Të drejtën për t’i bërë kërkesa dhe propozime Kuvendit Kombëtar, për çështje që janë në kompetencë të tij, përveç rasteve kur ky Statut përcakton ndryshe, e kanë Kryetari i Partisë, Këshilli Kombëtar, Kryesia e PDSH-së, ose jo më pak se pesëmbëdhjetë për qind e anëtarëve të Kuvendit me të drejtë vote, të shpërndarë në të paktën pesë Degë të PDSH-së.”*. Në zbatim të kësaj dispozite propozimi i bërë nga Kryetari i Këshillit Kombëtar për ngritjen e Komisionit për Drejtimin e Punimeve të Kuvendit dhe Sekretariatit Teknik është i pavlefshëm pasi është bërë nga një subjekt që nuk plotëson kriteret e parashikuara në pikën 5 të nenit 47. Pavarësisht cilësisë së tij si Kryetar i Këshillit Kombëtar, në zbatim të pikës 5 të nenit, për të pasur një propozim të vlefshëm do të duhej që ky i fundit të vinte nga Këshilli Kombëtar, ç’ka në kuptimin procedural nënkupton një vendim marrje të këtij organi.
144. Fakt tjetër që duhet vlerësuar në procedurën e ngritjes së Komisionit është procedura e votimit të tij. Në paragrafin e sipërcituar në Procesverbal përcaktohet se votimi u bë i hapur, me shumicë votash dhe në prani të më shumë se gjysmës së numrit të përgjithshëm të anëtarësive së tij. Në asnjë moment procesverbali nuk përcakton se cili ishte organi që vërtetoi praninë e më shumë se gjysmës së numrit të përgjithshëm të delegatëve dhe cili ishte organi që bëri numërimin e votave.

145. Pas procedurës së caktimit të Komisionit drejtues të punimeve ky i fundit ka marrë vendim për verifikimin e ligjshmërisë statutores të thirrjes së Kuvendit. Për verifikimin e ligjshmërisë është ngritur një grup pune me 72 pjesëmarrës. Në procesverbal (faqe 4 e procesverbalit – faqe 125 e dosjes gjyqore) relatohet se: *“Në përfundim të verifikimit të formularëve dhe të kërkesës për thirrjen e Kuvendit Kombëtar ... nga kur rezultoi se: - Mbledhja e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike i datës 11.12.2021 ishte thirrur rregullisht nga 4200 dlegatë/anëtarë të tij, pra shumë më tepër se ¼ e numrit minimal të nevojitur për të thirrur Kuvendin Kombëtar të Jashtëzakonshëm që është 1912 delegatë; - Mbledhja e Kuvendit ishte thirrur rregullisht në raport me dispozitat statutores të cilat rregullojnë mbledhjen e tij, neni 43/2 i Statutit të PDSH”*. Rezulton se Kuvendi, nëpërmjet mekanizmave të tij jo vetëm ka verifikuar formularët e anëtarëve që e kanë thirrur atë por edhe zbatimin e dispozitave të tjera statutores lidhur me afatet dhe njoftimet. Pavarësisht relatimit në Procesverbal nga ana e grupit të punës prej 72 vetësh nuk ka një akt shkresor provues për rezultatet e verifikimit të kryer nga ana e tyre apo modalitetet e këtij verifikimi.
146. Pas verifikimit të thirrjes së ligjshme të Kuvendit nga ana Komisionit është bërë verifikimi i pranisë së delegatëve të pranishëm nga ku është konstatuar se janë të pranishëm 4934 anëtarë, numër ky më i madh se gjysma e numrit të përgjithshëm prej 7646 anëtarët të Kuvendit Kombëtar. Fakt është që numri i përgjithshëm prej 7646 anëtarësh të Kuvendit Kombëtar nuk gjendet në asnjë nga aktet e tjera provuese të depozituara në gjykim. Nuk ka asnjë të dhënë se si është përfutur ky numër nga ana e Komisionit të Drejtimit të Punimeve të Kuvendit.
147. Me verifikimin e pretenduar të ligjshmërisë, thirrjes dhe quorumit Komision ka kaluar në fazën vendimmarrëse të Kuvendit Kombëtar. Në faqe 5 (faqe 126 të dosjes gjyqore) të Procesverbalit relatohet se: *“Më pas, Komisioni i Drejtimit të Punimeve të Kuvendit administroi një kërkesë të paraqitur në përputhje me nenet 43 dhe 60 të Statutit të PDSH-së si më poshtë: 1) Kërkesë dhe Draft Statutin (ndryshimet në statut) e propozuar nga ¼ e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të PDSH dhe të mbështetura nga 15% e anëtarësisë së Kuvendit Kombëtar, i cili u regjistrua nga Komisioni me nr 1, datë 11.12.2021...”*. Ky relativitet i procesverbalit të punimeve lidhet me provën “Propozim për vendimmarrje Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të datës 11.12.2021” (faqe 66-74 të dosjes gjyqore) dhe me provën “Vendim numër 1, datë 11.12.2021 i Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike” (faqe 8 e dosjes gjyqore). Procesverbali i Kuvendit dhe propozimi numër 1 relatojnë si bazë statutores të propozimit nenet 43 dhe 60 të Statutit të PDSH. Kjo bazë ligjore është ajo e statutit të miratuar në vitin 2021, i cili ende nuk kishte hyrë në fuqi në kohën e zhvillimit të Kuvendit të pretenduar. Edhe duke marrë në referencë statutin e korrikut 2021 përsëri rezulton se nuk janë zbatuar dispozitat statutores. Referenca në neni 43 nuk bëhet në ndonjë pikë të caktuar të tij, por në të gjithë nenin duke lënë të kuptohet që në rastin konkret dispozita zbatohet në tërësinë e saj. Neni 43 përcakton në pikën 3/a të drejtën e Kuvendit Kombëtar për të marrë vendime në lidhje me Statutin e Partisë, ndërsa në pikën 4 përcakton se cilat janë organet e Partisë që kanë të drejtën e paraqitjes së propozimeve në Kuvendin Kombëtar. Ndërkohë neni 60 është nen i veçantë i statutit i cili i referohet vetëm rasteve dhe procedurave për ndryshimin e statutit. Ky nen përcakton se: *“Ky Statut mund të rishikohet nga Kuvendi i Partisë me shumicën e të gjithë të anëtarëve të tij sipas propozimeve të Kryesisë së Partisë, së një të katërtës së anëtarëve të Këshillit Kombëtar. Për përgatitjen e ndryshimeve në Statut ngrihet dhe funksion Komisioni i Përhershëm i Statutit, i cili është përgjegjës edhe për interpretimin e dispozitave të Statutit. Komisioni i Përhershëm i Statutit përbëhet nga 7 anëtarë titullarë dhe dy anëtarë ndihmës, dhe caktohet nga Kryesia e Partisë”*. Nga interpretimi i nenit 60 rezulton se organet e përcaktuara në të, Kryesia e Partisë dhe një e katërta e anëtarëve të Këshillit Kombëtar, kanë të drejtën të hartojnë dhe propozojnë ndryshime statutores, por jo të drejtën që



këtë propozim t'ia adresojnë Kuvendit Kombëtar në mënyrë të drejtpërdrejtë. Ky qëllim i dispozitës nxirret nga paragrafi i dytë i saj i cili krijon një strukturë të posaçme, Komisioni i Përhershëm i Statutit, që ka për detyrë të përgatisë ndryshimet sipas propozimeve të organeve të cituara në paragrafin e parë të nenit. Nga leximi sistematik i dispozitave 43 dhe 60 të Statutit rezulton se ky i fundit mund të ndryshohet vetëm me procedurë normale dhe në asnjë rast me procedurë të jashtëzakonshme. Në një interpretim pak të gjërë mund të pranohet së në kushtet e plotësimit të kërkesës formale nga 15% e anëtarësisë së Kuvendit Kombëtar ky i fundit mund të marrë në shqyrtim një kërkesë për ndryshimin e Statutit, por ky interpretim do të ishte në kushtet e një rasti zhbllokues më shumë se në kushtet normale.

148. Në dosjen gjyqësore (faqe 66-74 të dosjes gjyqësore) gjendet prova "Propozim për vendimmarrje Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të datës 11.12.2021". Në analizë të Propozimit numër 1, datë 11.12.2021, rezulton se ky propozim është paraqitur nga 138 nënshkrues të cilët prezumohet që kanë cilësitë e anëtarit të Këshillit Kombëtar dhe Delegatit të Kuvendit Kombëtar. Duke referuar në analizën e dispozitave statutores të parashtruar më lartë vëmë re se të drejtën e paraqitjes së propozimeve në Kuvendin Kombëtar e kanë vetëm "*...Kryetari i Partisë, Këshilli Kombëtar, Kryesia e PDSH-së, ose jo më pak se pesëmbëdhjetë për qind e anëtarëve të Kuvendit me të drejtë vote, të shpërndarë në të paktën pesë Degë të PDSH-së...*". Pra si rregull i përgjithshëm anëtarët e Këshillit Kombëtar nuk kanë të drejtën e propozimeve të drejtpërdrejta në Kuvendin Kombëtar e për pasojë pretendimi se ky propozim është nënshkruar nga ¼ e anëtarëve të Këshillit Kombëtar nuk rregullon pavlefshmërinë e tij. Në Propozim dhe në Procesverbal pretendohet se propozimit i bashkëlidhen edhe 15% e firmave të anëtarëve të Kuvendit Kombëtar, fakt që pretendohet të provohet me provën numër 7 të depozituar në gjykim. Ky pretendim nuk është i vërtetë pasi propozimi është i shoqëruar vetëm nga 138 firma (të cilat në raport me numërin 7646 të delegatëve) nuk përmbushin kushtin e kërkuar prej 15% të delegatëve të Kuvendit. Kjo pa i hyrë analizës mbi shpërndarjen gjeografike nëpër degët e partisë të nënshkruesve të propozimit. Nisur nga kjo analizë rezulton se propozimi që i është paraqitur Kuvendit Kombëtar për miratimin e ndryshimeve statutores nuk është i vlefshëm e për pasojë nuk mund të merrej në shqyrtim nga Kuvendi. Pavlefshmëria e propozimit sjell si pasojë edhe nullitetin e vendimit numër 1 të Kuvendit me të cilin është miratuar Draft Statuti i propozuar.
149. Prova 7, e depozituar nga përfaqësuesi i kërkuar nga ana formale përbëhet nga 55 fletë. Në fillim të fletë gjendet i shtypur teksti "*Kërkesë për shkarkimin e Kryetarit të Partisë Demokratike të Shqipërisë Z. Lulzim Basha*". Në vijim të këtij teksti gjendet një listë me emër, mbiemër dhe nënshkrimin e 1396 personave, ndryshe nga sa relatohet në aktin noterial për njehsimin e tij me origjinalin në të cilin citohet se janë 1404 firma. Përpos numrit ajo që vihet re, në raport me pretendimin se kjo provë mbështet pretendimin se një numër prej 15% të anëtarëve të Kuvendit Kombëtar mbështet propozimin për ndryshimet statutores, bie ndesh me brendinë e shkresave, në titullin e të cilave përcaktohet se kjo kërkesë është për shkarkimin e Kryetarit të PDSH-së Lulzim Basha.
150. Vendimet 2 -7 të miratuara më pas nga Kuvendi janë pasojë e propozimeve të paraqitura nga një grup prej 7 deputetësh, në zbatim të neneve 42 dhe 43 të Statutit të ndryshuar me vendimit numër 1, të analizuar më lartë. Për shkak se në bazë të analizës së bërë vendimi numër 1 i Kuvendit është null, për rrjedhojë të gjithë vendimet e bazuara në propozime të paraqitura në mungesë të mbështetjes në dispozitat statutores janë të pavlefshme.

#### IX. MBI VENDIMIN NUMËR 3, DATË 25.03.2022 TË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR TIRANË

151. Nga analiza e vendimit numër 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë rezulton se në analizën e legjitimitetit të palës kërkuese dhe në analizën e provave, ligjshmërinë e tyre dhe përputhshmërinë e dispozitat statutore Gjykata i është referuar statutit të miratuar në Kuvendin Kombëtar të datës 17 korrik 2021. Sjellim në vëmendje të trupit gjykues së vendimi i datës 18.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me të cilin është pranuar kërkesa për regjistrimin e ndryshimeve statutore të miratuara në 17.07.2021 është ankimuar nga PDSH (referuar ankimit të njoftuar edhe gjyqtarit Zhukri) e për pasojë ky statut nuk ishte pjesë e dosjes gjyqësore në momentin e shqyrtimit të kërkesës së paraqitur nga KPR.
152. Nga provat shkresore pjesë e dosjes gjyqësore rezulton se me shkresë numër 1346/222 akti, datë 23.03.2022 Gjyqtari Zhukri i është drejtuar “Zyrës së OJF” me kërkesën për marrjen e dosjes (praktikës) së subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë (faqe 100 e dosjes gjyqësore). “Zyra e OJF” me shkresën pa numër protokolli të të njëjtës datë i ka kthyer përgjigje Gjyqtarit Zhukri duke u shprehur se: *“Në përgjigje të shkresës tuaj numër 1346/222 akti, datë 23.12.2022, në të cilën kërkon vënien në dispozicion të dosjes së Partisë Demokratike të Shqipërisë, regjistruar më urdhër të Ministrit të Drejtësisë numër 12, datë 19.12.1990. Ju bëj me dije se dosjen e regjistrimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë nuk mund t’jua vëmë në dispozicion pasi është tërhequr më datë 20.12.2021 nga gjyqtare Blerina Muça, në momentin që do të dorëzohet dosja nga gjyqtarja do t’jua vëmë në dispozicion. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin”* (faqe 101 e dosjes gjyqësore). Nga këto akte rezulton se në momentin e marrjes në shqyrtim të kërkesës së paraqitur nga KPR gjyqtari Zhukri nuk dispononte dosjen e subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë.
153. Në pikën 27 të vendimit të saj Gjykata e Lartë arsyeton se: *“27. Në këtë procedurë kontrolli gjyqësor (homologimi), gjykata ka detyrimin ligjor që të fokusojë dhe kushtëzojë vlerësimin e saj në kontrollin e ligjshmërisë të: (i) procedurave të ndjekura për thirrjen e mbledhjes së organeve vendimarrëse të partisë, kuvendit kombëtar, kryesisë apo organeve të tjera drejtuese me të drejtë vote dhe vendimmarrëse; (ii) vlefshmërinë e njoftimeve të kryera për mbledhjen e këtyre forumeve; (iii) përcaktimin dhe verifikimin e kuorumit të nevojshëm për të mbledhur forumet dhe organet drejtuese të subjektit politik, si dhe për të marrë vendimet përkatëse; si dhe (vi) kontrollin e përputhshmërisë e realizimit të të gjitha këtyre procedurave me ligjin specifik, përcaktimet e statutit të subjektit juridik dhe akteve rregullatore të brendshme, me qëllim përcaktimin e vlefshmërisë së akteve të nxjerra nga këto procedura vendimarrëse nga pikëpamja e ligjit dhe pasqyrimin e tyre në regjistrin përkatës të partive politike.”* Në këtë arsyetim, me të drejtë, Gjykata e Lartë përcakton se cilat janë detyrat e Gjykatës në shqyrtimin e kërkesave për regjistrimin e akteve të kërkuara nga Ligji për Partitë Politike.
154. Në datën 25.03.2022, në të cilën është zhvilluar seanca gjyqësore për miratimin e kërkesës së paraqitur nga KPR, rezulton se statuti i fundit i regjistruar në dosjen e subjektit politik Partia Demokratike e Shqipërisë ishte ai i miratuar në Kuvendin Kombëtar vitit 2018, regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datë 13.07.2021. Për pasojë përse i përket Gjykatës, statuti i cili duhet të merrej si bazë ligjore për të verifikuar vlefshmërinë ligjore dhe statutore të akteve që i nënshtroheshin homologimit gjyqësor, është statuti i fundit i regjistruar në gjykatë, ai i miratuar në vitin 2018 dhe i regjistruar në dosjen e subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë në vitin 2021. Në kundërshtim me këtë detyrim ligjor, të saktësuar dhe nga Vendimi 768 i Gjykatës së Lartë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka analizuar, shqyrtuar dhe në fund homologuar mbledhjen dhe vendimet e Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021 bazuar në statutin e miratuar në vitin 2021 por ende të paregjistruar në gjykatë, i cili nuk ishte pjesë e dosjes së subjektit politik, dosje që për më tepër gjykata as nuk e dispononte.

155. Ky fakt provohet edhe nga lista e provave të cilat i janë depozituar gjykatës me datë 23.03.2022 nga kërkuesi. Në listën e provave me numrin 1 është statuti i partisë demokratike, i cili bazuar në aktet që ndodhen në dosjen gjyqësore është statuti i miratuar në Kuvendin Kombëtar të datës 17.07.2021, i cili në kohën e zhvillimit të seancës gjyqësore nuk ishte ende i regjistruar në dosjen e subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë. Në këto kushte rezulton se nga ana e Gjykatës është realizuar shqyrtimi dhe homologimi i mbledhjes dhe vendimeve të Kuvendit të datës 11.12.2021 jo mbi bazën e dosjes së tërhequr në rrugë administrative nga “Zyra e OJF” por mbi bazën e provave të depozituara në gjykim nga kërkuesi KPR. Rezulton se e gjithë pjesë arsyetuese, analizuese dhe homologuese e vendimit numër 3, datë 25.03.2023 është realizuar jo vetëm në mungesë të dosjes gjyqësore por duke marrë për bazë një statut i cili ende nuk kishte marrë fuqi ligjore.
156. Nisur nga kjo analizë arrijmë në përfundimin se vendimi numër 3, datë 25.03.2022 është një vendim i marrë në mungesë të plotë të akteve provuese dhe homologuese e për pasojë arsyetimi, shqyrtimi gjyqësor dhe në përfundim edhe vendimmarrja është në kundërshtim dhe pasojë e interpretimit të gabuar të ligjit dhe në mungesë të plotë të akteve provuese.
157. Duke shprehur bindjen e plotë që arsyetimi dhe analiza e mësipërme lidhur me shqyrtimin gjyqësor dhe vendimmarrjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është e drejtë dhe e mbështetur në prova dhe ligj, dëshirojmë t'i nënshtrojmë analizës së kësaj gjykate faktin që edhe në raport me statutin e miratuar në Kuvendin Kombëtar të datës 17.07.2021 vendimi është përsëri i gabuar dhe në interpretim jo të drejtë të ligjit dhe provave materiale.
158. Në vendimin numër 3, datë 25.03.2022 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë relaton se: *“Pala kërkuese “PDSH” i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesën objekt shqyrtimi, e cila është regjistruar në datën 16/12/2021 dhe në vijim nënshtroar procedurave të shortit elektronik dhe kalimit të dosjes te Gjyqtari i çështjes.”*. Sikurse relaton vetë gjykata pala kërkuese është PDSH, fakt i cili provohet edhe nga kërkesa e depozituar në gjykatë edhe nga vetë referimi i vendimit mbi palët dhe objektin e kërkesës. Më pas Gjykata në pjesën arsyetuese në lidhje me legjitimitetin e kërkuesit relaton se: *“...kërkesa është paraqitur nga Komisioni i Rithemelimit i Partisë Demokratike, (nëpërmjet përfaqësuesit të saj të autorizuar) organ i cili cilësohet si organi i përkohshëm drejtues i Partisë Demokratike të Shqipërisë, zgjedhur dhe miratuar nga vendimmarrjet e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë të datës 11.12.2021.”*. Sikurse konstatohet nga arsyetimi i Gjykatës kjo e fundit ka bërë një diferencë ndërmjet subjektit juridik PDSH dhe kërkuesit (në cilësinë e paraqitësit të kërkesës) Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit, (i përfaqësuar edhe ky i fundit me autorizimin numër 01, datë 13.12.2021).
159. Pas këtij relatimi nga ana e Gjykatës është arsyetuar në lidhje me legjitimitetin e Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit për të adresuar gjykatën me kërkesën objekt shqyrtimi gjyqësor. Gjykata vetë shprehet se nga kjo e fundit është bërë vetëm verifikimi formal i akteve të përfaqësimit *“...duke i gjetur ato të rregullta dhe në përputhje me ligjin procedural”*. Ky konstatim i gjykatës është krejtësisht i pabazuar në ligj dhe në prova. Nëse analizojmë praktikën gjyqësore në rastin e regjistrimit të ndryshimeve në regjistrat e partive politike, por edhe në rastin konkret të shqyrtuar nga vetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se një gjykim për regjistrimin e ndryshimeve nuk mund të fillojë për aq kohë sa trupi gjykues nuk disponon dhe bën pjesë të shqyrtimit gjyqësor dosjen e partisë politike. Vetë Gjykata, ka vendosur në dy raste, për çështjen objekt ankimi, pezullimin e gjykimit me arsyetimin se dosja e subjektit politik Partia Demokratike ishte tërhequr nga gjykatës tjetër i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

Tiranë. Pra rezulton e qartë që parakushti procedural për fillimin e shqyrtimit gjyqsor është disponimi nga ana e trupës gjyquese të dosjes së subjektit politik. Ky disponim është i domosdoshëm pikërisht për të verifikuar nëse subjekti kërkues është ai i regjistruar në regjistrin e partisë politike dhe se subjekti kërkues ka dhe cilat janë tagrat e përfaqësimit.

160. Për të arritur në pabazueshmërinë e konkluzioneve të arritura nga Gjykata në lidhje me legjitimitetin e Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit është e nevojshme të analizojmë shkaku për të cilin një gjykim për regjistrimin e ndryshimeve në regjistrin e partive politike nuk mund të fillojë përpara se Gjykata të disponojë fizikisht dosjen e subjektit politik. Shkaku për të cilin Gjykata përpara fillimit të shqyrtimit gjyqsor të kërkesës duhet të tërheqë dosjen e subjektit politik gjendet nga analiza e neneve 9, 10, 11 dhe 14 të ligjit 8580 datë.17.02.2000 “Për Partitë Politike”. Ky ligj në nenin 9 përcakton se: *“Regjistrimi i partive politike bëhet në gjykatën e shkallës së parë të rrethit të Tiranës, e cila mban regjistrin e partive politike. Në regjistrin e partive politike shënohet numri rendor i regjistrit, numri i aktit, numri i vendimit gjyqsor, data e shpalljes, dispozitivi i vendimit, emri i plotë i partisë, inicialet e partisë, stema e partisë, përshkrimi i konfiguracionit të vulës, emri i kryetarit, numri i anëtarëve themelues shënime për ndryshimin e emrit, konfiguracione të vulës ose të kryetarit të partisë, fshirjes apo mbarimit të veprimtarisë së subjektit, data e bërjes së shënimit, emri, si dhe nënshkrimi i nëpunësit kompetent. Partia politike njihet si person juridik që nga data kur gjykata ta ketë miratuar dhe regjistruar atë. Deri në datën e regjistrimit, themeluesit e partisë mund të kryejnë veprime që janë të nevojshme për organizimin e saj, siç janë, sidomos, thirrja e zhvillimi i mbledhjes së themeluesve dhe zgjedhja e organeve drejtuese, por nuk mund të kryejnë veprimtari si parti politike.”* Neni 11 përcakton se: *“Në dokumentet për regjistrimin e partisë politike, përcaktohen: a) emërtimi dhe selia e partisë; b) qëllimet dhe detyrat e saj; c) organet udhëheqëse dhe ndërtimi i partisë; ç) burimet fillestare të financimit dhe numrin e anëtarëve themelues”,* ndërsa neni 14 i ligjit përcakton se: *“Dispozitat e këtij ligji për regjistrimin e partive politike janë njëlloj të vlefshme për ndryshimet dhe fshirjet në regjistrimet e mëparshme. Kërkesa për ndryshime në regjistrin e partive politike bëhet nga organi i partisë që ka në kompetencë përfaqësimin e saj ndaj të tretëve”.*
161. Nga leximi sistematik i neneve të sipërcituara rezulton se në regjistrimin e partisë politike në Gjykatë një nga elementët e domosdoshëm është cilësimi i emrit të Kryetarit të Partisë dhe ose Organet udhëheqëse të saj. Ky përcaktim i neneve 9 dhe 11, i parë nën dritën e përcaktimeve të paragrafit të dytë të nenit 14, si dhe praktikës procedurale për disponimin e dosjes gjyqsore përpara fillimit të shqyrtimit gjyqsor të çështjes çojnë në përfundimin se detyra e gjykatës në rastin e regjistrimeve jo fillestare është të verifikojë identitetin e subjektit kërkues krahasuar ky i fundit me të dhënat e regjistrit të partive politike në të cilën caktohet se cili është organi i partisë që ka tagrat e përfaqësimit ndaj të tretëve, përfshirë këtu edhe të drejtën e përfaqësimit të subjektit në Gjykatë. Në rastin objekti gjykim, Gjykata e Rrethit Gjyqsor Tiranë nuk ka marrë asnjë të dhënë nga dosja e tërhequr nga vetë ajo nga “Zyra e OJF”, për të verifikuar nëse kërkuesi Komision i Përkohshëm i Rithemelimit kishte apo jo tagra përfaqësimi të subjektit Partia Demokratike në Gjykatë. Në kundërshtim me vetë praktikën e ndjekur prej saj lidhur me tërheqjen e dosjes së subjektit, Gjykata nuk është konsultuar me të por ka vendosur të legjitimojë kërkuesin Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit bazuar në Statutin e miratuar me vendimin numër 1, datë 11 dhjetor 2021, ndonëse shqyrtimi i ligjshmërisë dhe çertifikimi i tyre (sikurse arsyetoni vetë gjykata në vendim kur shprehet se: *“...veprimtaria e brendshme organizative (zgjedhja e organeve drejtuese) e partive politike nuk kushtëzohet nga miratimi dhe regjistrimi gjyqsor, por ky i fundit nevojitet detyrimisht për çertifikimin e ligjshmërisë në këto procese dhe legjitimitimin ndaj të tretëve”*.) është bërë nga gjykata pas legjitimitetit të palës. Bazuar në sa më sipër si dhe në arsyetimet e parashtruara më lartë rezulton se arsyetimi

i Gjykatës në lidhje me legjitimitimin e Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit dhe përfaqësuesit të autorizuar të këtij Komisioni janë tërësisht të gabuara dhe të pabazuara në ligj dhe në prova.

162. Sikurse kemi arsyetuar gjerësisht më lartë Gjykata nuk mund të legjitimonte kërkuesin për aq kohë së Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit nuk rezultonte organ përfaqësues i Partisë Demokratike si dhe akti i përfaqësimit të këtij organi për përfaqësuesin Ivi Kaso nuk ishte në formën e kërkuar nga ligji. Sjellim në vëmendje të trupit gjykues faktin që akti i përfaqësimit i depozituar në gjykim është një autorizim për përfaqësim gjyqësor i cili nuk përmbush kushtet e parashikuara nga neni 72 i Kodit të Procedurës Civile. Lëshuesi i autorizimit, Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit nuk gëzon cilësitë e subjektit juridik dhe as nuk rezulton i regjistruar si një subjekt apo organ në regjistrat publikë. Në këto kushte forma e kërkuar e autorizimit do të ishte Prokura Noteriale dhe jo autorizimi i thjeshtë.
163. Ndryshe nga sa arsyeton gjykata, Statuti i Partisë Demokratike, nuk përcakton dy lloj mbledhjesh të Kuvendit Kombëtar: *i) mbledhje zakonshme; ii) mbledhje e jashtëzakonshme*, që përcaktohet nga nga mënyra e thirrjes së saj. Statuti i PDSH njeh vetëm një lloj mbledhje: Mbledhjen e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike, sipas rregullave të përcaktuara në Statut dhe në aktet nënstatutore.
164. Nga analiza e dispozitave të Statutit të PDSH, konkretisht nenit 43, ku bazohet thirrja e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar vërehet qartësisht se ruga përmes së cilës kalon mbledhja e Kuvendit Kombëtar është si më poshtë: “1. Vendimin për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar e merr Këshilli Kombëtar ose Kryesia e PDSH-së. 2. Vendimi merret: a) me propozim të Kryetarit të PDSH-së (rregulli i përgjithshëm). b) kur e kërkojnë 1/4 e anëtarëve të PDSH-së ose 1/4 e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar (rasti përjashtimor: Kuvendi mund të mbledhet edhe kur E KËRKOJNË... [pra, bëhet fjalë për kërkesë, dhe jo për vendim për thirrjen e Kuvendit, i cili në çdo rast merret ose nga Kryesia e Partisë, ose nga Këshilli Kombëtar i PDSH, dhe ti njoftohet rregullisht dhe në rrugë zyrtare anëtarëve të tjerë të organit]). 3. Punimet e Kuvendit drejtohen nga një Komision i përbërë nga 5 anëtarë, i cili zgjidhet në fillim të Punimeve të tij, me propozimin e Kryetarit të Partisë. 4. Të drejtën për t’i bërë kërkesa dhe propozime Kuvendit Kombëtar, për çështje që janë në kompetencë të tij, përveç rasteve kur ky Statut përcakton ndryshe, e kanë Kryetari i Partisë, Këshilli Kombëtar, Kryesia e PDSH-së, ose jo më pak se pesëmbëdhjetë për qind e anëtarëve të Kuvendit me të drejtë vote, të shpërndarë në të paktën pesë Degë të PDSH-së.”.
165. Kjo rrugë është detajuar edhe në Rregulloren e Brendshme “Të funksionimit të organeve qendrore të PDSH”, miratuar nga Këshilli Kombëtar i PDSH në vitin 2010, sipas të cilit thirrja e Kuvendit Kombëtar të PDSH, kalon edhe nëpërmjet kësaj procedure: “1. Kërkesat për thirrjen e Kuvendit Kombëtar të Partisë duhet t’i dërgohen Kryesisë me shkrim (neni 5 i Rregullores). 2. Kohën, vendin dhe rendin e ditës së mbledhjes të Kuvendit Kombëtar e njofton Kryesia e PDSH-së mbi bazën e kërkesave (neni 3 i Rregullores). 3. Thirrja për t’u mbajtur Kuvendi u njoftohet degëve me shkrim (neni 4 i Rregullores).
166. Rregullat për thirrjen e Kuvendit Kombëtar përbëjnë një praktikë të konsoliduar të Partisë Demokratike të Shqipërisë, duke qenë se janë të pandryshuara që nga miratimi i Statutit të PDSH në vitin 2009. Në këtë kuptim, ndryshe nga sa interpreton në mënyrë të gabuar gjykata, ka vetëm një mënyrë për thirrjen e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë, që është thirrja me vendim të Këshillit Kombëtar ose Kryesisë së Partisë. Ndërkohë që ka dy forma sesi vihet në lëvizje procedura për marrjen e vendimit për thirrjen e Kuvendit Kombëtar,

që janë: a) Me kërkesë (propozim) të Kryetarit të Partisë; b) Me kërkesë të 1/4 së anëtarëve të partisë ose 1/4 së anëtarëve të Kuvendit Kombëtar.

167. Në këtë rast Statuti u ka njohur këtyre dy subjekteve të drejtën për të kërkuar thirrjen e Kuvendit Kombëtar, nisur nga fakti se ato janë organe përfaqësuese të vullnetit të drejtëpërdrejtë të anëtarëve. Konkretisht, Kryetari i Partisë zgjidhet nga anëtarët e Partisë sipas parimit “një anëtar, një votë”, ndërkohë që edhe pjesa dërrmuese e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar (kryetarët e seksioneve dhe grupseksioneve), zgjidhen nga anëtarët po sipas parimit “Një anëtar, një votë”. Në këtë mënyrë gjen zbatim parimi demokratik ligjor i ngritjes dhe funksionimit nga poshtë – lart të partisë, për rrjedhojë u njeh anëtarëve të drejtën që të jenë pjesë aktive në vendimmarrjet e rëndësishme, përmes përfaqësuesve të zgjedhur drejtëpërdrejtë prej tyre.
168. Ndryshe nga sa argumenton gjykata, në çdo organ kolegjal shtetëror, publik apo jopublik, e drejta e pakicës për të kërkuar thirrjen e mbledhjes, nuk nënkupton vetëthirrjen, por faktin se ajo i nënshtrohet vetëm kontrollit formal, si rregull është e pakundërshtueshme dhe është jashtë vullnetit të shumicës së organit drejtues. Për ilustrim, i njëjti mekanizëm që njeh pushtetin e pakicës, është edhe procedura për thirrjen e komisioneve parlamentare, apo ngritjen e komisioneve hetimore nga Kuvendi. Kushtetuta ia njeh të drejtën për të ngritur një komision hetimor 1/4 së anëtarëve të Kuvendit, por Komisioni Hetimor nuk vetëngrihet dhe për ngritjen e tij kërkohet vendim i Kuvendit. Në këtë rast, ngritja apo mbledhja e Komisionit Hetimor nuk varet nga vullneti i shumicës parlamentare, por kërkesa e pakicës i nënshtrohet kontrollit formal të të qenurit në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. I njëjti rregull vepron edhe për thirrjen e mbledhjeve të Komisioneve të Përhershme Parlamentare nga pakica, ku kërkesa është e pakundërshtueshme, por ajo i nënshtrohet kontrollit formal të autoritetit që cakton mbledhjen e Komisionit, që është Kryesia e Komisionit Parlamentar.
169. Edhe në rastin e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar të PDSH, kërkesa e 1/4 së anëtarëve të partisë, apo 1/4 së anëtarëve të Kuvendit Kombëtar, është e pakundërshtueshme, por i nënshtrohet kontrollit formal nga institucionet e partisë, në dy drejtime: Së pari, nëse kërkuesit janë apo jo zyrtarisht anëtar të partisë apo anëtar të Kuvendit Kombëtar të PDSH, dhe nëse numri i kërkuesve është në numrin limit të kërkuar nga Statuti. Vetëm nëse përmbushet ky kusht, bëhet thirrja e mbledhjes së Kuvendit dhe njoftimi zyrtar i anëtarëve të Kuvendit. Pa u verifikuar ky kusht, nuk mund të ketë as thirrje të Kuvendit dhe as njoftim për mbledhjen e Kuvendit. Së dyti, nëse themeli i kërkesës, është apo jo në përputhje me Statutin dhe është ose jo në kompetencë të Kuvendit Kombëtar sipas Statutit.
170. Në rastin konkret, vendimi i organeve të Partisë për thirrjen e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar është i nevojshëm edhe për efekt njoftimi zyrtarisht të anëtarëve të tjerë të Kuvendit Kombëtar, degëve të partisë, dhe institucioneve të partisë. Në mungesë të këtij vendimi, publikimit të rregullt të tij nga institucionet e partisë, njoftimit zyrtar të këtij vendimi për degët e partisë dhe anëtarët e Kuvendit, nuk mund të ketë mbledhje e të Kuvendit Kombëtar.
171. Gjykata në mënyrë abuzive parashikon një situatë që del jashtë funksionimit demokratik të një partie politike, duke abuzuar në argument se: “Në kushte ekstreme, organet drejtuese të partisë, mund të mos vlerësojnë si të nevojshme mbledhjen e Kuvendit dhe vendimmarrjen për çështje të caktuara, në kundërshtim me vullnetin e anëtarësisë. Organet vendimmarrëse mund të jenë në konflikt interesi në raport me ushtrimin e një kompetence të Kuvendit. Të tilla do të ishin ndryshimet statutores që do të zvogëlonin apo ndryshonin kompetencat e organeve që kanë të

drejtën e thirrjes së zakonshme apo shkarkimi i tyre (psh. kryetarit) nga Kuvendi. Në këto kushte, këto organe do të refuzonin mbledhjen e Kuvendit.”.

172. Thirrja e organit kolegjial është e detyrueshme kur një kuorum i përcaktuar me aktin përkatës (kushtetutë, ligj, rregullore apo statut), kërkon thirrjen e organit. Në këto kushte, kërkesa nuk mund të refuzohet, jashtë shkaqe statutore, apo për arsye të paligjshme të konfliktit të interesit, sic abuzon në fantazi gjykata. Në të kundër do të ishim përpara shkeljes së Statutit, që i mundëson anëtarëve kërkuar të drejtën për të ankimuar vendimin në institucionet përkatëse Statutore apo në rrugë të tjera ligjore. Për pasojë, e drejta e pakicës (1/4 e anëtarëve të Kuvendit) nuk mund të bllokohet për arsye ekstrastatutore nga institucionet e partisë.
173. Është e vërtetë që Statuti në nenin 47 nuk e ka përfshirë të drejtën e pakicës për të thirrur kuvendin në të njëjtën fjali ku rregullohet thirrja me propozim të Kryetarit. Kjo për faktin se thirrja nga ¼ e anëtarëve të Kuvendit është rast përjashtimor, dhe jo rregull i përgjithshëm. Nëse analizon me kujdes Statutin, i njëjti rregull vlen edhe për mbledhjen e Këshillit Kombëtar të PDSH. Sipas pikës 4 të nenit 47 të Statutit, “mbledhjen e Këshillit Kombëtar e thërret Kryetari i Partisë ose Kryesia e Partisë. Këshilli Kombëtar mund të mblidhet edhe nëse e kërkojnë 1/4 e anëtarëve të tij. Në këtë rast, Kryetari thërret mbledhjen jo më vonë se dy javë nga data e depozitimit të kërkesës”. Pra, edhe në këtë rast vendimi për thirrjen e mbledhjes merret nga Kryetari, organi që thërret si rregull mbledhjet e Këshillit Kombëtar, dhe Këshilli Kombëtar nuk vetëthërret dhe as nuk vetëmbledhet. Pra, mënyra sesi është formuluar Statuti, që më pas është detajuar nga aktet nënstatutore, ndan rregullin e përgjithshëm për thirrjen e një organi të partisë, nga rregulli përjashtimor për thirrjen e tij, por në çdo rast pa shmangur vendimmarrjen e domosdoshme të institucionit të partisë që bën thirrjen e mbledhjes së organit.
174. Vendosja në një fjali të pavarur, dhe lidhëza “edhe” qartësojnë pikërisht faktin se thirrja bëhet ose kur propozon kryetari (rregulli i përgjithshëm), ose kur e kërkojnë 1/4 e anëtarëve (si rregull përjashtimor dhe formë alternative për marrjen e vendimit për thirrjen e mbledhjes nga organet përkatëse). Në rastin konkret, gjykata nuk argumenton sesi bëhet verifikimi nëse anëtarët që kanë kërkuar thirrjen e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, janë në numrin e kërkuar nga Statuti apo janë vërtetë anëtar të partisë apo anëtarë të Kuvendit Kombëtar. Mungesa e këtij verifikimi paraprak pamundëson thirrjen e mbledhjes së Kuvendit, për shkak se pa këtë verifikim dhe pa u konfirmuar këto dy kushte, nuk mund të investohen në pjesëmarrje anëtarët e tjerë të Kuvendit Kombëtar. Për këtë qëllim, në aktet nënstatutore dhe konkretisht në “Rregulloren e Brendshme të organizimit të organeve qendrore të partisë” specifikohet se në të dyja rastet (qoftë propozimi i Kryetarit, qoftë kërkesa e ¼ së anëtarëve, i dërgohet me shkrim Kryesisë së Partisë.
175. Në pjesën arsyetuese të vendimit lidhur me thirrjen e Kuvendit Kombëtar Gjykata analizon drejtë përbërjen e tij, fitimin, humbjen dhe kohëzgjatjen e mandatit të delegatit. Por pavarësisht se arsyetimi i Gjykatës është i drejtë kjo e fundit nuk ka krahasuar provat e depozituara në gjykim me arsyetimin e bërë lidhur me përbërjen dhe formimin e Kuvendit Kombëtar. Gjykata ka anashkaluar krejtësisht detyrimin për të provuar se cila është lista e Kuvendit Kombëtar, cili është organi që e harton atë dhe aq më pak se sa është numri i përgjithshëm i delegatëve që e formojnë Kuvendin Kombëtar në momentin e dhënë kohor të mbledhjes së tij. Të gjithë elementët e përmendur më lartë janë të domosdoshëm për t’u përdorur më pas në analizën e plotësimi të kushteve formale (formularët kërkesë dhe numri i tyre) për fillimin e procedurës së thirrjes së Kuvendit Kombëtar.

176. Gjykata ka argumentuar se “për thirrjen e Kuvendit nga 1/4 e anëtarëve ka dy aspekte themelore: 1. Aspekti cilësor – të drejtën e thirrjes e kanë vetëm delegatët, pra ata anëtarë që kanë një funksion që sipas statutit i jep ex officio edhe mandatin e delegatit. 2. Aspekti sasior – duhet që thirrjen ta kërkojnë jo më pak se 1/4 e delegatëve. Plotësimi i këtyre kushteve si dhe caktimi i datës në një afat jo më herët se 30 ditë nga momenti i thirrjes dhe caktimi i rendit të ditës, janë kushtet e mjaftueshme për të thirrur Kuvendin.”. Mirëpo gjykata nuk jep përgjigje se kush e bën dhe sesi bëhet verifikimi i përmbushjes së këtyre dy kushteve, me qëllim që të shkohet më pas në thirrjen e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, njoftimin e thirrjes së Kuvendit Kombëtar, apo mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar.
177. Në vijim Gjykata arsyeton se: “Në të dy format e thirrjes, statuti i 17 Korrikut 2021, ashtu si legjislacioni tjetër i përmendur më sipër, vendos tre elemente të detyrueshëm: caktimi dhe publikimi i : *i) datës për thirrjen e kuvendit; ii) afati 30-ditor nga momenti i thirrjes deri në datën e caktuar; iii) rendi i ditës i përcaktuar paraprakisht.*”. Pika ii) e kësaj analize të gjykatës është e gabuar dhe nuk reflekton parashikimet e nenit 43 të Statutit. Statuti, për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar, nuk cakton afate në ditë por afate në muaj. Në rastin konkret afati për njoftimin e thirrjes së Kuvendit Kombëtar është “të paktën një muaj përpara ditës së parë të Kuvendit”, ç’ka nënkupton që afati një muaj duhet të përfundojë në ditën e fundit përpara ditës së parë të punimeve.
178. Kjo është arsye, pse sipas akteve nënstatutore kërkesa depozitohet pranë Kryesisë së Partisë, me qëllim që strukturat përgjegjëse për organizimin e partisë dhe që kanë akses të plotë mbi të dhënat e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar, të bëjnë verifikimet përkatëse. Ndryshe nga sa shprehet gjykata, që Statuti i PDSH në asnjë dispozitë të tij, nuk parashikon organin të cilit kërkuessit e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, duhet t’i drejtojnë kërkesën për mbledhjen e tij, në rastet kur mbledhja e Kuvendit kërkohet nga anëtarësia, Statuti i Partisë parashikon se është Sekretari i Përgjithshëm autoriteti përgjegjës statutor për organizimin e partisë. Organizimi i partisë, nënkupton edhe marrjen e masave të nevojshme organizative, për organizimin e mbledhjeve të organeve të partisë, përfshirë Kuvendin Kombëtar. Në këtë pikë, vlen të theksohet se organi se ku depozitohet kërkesa parashikohet në Rregulloren e Brendshme të funksionimit të organeve qendrore të partisë, dhe sipas nenit 5 të këtij akti nënstatutor, kërkesa i dërgohet me shkrim Kryesisë së Partisë.
179. Gjykata gabimisht thekson se formalizimi i këtyre kërkesave dhe përcjellja e tyre pranë Kryetarit të Këshillit Kombëtar, organ ky i cili në bazë të nenit 49 të statutit përcaktohet si organi më i lartë i cili drejton veprimtarinë politike të partisë në periudhën midis dy Kuvendeve, është në vlerësim të gjykatës i ligjshëm dhe i pa kontestueshëm. Në këtë pikë, qëllimisht dhe në shkelje të ligjit, konsideron si organin më të lartë që drejton veprimtarinë politike të partisë, Kryetarin e Këshillit Kombëtar, ku në fakt sipas Statutit, është Këshilli Kombëtar, një organ kolegjal, ku Kryetari i Këshillit ka vetëm një votë. Kryetari i Këshillit Kombëtar nuk ka asnjë kompetencë statutorë, përveç drejtimit të mbledhjes së Këshillit, që lidhet me organizimin e partisë, strukturat e partisë apo anëtarësinë e organeve të tjera të partisë.
180. Gjykata në mënyrë të gabuar dhe të paligjshme ka marrë të provuar faktin se një grup deputetësh dhe politikanësh të tjerë të Partisë Demokratike, në datën 10 Nëntor 2021 kanë depozituar në zyrën e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të PD më shumë se 4200 formularë kërkesash të delegatëve të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike, për mbajtjen e Kuvendit Kombëtar të PDSH në datën 11.12.2021 në orën 11.00. Për këtë qëllim, gjykata shprehet se ka marrë dhe ka administruar provën nr. 24 bashkangjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022.



181. Gjykata arsyeton se: *“Rezultoni nga materialet e depozituara në dosje, se një grup deputetësh dhe politikanësh të tjerë të Partisë Demokratike, në datën 10 Nëntor 2021 kanë depozituar në zyrën e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të PD më shumë se 4200 formularë kërkesash të delegatëve të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike, për mbajtjen e Kuvendit Kombëtar të PDSH në datën 11.12.2021 në orën 11.00. Kjo procedurë është zhvilluar në përputhje me pikën 2, të nenit 43 të Statutit të PDSH-së, në fuqi në momentin e thirrjes së Kuvendit Kombëtar, i cili parashikon qartësisht mbledhjen e organit më të lartë drejtues të Partisë Demokratike të Shqipërisë me kërkesë të një numri anëtarësh dhe delegatësh të Kuvendit Kombëtar më të madh se ¼ e gjithë përbërjes të tij. Në rastin konkret numri i formularëve të kërkesave të paraqitura (4200) e tejkalon ndjeshëm numrin e kërkesave të nevojshme për thirrjen e Kuvendit Kombëtar, i cili për shkak se përbëhet nga 7646 delegatë mund të thirret në mënyrë të ligjshme kur këtë e kërkojnë jo më pak se 1912 anëtarë të tij, (Gjykata për këtë qëllim administroi dhe vlerësoi provën nr.24 bashkangjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022)”. Ky arsyetim i Gjykatës është krejtësisht i gabuar dhe i pambështetur nga provat e depozituara në gjykim. Referuar provave të dosjes gjyqësore nuk ka asnjë të dhënë se cilët janë personat që kanë depozituar në zyrën e Kryetarit të Këshillit Kombëtar formularët. Akti provues për depozitimin e këtyre formularëve është shkresa e datës 11.11.2021 e Z. Edi Paloka me të cilën njofton Kryetarin e Partisë për depozitimin e tyre. Gjykata raporton se janë dorëzuar në këtë datë më shumë se 4200 formularë, ndërkohë që vetë shkresa e Z. Paloka e cituar më lartë referon vetëm numrin 4200 dhe jo më shumë. Nga ana tjetër prova 24 e administruar nga gjykata, përbëhet nga 4552 formularë shifër që është e ndryshme nga shifra prej 4200 formularësh e deklaruar nga shkresërisht nga Z. Paloka. Arsyetimi i gjykatës se kjo procedurë është zhvilluar në përputhje me pikën 2 të nenit 43 të Statutit, duke e lidhur procedurën vetëm me të drejtën e thirrjes së Kuvendit nga ¼ e anëtarësisë është krejtësisht e pabazuar dhe në kundërshtim me vetë arsyetimin e gjykatës lidhur me aspektin cilësor dhe atë sasior. Duke e vlerësuar të drejtë arsyetimin e gjykatës për aspektet cilësore dhe sasior gjykojmë se për të arritur në një përfundim të drejtë e të bazuar gjykata duhet të vlerësonte provën 24 pikërisht në këto drejtime. Për këtë qëllim duhet fillimisht të vlerësonte nëse formularët kërkesë plotësonin këto kushte:*

- a. Formulari të shoqërohej nga kopje e kartës së identitetit të personit nënshkruar.
- b. Formulari ishte nënshkruar nga vetë personi
- c. Personi nënshkruar gëzonte cilësinë e delegatit apo anëtarit të Kuvendit Kombëtar
- d. Formulari përcaktonte rendin e ditës së Kuvendit Kombëtar;
- e. Formulari përcaktonte datën dhe orën e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar.
- f. Datën e nënshkrimit të formularit.

182. Vetëm pas verifikimit të plotësisht të të gjithë këtyre elementëve Gjykata do të kishte mundësinë të shprehej lidhur me respektimin e pjesës së parë të anës procedurale të thirrjes së mbledhjes së Kuvendit Kombëtar. Në kundërshtim me sa analizuar më sipër, edhe në mungesë të një liste të plotë të delegatëve të Kuvendit Kombëtar, Gjykata raporton se numrit të përgjithshëm i delegatëve është 7646 pa u referuar në asnjë rast se cila është prova apo akti shkresor që prodhon këtë numër. Sjellim në vëmendje të trupit gjykues që pa një akt të plotë provues që vërteton numrin e saktë të anëtarëve/delegatëve të Kuvendit Kombëtar është e pamundur të vlerësohet përmbushja e kriterit sasior të ¼ së delegatëve të nevojshëm për thirrjen e Kuvendit Kombëtar.

183. Sipas nenit 47, pika 4 e Statutit të Partisë Demokratike, vendimi për thirrjen e Kuvendit Kombëtar e merr Këshilli Kombëtar ose Kryesia e Partisë. Konkretisht, Statuti i Partisë

parashikon se: “Kuvendi Kombëtar mbledhet si rregull çdo katër vjet. Vendimin për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar e merr Këshilli Kombëtar ose Kryesia e PDSH-së, me propozim të Kryetarit të PDSH-së. Kuvendi mund të mbledhet edhe kur e kërkojnë 1/4 e anëtarëve të PDSH-së ose 1/4 e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar.”. Statuti njih dy rrugë për të kërkuar marrjen e vendimit për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar. Rruga normale është propozimi i Kryetarit të Partisë. Mirëpo, si për çdo organ kolegjal, Statuti njih edhe një rrugë tjetër, që synon të garantojë të drejtat e pakicës në një parti politike, që është kërkesa e 1/4 së anëtarëve të PDSH-së ose 1/4 së anëtarëve të Kuvendit Kombëtar. Në këtë rast, kërkesa e një numri të caktuar të anëtarëve të PDSH apo Kuvendit Kombëtar nuk zëvendëson vendimin e Këshillit Kombëtar apo të Kryesisë së Partisë, por zëvendëson aktin e propozimit nga Kryetari i Partisë. Kërkesa e tyre është e pavarur nga vullneti i Kryetarit të Partisë, si rregull e pakundërshtueshme, por që formalisht i nënshtrohet vendimmarrjes së Këshillit Kombëtar ose Kryesisë së Partisë, për efekt të njohjes dhe njoftimit të anëtarëve të tjerë të Kuvendit Kombëtar, njoftimit të Degëve të Partisë, përgatitjes dhe organizimit të mbledhjes së Kuvendit, përcaktimit të anëtarëve me të drejtë vote të Kuvendit, etj. Termat e përdorura në Statut “propozim” apo “kur e kërkojnë” kanë të njëjtin efekt, atë të nisjes së procedurës për thirrjen e Kuvendit Kombëtar.

184. Anëtarët e partisë, të pidentifikuar në numër, refuzuan të dorëzonin kërkesën pranë Partisë Demokratike, duke pretenduar se kërkesat ishin depozituar në zyrën e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike z. Edi Paloka, i cili nuk kishte të drejtë t’i shqyrtonte, por vetëm do të shërbente si depozitues dhe ruajtës i kërkesës. Sipas nenit 50 të Statutit të Partisë Demokratike, Kryetari i Këshillit Kombëtar nuk ka asnjë kompetencë statutores, as në thirrjen e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, as në organizimin e partisë, as në ruajtjen apo depozitimin e kërkesave drejtuar Partisë Demokratike. Pika 2 e nenit 50 të Statutit specifikon se Këshilli Kombëtar drejtohet nga Kryetari i Këshillit, i cili zgjidhet në mbledhjen e parë të konstituimit të Këshillit Kombëtar. Pra, e vetmja kompetencë statutores e Kryetarit të Këshillit Kombëtar të PDSH, është drejtimi i mbledhjes së Këshillit Kombëtar.
185. Megjithatë, sa kohë Kryetari i Këshillit Kombëtar është njoftuar për kërkesën e një numri të pacaktuar të anëtarëve të partisë, ai kishte detyrimin statutor, të njoftonte zyrtarisht organet e partisë, si më poshtë:
- Kryetarin e Partisë, me qëllim që të vihej në lëvizja procedura për thirrjen e mbledhjes së Kryesisë ose Këshillit Kombëtar;
  - Si anëtarë i Kryesisë së Partisë, të njoftonte anëtarët e tjerë të Kryesisë së Partisë;
  - Si drejtues i Këshillit Kombëtar, duhet të njoftonte anëtarët e Këshillit Kombëtar të PDSH, si dhe të iniciojë procedurën për të mbledhur Këshillin Kombëtar që të njëjti me kërkesën dhe të ndiqte procedurat përkatëse statutores për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar.
186. Në mungesë të këtyre veprimeve, dhe në mungesë të vullnetit për depozitimin të kërkesës e pretenduar në Partinë Demokratike, Kryetari i Partisë, njoftoi thirrjen e mbledhjes së Kryesisë së Partisë, për të diskutuar mbi situatën dhe për të vlerësuar mundësinë për thirrjen e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike. Konkretisht, me vendimin nr. 139 Prot, datë 15.11.2021 të Kryesisë së Partisë, u vendos thirrja e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike, ditën e shtunë, më datë 18 dhjetor 2021, ora 11:00, në Pallatin e Kongreseve, duke caktuar edhe Rendin e Ditës.
187. Sipas Statutit të PDSH, të drejtën për t’i bërë kërkesa dhe propozime Kuvendit Kombëtar, për çështje që janë në kompetencë të tij, përveç rasteve kur ky Statut përcakton ndryshe, e kanë

Kryetari i Partisë, Këshilli Kombëtar, Kryesia e PDSH-së, ose jo më pak se pesëmbëdhjetë për qind e anëtarëve të Kuvendit me të drejtë vote, të shpërndarë në të paktën pesë Degë të PDSH-së. Në këtë mënyrë, me caktimin e datës për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar për në datën 18 Dhjetor 2021, ¼ e anëtarëve të Kuvendit, i'u krijua mundësia statutore që të përfshinin kërkimin e tyre, duke paraqitur kërkesa apo propozime për vendimmarrje në Kuvend. Kjo e drejtë dhe mundësi statutore nuk u shfrytëzua, dhe nuk u paraqit asnjë kërkesë apo propozim shtesë nga ato të përcaktuar nga Kryesia e Partisë.

188. Në vijim të arsyetimit lidhur me verifikimin e kërkuësve gjykata shprehet se: *“Gjithashtu gjykata administroi me cilësinë e provës nr. 22 bashkangjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022 edhe listën e plotë të delegatëve të Kuvendit Kombëtar, përcjellë zyrtarisht Kryetarit të Kuvendit Kombëtar z. Edi Paloka, në datë 11.11.2021 nga ana e Degës nr.3 të Partisë Demokratike Tiranë. Shkresës zyrtare të kësaj Dege të PDSH i bashkëlidhet edhe lista e plotë emërore e delegatëve që përbëjnë Kuvendin Kombëtar të PDSH, e shkarkuar kjo e fundit nga aplikacioni Blu System, aplikacion zyrtar i PDSH. Lista bashkëlidhur është e përcjellë me shkresë zyrtare dhe e vulosur me vulën e degës 3 të PDSH Tiranë, dhe si e tillë i plotëson edhe elementët formalë për tu konsideruar një dokument zyrtar.”*. Ky interpretim i gjykatës është në vazhden e interpretimeve të pabazuara dhe në vlerësim të gabuar të provave. Gjykata citon në arsyetim termin “listë e plotë” i huazuar nga shkresa të cilës i referohet si sekretari i Degës 3 Tiranë. Për të legjitimuar të dhënat e kësaj liste gjykata shton në arsyetimin e saj informacione të cilat mungojnë në shkresën e cituar. Në këtë shkresë përdoret fraza *“...lista e plotë emërore e delegatëve të Kuvendit Kombëtar të PDSH të cilën e administrojmë zyrtarisht nëpërmjet aksesit në sistem...”* ndërkohë që fraza që përdoret nga Gjykata është *“...lista e plotë emërore e delegatëve që përbëjnë Kuvendin Kombëtar të PDSH, e shkarkuar kjo e fundit nga aplikacioni Blu System, aplikacion zyrtar i PDSH...”*. Në asnjë nga aktet shoqëruese të praktikës gjyqësore nuk ka asnjë të dhënë lidhur me ekzistencën e një sistemi të quajtur Blu System e aq më pak që ky i fundit të jetë edhe aplikacion zyrtar i PDSH, fakt në bazë të të cilit më pas gjykata të mund të vlerësojë si provë të plotë një informacion të nxjerrë nga ky sistem.
189. Për të provuar pretendimin e saj, gjykata shprehet se ka analizuar disa prova. Gjykata shprehet se ka verifikuar nëse shtetasit nënshkruer të thirrjes së Kuvendit Kombëtar përfshiheshin në listën emërore të funksionarëve të PDSH të cilët, në momentin e thirrjes së tij, përbënin listën e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar. Për këtë qëllim gjykata pretendon se ka administruar provat shkresore, konkretisht provën nr. 3, nr. 4 dhe nr. 22, duke dalë në konkluzionin se listat bashkëngjitur këtyre dokumentave përbëjnë listë të plotë zyrtare dhe të detajuar të shtetasve të cilët përbënin Kuvendin Kombëtar të PDSH, në momentin e thirrjes së tij nga anëtarësia.
190. Konkretisht gjykata thekson se ka administruar me cilësinë e provës nr. 22, listën e plotë të delegatëve të Kuvendit Kombëtar, përcjellë zyrtarisht Kryetarit të Kuvendit Kombëtar z. Edi Paloka, në datë 11.11.2021 nga ana e Degës nr.3 të Partisë Demokratike Tiranë. Së pari, z. Edi Paloka nuk ka qenë Kryetar i Kuvendit Kombëtar, por ka qenë kryetar i Këshillit Kombëtar. Së dyti, Dega 3 e Partisë Demokratike Tiranë, nuk është autoriteti statutor për lëshimin e një dokumenti që përmban listën e plotë të anëtarëve të Kuvendit Kombëtar të PDSH, për shkak se del jashtë kompetencave të saj dhe për shkak se ka të pamundur sipas organizimit të partisë, që të disponojë listën e plotë të anëtarëve të Kuvendit Kombëtar të PDSH.
191. Gjykata në mënyrë të gabuar shprehet se lista e plotë emërore e delegatëve që përbëjnë Kuvendin Kombëtar të PDSH, e përcjell me shkresë zyrtare të kësaj Dege të PDSH ka qenë shkarkuar nga një aplikacion “Blu System”, që gjykata e ka cilësuar si aplikacion zyrtar i

PDSH, pa shpjeguar se nga e ka marrë zyrtarisht këtë informacion. Ky pretendim i gjykatës është i pavërtetë, për disa arsye:

192. Sipas nenit 32 të Statutit të Partisë, Dega e PDSH-së formohet apo shkrihet me vendim të Kryesisë së PDSH, ajo funksionon përgjithësisht në bazë të njësisve të qeverisjes lokale apo çdo ndarje tjetër administrative territoriale të përshtatshme dhe përbëhet nga grupseksionet dhe seksionet e atyndodhura. Nga ky përcaktim statutor del qartë që një Degë partie, nuk shtrin veprimtarinë e saj në degët e tjera të partisë, dhe ushtron veprimtarinë e vet politike vetëm brenda territorit të degës. Për këtë qëllim, përcaktimi i listës së anëtarëve të Kuvendit Kombëtar të PDSH, nuk përfshihet brenda kompetencave të një dege të Partisë. Asnjë degë partie, nuk ka akses apo mundësi, të njoh, dijë, apo prodhojë, listën e plotë të anëtarëve të Kuvendit Kombëtar. Asnjë degë partie nuk ka akses në asnjë sistem elektronik zyrtar të partisë, që t'i mundësojë njohjen me të dhënat apo listën e plotë të anëtarëve të Kuvendit Kombëtar të PDSH. Për pasojë, nëse në shkresën e Degës 3 Tiranë, është specifikuar një fakt i tillë, ai është i pavërtetë, është një informacion i rremë, e për pasojë akti që ka marrë në konsideratë gjykata, përveçse absolutisht i pavlefshëm, është edhe i falsifikuar. Së treti, PDSH nuk disponon asnjë aplikacion zyrtar, që përmban të dhëna të tilla dhe që i mundëson Degëve të Partisë akses në të dhënat e një Dege tjetër partie.
193. Qartësisht gjykata ka njohur si provë, një akt absolutisht të pavlefshëm, që është prodhuar nga një autoritet që sipas ligjit nuk e ka në kompetencë. Për pasojë, lista e anëtarëve të Kuvendit që ka marrë si të mirëqenë gjykata, nuk përbën listën zyrtare të anëtarëve të Kuvendit Kombëtar të PDSH.
194. Për pasojë, pretendimi i gjykatës se nga verifikimi i kryer nëpërmjet krahasimit të emrave dhe funksioneve të nënshkruesve të thirrjes së Kuvendit Kombëtar me listat e sipërcituara rezulton se nënshkruesit e formularëve të kërkesave të thirrjes së Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021 janë anëtarë/delegatë të këtij organi, për shkak të funksionit që gjithsecili prej tyre mban, është i pambështetur në prova dhe bazohet në një rrethanë të rremë, të krijuar në kundërshtim me ligjin dhe Statutin, nga një organ jo kompetent.
195. Nga ana tjetër, gjykata shprehet se ka administruar si provë, shkresat e FRPD dhe LDG, mbi anëtarët e Kuvendit që janë përfaqësues të tyre. Sipas Statutit, anëtar të Kuvendit Kombëtar të PDSH janë edhe jo më shumë se 5 % e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar, përfaqësues të FRPD dhe LDG. Nisur nga fakti që numri i përfaqësuesve mund të jetë nga 0.1 % - 5 % (për shkak se Statuti specifikon "jo më shumë se"), është Sekretari i Përgjithshëm, si autoriteti përgjegjës statutor, për organizimin e partisë, që për çdo mbledhje të Kuvendit, cakton kuotat përfaqësuese të FRPD dhe LDG, dhe njofton këta të fundit. Më pas, lista e përfaqësuesve i përcillet Sekretarit të Përgjithshëm, që i përfshin ato në listën e anëtarëve të Kuvendit, për atë mbledhje të Kuvendit Kombëtar, duke i pajisur me mandatin e anëtarit. Kjo është një praktikë e konsoliduar dhe e dokumentuar në çdo mbledhje të Kuvendit Kombëtar. Në rastin konkret, asnjë autoritet statutor nuk ka përcaktuar kuotën e përfaqësimit të FRPD dhe LDG, dhe as ka pajisur me mandat anëtari asnjë përfaqësues të FRPD dhe LDG, për shkak se nuk ka patur asnjë mbledhje të Kuvendit Kombëtar të PDSH në 11 Dhjetor 2021 dhe asnjë njoftim për një mbledhje të tillë.
196. Gjithashtu gjykata shtrembëron faktet kur referon se kërkesa nga ana e ¼ të anëtarëve përcakton dhe datën 11.12.2021 për kryerjen e punimeve të këtij kuvendi. Ky është një fakt publik dhe i vërtetuar me anë të provave shkresore që një datë e tillë nuk është plotësuar në asnjë formularë të firmosur nga këta persona që pretendojnë se janë anëtarë të Kuvendit Kombëtar të PDSH, që vendi, data dhe ora janë caktuar pas plotësimit të një kërkesë të tillë, në

mënyrë individuale dhe personale në facebook nga shtetasi Sali Berisha. Nga ana tjetër, mbetet e paqartë sesi ka arritur gjykata të vërtetojë nënshkrimet e kërkuësve, që pretendon se janë më shumë se ¼ e anëtarëve të Kuvendit Kombëtar, në kushtet kur kërkesat nuk janë nënshkruar pranë një institucioni të partisë, nuk janë mbledhur nën përgjegjësinë e një grupi të caktuar personash të identifikueshëm dhe as nuk janë mbajtur përpara një noteri publik. Gjithashtu, pamjet filmike që gjykata pretendon se ka administruar nuk pasqyrojnë që sistemi elektronik skanon përputhjen mes identitetit të anëtarit të Kuvendit dhe personit që paraqitet në Kuvend.

197. Pas certifikimit të të dhënave të paraqitura si të dhëna zyrtare të Partisë Demokratike Gjykata ka vijuar me verifikimin e kryer nëpërmjet krahasimit të emrave dhe funksioneve të nënshkruesve të thirrjes së Kuvendit Kombëtar me listat e sipërcituara nga ku ka rezultuar se nënshkruesit e formularëve të kërkesave të thirrjes së Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021 janë anëtarë/delegatë të këtij organi, për shkak të funksionit që gjithsecili prej tyre mban. Pra nga ana e gjykatës është kryer verifikimi duke krahasuar formularët e nënshkruar me listën e prodhuar nga Dega 3 Tiranë nëpërmjet një sistemi, që nuk është e mundur të identifikohet, dhe listave të dërguara nga LDG dhe FRPD. Në këtë rast gjykata ka anashkaluar analizën e personave që kanë humbur mandatin e delegatit për shkak të humbjes së pozicionit ex officio prej të cilit e përfitonin këtë mandat. Vetëm nga një krahasim i thjeshtë i listës së bashkëlidhur shkresës së Degës 3 Tiranë me listën e Këshillit Kombëtar depozituar si prova 2 rezulton se një pjesë e mirë e të konsideruarve nga Gjykata si delegatë të Kuvendit e kanë humbur këtë cilësi për shkak të humbjes së pozicionit i cili u garantonte atyre ex officio të drejtat e delegatit në Kuvendin Kombëtar.
198. Në lidhje me detyrimin statutor për njoftimin e datës, vendit dhe rendit të ditës së Kuvendit të paktën një muaj përpara ditës së parë të punimeve të tij gjykata arsyeton se: *“Këto të dhëna, të cilat Statuti i PDSH, kërkon në mënyrë të detyrueshme që të komunikohen të paktën një muaj përpara ditës në të cilën thirret Kuvendi Kombëtar, u bënë të njohura për të gjithë publikun me mjetet e informimit publik, njoftime në televizione kombëtare, konferenca shtypi, portale e rrjete sociale menjëherë pas njoftimit drejtuar Kyetarit të Këshillit Kombëtar si më sipër, (Gjykata për këtë qëllim administroi dhe vlerësoi provat nr. 9, nr.10, nr.11 bashkangjitur kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022 )”*. Dëshirojmë të sjellim në vëmendje të trupit gjykues se provat 9, 10 dhe 11 të cituara nga gjykata si prova që mbështesin pretendimin për respektimin e afatit procedural 1 mujor janë emisione informative dhe publikime të datave 11 dhe 12 nëntor 2021. Nenit 43, pika 2 e Statutit për përcaktuar afatin për njoftimin e të dhënave të Kuvendit Kombëtar përdor togfjalëshin “të paktën një muaj përpara ditës së parë të Kuvendit”. Kodi i Procedurës Civile në nenin 148 të tij përcakton mënyrën e llogaritjes së afateve duke parashikuar se: *“Afati që është caktuar në javë, në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës që ka filluar afati”*. Në rastin objekt shqyrtimi duhet paraprakisht të saktësojmë se njoftimi për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar është një njoftim që i drejtohet të gjithë anëtarëve të tij e për pasojë ka kuptimin e një njoftimi publik. Ky njoftim duhet të shpallej publikisht nga një organ i ngarkuar ose i emëruar nga kërkuësit, ose një grup individësh të cilëve këto tagra i janë deleguar. Në rastin objekti shqyrtimi gjyqësor nuk kemi një grup nismëtar, i cili ka propozuar plotësimin e formularëve dhe as një grup përfaqësues i cili ka tagrin që në emër të organizatorëve të bëjë njoftimin për të gjithë delegatët e Kuvendit Kombëtar. Fakti që dokumenti formal, i publikuar mediatikisht nuk ka asnjë nënshkrim tregon që ky akt nuk është formuluar nga asnjë kërkuës. Në këtë këndvështrim duhet të zbatoheshin dispozitat statutorë lidhur me subjektet të cilave statuti u ngarkon detyrimin e njoftimit. Sipas procedurës së pretenduar nga kërkuësit, dhe e konsideruar edhe legjitime nga vetë gjykata në arsyetimin e saj për depozitimin e kërkesave tek Kryetari i Këshillit Kombëtar, ishte detyrë e

këtij të fundit që të bënte njoftimin publik për të gjithë delegatët, njoftim që nuk rezultoi të jetë bërë. Përpos sa arsyetuar më lartë duke marrë si të mirëqenë formën e njoftimit të bërë me datë 11 dhe 12 nëntor (sipas provave 9, 10 dhe 11 të relatuara nga Gjykata), rezultoi se afati “**të paktën një mujor**” i përcaktuar nga neni 43, pika 2 e statutit nuk është respektuar. Njoftimi është publikuar me datë 11.11.2021 duke bërë që afati i përcaktuar nga neni 43 të fillonte me datë 11 nëntor e të përfundonte me datë 11 dhjetor. Neni 43, pika 2 përcakton se afati i njoftimit duhet të përfundojë një ditë përpara ditës së fillimit të punimeve të Kuvendit Kombëtar. Nga sa analizuar më lartë rezultoi se nga njëra anë njoftimi nuk është bërë në formën e kërkuar dhe nga ana tjetër edhe njoftimi i pretenduar nuk respekton afati e detyrueshëm statutor. Në kuptim të vetë interpretimit të bërë nga gjykata mbi tre elementët e detyrueshëm të njoftimit mosplotësimi i njoftimit dhe respektimit të afatit të njoftimit përbëjnë shkaqe për pavlefshmërinë e thirrjes së mbledhjes së Kuvendit Kombëtar.

199. Në vijim gjykata ka arsyetuar mbi funksionin statutor të propozimit të anëtarëve të Komisionit të drejtimit të punimeve të Kuvendit. Gjykata raportoi se një grup deputetësh përfaqësues të anëtarëve kërkuar me datë 09.12.2021 i janë drejtuar Kryetarit të PDSH me kërkesën për ushtrimin e funksioneve statutorë dhe propozimin e anëtarëve të Komisionit Drejtues të Punimeve të Kuvendit. Gjykata arsyetoi se: *“Në kushtet e konstatimit të mosushtrimit të kësaj përgjegjësie statutorë nëpërmjet mungesës së një përgjigje shkresore si dhe të mospjesëmarrjes së Kryetarit të PDSH në mbledhjen e Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021, Kuvendi Kombëtar me propozim të Kryetarit të Këshillit Kombëtar të PDSH z. Edi Paloka, i cili çeli edhe Kuvendin, miratoi me votim të hapur dhe me shumicë votash, në prani të më shumë se gjysmës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve të tij një Komision të drejtimit të punimeve të tij të përbërë nga 5 anëtarë, si dhe një sekretariat teknik, sipas përbërjes së reflektuar në proces-verbalin e punimeve të Kuvendit Kombëtar dhe akteve të tjera të dala prej tij.”* Së pari gjykata nuk ka asnjë fakt provues që deputetët të cilët kanë nënshkruar kërkesën drejtuar Kryetarit të Partisë kanë tagra përfaqësimi për anëtarët kërkuar të mbledhjes së Kuvendit. Në dritën e akteve provuese të depozituara në gjykim e ritheksojmë se anëtarët kërkuar të mbledhjes së Kuvendit Kombëtar nuk kanë deleguar asnjë tagër përfaqësimi tek asnjë grup individësh qofshin këta edhe deputetë, për përfaqësimin e tyre në raport me organet drejtuese të Partisë Demokratike.
200. Është e vërtetë që më datën 09.12.2021, 10 anëtarë të Kuvendit Kombëtar, për shkak të cilësisë së tyre si deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, i kanë paraqitur Kryetarit të Partisë, njoftimin përkatës, të protokolluar me nr. 150 prot., datë 09.12.2021. Mirëpo, ndryshe nga sa shprehet gjykata, Kryetari i Partisë nuk ka qenë në kushtet e mosushtrimit të kësaj përgjegjësie statutorë nëpërmjet mungesës së një përgjigje shkresore. Me shkresën nr. 150/1 Prot., datë 09.12.2021, marrë në dorëzim nëpërmjet zyrës së protokollit nga z. Edi Paloka, në emër të njoftuesëve, Kryetari i Partisë, pasi ka konstatuar se 10 anëtarë të Kuvendit Kombëtar, nuk është numër i mjaftueshëm për thirrjen e Kuvendit Kombëtar, sepse nuk përbën  $\frac{1}{4}$  e numrit të anëtarëve të Kuvendit, Në këtë shkresë Kryetari i Partisë ka sqaruar sa më poshtë vijon: *“Në përgjigje të shkresës suaj të datës 09.12.2021, protokolluar pranë Partisë Demokratike të Shqipërisë me nr. 150 prot., datë 09.12.2021, ju bëjme me dije sa më poshtë vijon: Në Partinë Demokratike nuk ka asnjë kërkesë, njoftim apo dijeni për ndonjë mbledhje të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike, përveç mbledhjes së miratuar dhe njoftuar sipas vendimit nr. 139 Prot., datë 15.11.2021 të Kryesisë së Partisë, që ka vendosur: Thirrjen e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike, ditën e shtunë, më datë 18 Dhjetor 2021, ora 11:00, në Pallatin e Kongreseve, me rend dite: “I. Vendimmarrje mbi situatën politike, si dhe marrjen e masave për të mbrojtur interesin e Partisë Demokratike, duke mos lejuar që problemet apo interesat personale të secilit anëtar të dëmtojnë interesat elektorale dhe politike të PD, dhe axhendën*

e saj politike në përballjen me regjimin e Edi Ramës, II. Miratimin e Aksionit Politik për të ardhmen e Partisë Demokratike dhe shpalljen e Platformës Qytetare për Demokraci, për rikthimin e legjitimitetit dhe demokracisë në vend, si dhe ndërtimin e mekanizimit të bashkëpunimit me të gjitha forcat e shoqërisë në përballjen me regjimin e Edi Ramës, i cili në aleancë me krimin e organizuar dhe korrupsionin ka shkatërruar çdo mjet të funksionimit demokratik të shtetit shqiptar dhe po nxit braktisjen masive të vendit nga qytetarët dhe kryesisht të rinjtë, III. Miratimin e programit organizativ të Partisë Demokratike për të përgatitur strukturën e partisë për zgjedhjet e ardhshme, sipas objektivit "Partia Demokratike, partia e demokratëve dhe çdo shqiptari të ndershëm – Forca e vetme politike që do të sjellë ndryshimin në Shqipëri". Për dijeninë tuaj, lutem gjeni bashkëlidhur një kopje të vendimit nr. 139, datë 15.11.2021 të Kryesisë së Partisë. Strukturat përgjegjëse të Partisë Demokratike janë duke realizuar të gjithë procesin organizativ për mbledhjen e Kuvendit Kombëtar dhe çdo organ i partisë, sipas përgjegjësive është duke ushtruar detyrimet që i burojnë nga Statuti i Partisë dhe vendimi i Kryesisë së Partisë. Pavarësisht se kujtesa për ushtrimin e detyrimeve statutores të mbarëvajtjes së Kuvendit Kombëtar të PDSH del jashtë fushës së përgjegjësisë së një anëtarë të Kuvendit Kombëtar, qoftë edhe kur ky i fundit gëzon statusin e deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, ju sigurojë që në ushtrim të kompetencës së Kryetarit të Partisë, sanksionuar në nenin 43, pika 2 e Statutit, do të bëjë në fillim të mbledhjes së Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të datës 18 Dhjetor 2021, ora 11:00, sipas procedurës statutores, edhe propozimin për miratimin e anëtarëve të Komisionit për drejtimin e punimeve të Kuvendit."

201. Pra qartësisht, Kryetari i Partisë jo vetëm ka kthyer përgjigje, jo vetëm nuk ka shfaqur mungesë vullneti për të ushtruar kompetencat e tij statutores, por ka konfirmuar se nuk ka asnjë njoftim zyrtar, asnjë kërkesë të depozituar në Partinë Demokratike për thirrjen e Kuvendit Kombëtar, dhe se njoftimi i vetëm 10 anëtarëve të Kuvendit Kombëtar është i pamjaftueshëm në kuptim të kuorumit të kërkuar nga nenin 43 i Statutit të Partisë, duke konfirmuar se do të ushtrojë përgjegjësitë e tij statutores në mbledhjen e Kuvendit Kombëtar, për të cilin ka dijeni dhe që është njoftuar sipas rregullave të Statutit. Për pasojë, konstatimi i gjykatës, se propozimi nga Kryetari i Këshillit Kombëtar, në kundërshtim me nenin 43 të Statutit, është i pranueshëm, është i pambështetur në ligj dhe prova.
202. Gjykata nuk bën asnjë arsyetim lidhur me të drejtën e Kryetarit të Këshillit Kombëtar për paraqitjen e propozimeve në drejtim të Kuvendit Kombëtar. Risjellim në vëmendje të trupit gjykues përcaktimet e pikës 4 të nenit 43 të Statutit. Kjo pikë është shteruese përse i përket organeve apo trupave që mund të adresojnë me propozime Kuvendin Kombëtar. Sikurse arsyeton Gjykata në lidhje me rastet e zakonshme dhe të jashtëzakonshme, pika 4 e nenit 43 parashikon rastet e zakonshme të paraqitjes së propozimeve (Kryetari, Kryesia, Këshilli Kombëtar) dhe rastet e jashtëzakonshme, atë të paraqitjes së propozimeve nga 15% e anëtarësisë së Kuvendit me shpërndarje nga 5 degë të ndryshme territoriale. Në kuptim të parashikimeve të kësaj pike të nenit 43 asnjë entitet, qoftë ky edhe Kryetari i Këshillit Kombëtar, në cilësinë personale dhe jo bazuar në një vendim të Këshillit, nuk mund të paraqesë propozime përpara Kuvendit Kombëtar. Arsyetimi i Gjykatës, me të cilin ajo vlerëson si të ligjshme mënyrën e ngritjes së Komisionit të Drejtimin të Punimeve është në interpretim të gabuar të dispozitave statutores e për pasojë i gabuar.
203. Pavarësisht arsyetimit të gjykatës aktet provuese të depozituara në gjykim, provojnë që propozimi për caktimin e Komisionit Drejtues të Punimeve të Kuvendit nuk është zgjedhur apo caktuar në bazë të një propozimi të Kryetarit të Këshillit Kombëtar. Përkundrazi, në fjalën drejtuar delegatëve të Kuvendit rezultoi se propozimi i anëtarëve të Komisionit Drejtues të

Punimeve vjen nga një përfaqësuesit e delegatëve. Në fjalimin e tij Edi Paloka shprehet se: **01.30.50** – *“Tani me propozim të përfaqësuesve të delegatëve që kanë kërkuar thirrjen e këtij kuvendi po ju paraqes për miratim emrat e komisionit që do drejtojnë punimet e Kuvendit. Zonja Albana Voksi, Kryetar e Lidhjes Demokratike të Gruas. Z. Ervin Minarolli, Sekretar Organizativ i Partisë Demokratike. Z. Ivi Kaso, Sekretar Zgjedhor i Partisë Demokratike. Z. Edmond Spaho, ish nënkryetar i Partisë Demokratike dhe Z. Belind Këllici, Kryetar i Forumit Rinor të Partisë Demokratike, i cili do të jetë edhe drejtuesi i këtij komisioni. Ndërkohë për sekretariatën propozohen Znj Minushe Lazaj, Zonja Nada Daulija dhe Z. Ledio Nuraj. Ju ftoj t’i votojmë me ngritje dore, kush është pro, kundër nuk ka. Ftoj Komisionin dhe Sekretarinë që të zejë vend në podium”*. – **01.32.11**. Pra propozimi në rastin objekt shqyrtimi nuk vjen nga Kryetari i Partisë Demokratike, në zbatim të dispozitave statutore, nuk vjen as nga Kryetari i Këshillit Kombëtar, sikurse arsyeton gjykata, por nga një përfaqësi e papërcaktuar, e paspecifikuar apo e paidentifikuar, për të cilën nuk gjendet asnjë parashikim statutor.

204. Ndryshe nga sa arsyeton gjykata, nuk kemi një akt provues për çertifikimin e cilësisë së kërkuar dhe pjesmarrëve në Kuvendin Kombëtar. Nga analiza e provave të depozituara në gjykim rezulton se 4200 formularët e pretenduar janë depozituar në zyrën e Kryetarit të Këshillit Kombëtar Edi Paloka me datë 11.11.2021 duke i kufizuar këtij të fundit të drejtën e verifikimit të tyre në raport me listën e delegatëve të Këshillit Kombëtar. Ky verifikim pretendohet se është bërë me datë 11.12.2021 në ambientet e Air Albania, nga një trupë prej 72 personash të caktuar nga Komisioni Drejtues i Punimeve të Kuvendit Kombëtar. Ky fakt i pretenduar në Proces-verbalin e punimeve të Kuvendit nuk gjendet i reflektuar në pamjet filmike të depozituara në gjykim. Për pasojë vërtetësia e këtij pretendimi është e paprovueshme në gjykim. Nga ana tjetër kemi një konflikt të dhënash lidhur me numrin e formularëve. Me datë 11.11.2021 deklarohet nga Z. Edi Paloka se numri i formularëve të depozituar në zyrën e tij është 4200, ndonëse nuk ka një akt verifikimi nga ana e tij as në lidhje me numrin dhe as në lidhje me cilësinë. Me datë 11.12.2021 në Kuvendin Kombëtar shfaqet si numër i delegatëve që kanë nënshkruar formularët për mbledhjen e Kuvendit numri prej 4890 delegatësh (minuta 02.05.18 e materialit filmik), ndërkohë që me datë 23.03.2022 në Gjykatën e Rrethit Gjyqsor është dorëzuar në cilësinë e provës një numër prej 4552 formularësh. Në mungesë të çertifikimit nga një trupë e pavarur, apo e ngritur dhe formuar në përputhje me procedurat statutore, asnjë entitet, grupim apo organ nuk mund të certifikojë nëse formularët e pretenduar të paraqitur janë formularë të nënshkruar nga delegatë të Kuvendit apo janë në numrin e kërkuar për thirrjen e Kuvendit.
205. Pas arsyetimit në lidhje me kushtet formale dhe proceduriale të thirrjes dhe fillimit të punimeve të Kuvendit Gjykata arsyeton në lidhje me vendimmarrjet e Kuvendit Kombëtar të datës 11.12.2021. Në lidhje me vendimin numër 1 të Kuvendit Kombëtar gjykata relaton se: *“Rezulton nga proces-verbali i mbledhjes së punimeve të Kuvendit Kombëtar, nga materiali i plotë filmik i punimeve të Kuvendit, si dhe nga provat e tjera shkresore, veçanërisht ato të administruara së bashku me vendimin nr. 1 dt.11.12.2021 të Kuvendit Kombëtar, por edhe ato të provave nr. 2, nr.6 dhe nr.7 të bashkangjitura kërkesës së palës kërkuese të datës 23.03.2022 se Komisioni i drejtimit të punimeve të Kuvendit, administroi një kërkesë të paraqitur në përputhje me nenet 43, dhe 60 të Statutit të PDSH-së, si më poshtë: - Kërkesë dhe draft Statutin (ndryshime në Statut) e propozuar nga 1/3 e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të PDSH, (firmat mbështetëse të 138 anëtarëve të Këshillit Kombëtar sipas provave nr. 2 dhe nr.6) dhe të mbështetura nga 15% e anëtarësisë së Kuvendit Kombëtar (firmat sipas provave nr.7), i cili u regjistrua nga Komisioni me nr. 1, datë 11.12.2021 në proces-verbalin e punimeve të Kuvendit”*. Ky arsyetim i gjykatës anashkalon krejtësisht interpretimin e neneve



43 dhe 60 të Statutit të Partisë. Edhe njëherë është e nevojshme t'i rikthehemi parashikimeve statutores në lidhje organet që kanë të drejtën e paraqitjes së propozimeve në Kuvendin Kombëtar dhe të analizojmë provat mbi të cilat mbështetet arsyetimi i gjykatën në dritën e këtyre dispozitave. Rezulton se propozimi i është adresuar Kuvendit Kombëtar nga një numër prej 138 anëtarësh të Këshillit Kombëtar. Kjo trupë, në kuptim të përcaktimeve të pikës 4 të nenit 43 nuk ka të drejtën e paraqitjes së propozimeve përpara Kuvendit Kombëtar. Gjykata relaton provën 7 të paraqitur në gjykim duke e vlerësuar këtë provë si dokumenti me të cilin 1404 anëtarë të Kuvendit Kombëtar shprehin mbështetjen për propozimin e paraqitur për miratimin e ndryshimeve statutores. Prova në fjalë është vetëm një listë me emra mbiemra dhe nënshkrime të në një fletë në të cilën titulli është propozim për shkarkimin nga detyra të Kryetarit të PDSH Lulzim Basha. Nga ana formale prova është paraqitur në gjykatë në formën e dokumentit të njehsuar me origjinalin. Ndërkohë që vetë dokumenti nuk ka asnjë të dhënë për titullin, emrin apo cilësinë e nënshkruesve, në aktin noterial me të cilin është bërë njehsimi cilësohet se dokumenti është *“Formularët e nënshkruara nga 15% (pesëmbëdhjetë) e anëtarësisë së Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë, përkatësisht nga 1404 (njëmijë e katërqind e katër) anëtarë”*. Relatimi i provës nga gjykata (kur e relaton si prova 7) është bërë si një provë me të cilën nga ana e anëtarëve të Kuvendit është mbështetur propozimi për ndryshimin e statutit, ndonëse ndërmejt aktit shkresor dhe ndryshimeve statutores nuk gjendet asnjë pikë lidhëse. Nuk rezulton që nga ana e Gjykatës të jetë bërë një hetim lidhur me cilësinë e nënshkruesve si anëtarë të Kuvendit Kombëtar, fakt që nuk e ka ndalur Gjykatën që të pranojë se jo vetëm nënshkrimet janë të anëtarëve të Kuvendit Kombëtar por nga ana tjetër edhe faktin që kjo provë përfaqëson mbështetjen e anëtarëve të pretenduar për miratimin e vendimit për ndryshimet statutores.

206. Përveç vlerësimit të gabuar të provave të administruara gjykata në arsyetimin e saj nuk përfshin në interpretim nenin 60 të Statutit të PDSH. Pavarësisht kompetencave shumë të gjëra që statuti i njeh Kuvendit Kombëtar fryma e tij është ajo e ndarjes dhe kontrollit të pushteteve. Pikërisht në këtë këndvështrim vetë statuti, duke vlerësuar se ndryshimi i tij është një akt i jashtëzakonshëm, e ka kufizuar këtë mundësi duke vendosur kriteret për subjektet që mund të propozojnë ndryshimin e statutit dhe një procedurë specifike nëpërmjet të cilës fillimisht ndryshimet statutores hartohen e më pas paraqiten për vendimarrje. Neni 60 i Statutit përcakton se procedura për ndryshimin e statutit kalon detyrimisht nëpër një organ të titulluar Komisioni i Përhershëm i Statutit, i cili ka tagrin e përgatitjes së këtyre ndryshimeve që më pas mund t'i paraqiten për miratim Kuvendit Kombëtar. Në nenin 60 organet e partisë që mund të propozojnë ndryshime statutores kufizohen vetëm në dy, Kryesinë e Partisë dhe një të katërtën e anëtarëve të Këshillit Kombëtar. Nga interpretimi sistematik i pikës 4 të nenit 43 dhe të nenit 60 rezulton se procedura për paraqitjen e propozimeve për ndryshimin e statutit të Partisë Demokratike duhet të kalojë nëpër këto hallka procedurale a) propozimi për ndryshimin e statutit nga Kryesia ose një e katërta e Këshillit Kombëtar duhet t'i paraqitet Komisionit të Përhershëm të Statutit; b) Komisioni i Përhershëm i Statutit përgatit statutin e ndryshuar, duke bërë njëkohësisht reflektimin e propozimeve dhe interpretimin e tyre në raport me dispozitat aktuale statutores dhe frymën e Statutit në përgjithësi.; c) drafti i paraqitur nga Komisioni i cili reflekton ndryshimet e propozuara Statutores i paraqitet për vendim Kryesisë së Partisë ose Këshillit Kombëtar dhe d) Kryesia ose Këshilli Kombëtar me vendim i propozojnë Kuvendit Kombëtar miratimin e ndryshimeve statutores. Vetëm në kushtet e respektimit të kësaj procedure është e mundur që Kuvendi Kombëtar të miratojë një vendim për miratimin e ndryshimeve statutores. Për sa analizuar më lartë rezulton se vendimi numër 1 i Kuvendit Kombëtar është marrë në bazë të një propozimi të bërë nga një trupë që nuk përmbush kushtet e parashikuara në nenin 43 pika 4 dhe është bërë në kundërshtim me procedurën e parashikuar në nenin 60, e për rrjedhojë është i paligjshëm.

Me të drejtë Gjykata e Lartë e cila në vendimin e saj arsyeton se: “36. Duke iu rikthyer mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se, referuar natyrës së mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, si dhe përcaktimit të interesit të ligjshëm për t’ju drejtuar gjykatës dhe për të iniciuar këtë proces gjyqësor, me të drejtë Gjykata e Apelit ka arritur në konkluzionin se, palë e interesuar në këtë gjykim është personi juridik PDSH, i cili, tërheq të drejtat e ligjshme nga ky proces...” arrin në përfundimin se në çështjen objekt gjykimi ka vetëm një palë e cila është subjekti juridik PDSH dhe se konflikti gjyqësor është se cilët përfaqësues të subjektit juridik kanë tagrat e përfaqësimit të këtij të fundit në Gjykatë. Gjykata arsyeton se me miratimin e vendimit numër 1 Statuti, i miratuar me këtë vendim, ka hyrë në fuqi menjëherë. Më tej Gjykata ndalet në anën formale dhe procedurale të propozimeve dhe vendimeve 2-7 të marra nga Kuvendi Kombëtar duke konkluduar se propozimet janë bërë në zbatim të dispozitave të Statutit të ndryshuar dhe se vendimet janë marrë nga Kuvendi Kombëtar në përputhje me këto dispozita. Së pari duhet të theksojmë se përsa analizuam më lartë lidhur me vlefshmërinë e vendimit numër 1 të Kuvendit Kombëtar dhe mungesën e ligjshmërisë së tij, të gjitha vendimet e mëpasshme të cilat janë marrë bazuar në dispozitat e këtij Statuti të ndryshuar janë të paligjshme për shkak të paligjshmërisë së miratimit të vetë Statutit. Së dyti Gjykata nuk ndalon të analizojë se cila është rrjedhoja e miratimit të Statutit (duke marrë prezumuar të ligjshëm vendimin numër 1) në ngritjen dhe përbërjen e Kuvendit Kombëtar. Me hyrjen në fuqi të Statutit të ri neni 43 që rregullon përbërjen e Kuvendit Kombëtar ndryshohet duke marrë numërimin 42 me këtë përmbajtje; “Kuvendi është organi më i lartë vendimarrës i Partisë, që përbëhet nga 1100 (njëmijë e njëqind) anëtarë të cilët zgjidhen nga Kuvendet e degëve të PDSH sipas një numri të përcaktuar për çdo degë nga Kryesia e PDSH. Lista e kandidatëve për delegatë në Kuvendin Kombëtar e paraqet në Kuvendin e Degës nga Kryesia e saj. Janë delegatë të Kuvendit Kombëtar: a) Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Partisë Demokratike; b) Anëtarët e Kryesisë së Partisë Demokratike; c) Deputetët e Partisë Demokratike në Kuvendin e Shqipërisë; ç) Anëtarët e qeverisë që janë anëtarë të Partisë Demokratike; d) Kryetarët e Bashkive, Prefekti, Kryetari i Qarkut, anëtarë të PDSH-së; dh) Një numër përfaqësuesish të organizatave partnere në numër të barabartë jo më shumë se 10 (dhjetë) përqind e numrit të anëtarëve të tjerë të kuvendit;”. Në pjesën arsyetuese të vendimit të saj gjykata relacionon se numri i anëtarëve të Kuvendit Kombëtar sipas nenit 43 të Statutit është 7646 anëtarë (ndonëse gjykata nuk jep asnjë argument për nxjerrjen e kësaj shifre) dhe se pjesëmarrës në punime janë 4935 anëtarë. Gjithashtu Gjykata arsyeton se me marrjen e vendimit numër 1 për miratimin e ndryshimeve në Statut, ky i fundit hyn në fuqi menjëherë, shkak për të cilin edhe procedura propozuese për vendimet 2-7 është në zbatim të Statutit të ndryshuar. Nëse do të vlerësojmë si të drejtë arsyetimin e derikëtushëm të gjykatës rezulton që me ndryshimin e numrit të delegatëve (nga 7646 në 1100), ndryshimin e mënyrës së zgjedhjes së delegatëve (nga ex officio – në zgjedhje nga Kuvendet e Degëve) si dhe numri i përfaqësuesve të organizatave partnere (nga 5% në 10%) Kuvendi i mbledhur duhet të shpërndahej deri në mbledhjen e Kuvendit të ri sipas numrit dhe procedurave të parashikuara në nenin 42 të Statutit të ndryshuar. Në këto kushte me marrjen e vendimit numër 1 Kuvendi Kombëtar i datës 11 dhjetor nuk kishte më asnjë aftësi vendimarrëse e për pasojë të gjitha vendimet 2 – 7 të marra nga ky Kuvend janë të paligjshme e si të tilla nuk mund të pranohen për regjistrim në regjistrin e partive politike të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**X. SHKAQET E REKURSIT NDAJ VENDIMIT NR.723 DATË 11.06.2024 TË GJYKATËS SË APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM TIRANË**

207. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm në vendimin e saj me nr. 723 datë 11.06.2024 nuk ka pranuar ankimin e bërë nga ana e partisë Demokratike të Shqipërisë përfaqësuar nga Enkelejd Alibeaj i cili gëzonte të dyja cilësitë dhe si i "Autorizuar" dhe si Kryetar i Komanduar i PDSH-së e pranuar ky fakt dhe me anë të vendimit numër 27, datë 16.03.2023 i KAS është lënë në fuqi me vendimin numër 5, datë 27.03.2023 të Kolegjit Zgjedhor duke i dhënë formën e gjësë së gjykuar dhe për pasojë të detyrueshme për çdo Gjykatë.
208. Gjykata e Apelit e ka vlerësuar gabim detyrat e lëna në VGJL si dhe ka vlerësuar gabim pozitën proceduriale të ankuesit duke e konsideruar këtë të fundit palë ndërkohë që GjL në vendimin ne saj me nr. 786 datë 27.12.2023 referon se: "36. Duke iu rikthyer mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se, referuar natyrës së mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, si dhe përcaktimit të interesit të ligjshëm për t'ju drejtuar gjykatës dhe për të iniciuar këtë proces gjyqësor, me të drejtë Gjykata e Apelit ka arritur në konkluzionin se, palë e interesuar në këtë gjykim është personi juridik PDSH, i cili, tërheq të drejtat e ligjshme nga ky proces..." arrin në përfundimin se në çështjen objekt gjykimi ka vetëm një palë e cila është subjekti juridik PDSH dhe se konflikti gjyqësor është se cilët përfaqësues të subjektit juridik kanë tagrat e përfaqësimit të këtij të fundit në Gjykatë.
209. Në vendimin e Gjykatës së Apelit me Nr. 723 datë 11.06.2024 referohet se: "Në lidhje me ankimin e paraqitur nga përfaqësuesi me autorizim z. Enkelejd Alibeaj, Gjykata e Apelit vlerëson se përpara se të marrë në shqyrtim ligjshmërinë e vendimit të shkallës së parë, duhet të marrë në konsideratë çështjen e pramueshmërisë së ankimit, si parakusht procedural për të vënë në lëvizje gjykatën e apelit." Ky është një konkluzion që bie ndesh dhe me vetë udhëzimet dhe orientimet e lëna nga ana e Gjykatës së Lartë në vendimin nr.768 datë 27.12.2023 dhe më konkretisht në pikën 60 të tij i cili referon se: "...60. Kolegji vlerëson se, në arritjen e konkluzionit se kush është organi kompetent që përfaqëson në këtë rast PDSH, gjykata e apelit nuk duhet ta kufizonte dhe ngushtonte shqyrtimin gjyqësor, duke vlerësuar faktin nëse dorëheqja e kryetarit të PDSH z. Lulzim Basha është kryer në formën shkresore dhe a ka gjetur pasqyrim në regjistrin e partive politike. Për të pasur një gjykim të drejtë dhe të gjithëanshëm të çështjes, si dhe për të kuptuar drejtë natyrën e këtij gjykimi, Gjykata e Apelit duhet të merret në shqyrtim dhe të analizonte nga pikëpamja e ligjit dhe e faktit se, çfarë vlere provueshmërie dhe juridike kanë: (i) aktet e miratuara në Kuvendin Kombëtar të PDSH në datën 11.12.2021 në lidhje me organet drejtuese të PDSH, për të cilat kërkohet regjistrimi në regjistrin e partive politike; (ii) aktet e prodhuara nga organet zgjedhore KOZ dhe KAS për aq sa ato mund të konsiderohen se ndikojnë në mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi; si dhe (iii) vendimet e marra nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, i cili është gjykatë dhe vendimet e dhëna prej tij janë vendime gjyqësore të formës së prerë. Vetëm pasi të merren në analizë të gjitha faktet dhe provat e nevojshme të administruara në dosje, gjykata do të kishte mundësi për të konkluduar definitivisht se kush është organi që përfaqëson juridikisht tek të tretët PDSH-në, i cili është subjekti juridik që tërheq të drejtat në këtë gjykim..."
210. Siç shihet gjykata e Apelit nuk ka zbatuar udhëzimet dhe orinetimet e Gj.L e cila e ka urdhëruar këtë të fundit që të shqyrtonte në themel dhe të gjitha aktet e administruara në dosje dhe vetëm pasi të vlerësonte ata do të duhet të arrinte në konkluzionin definitivisht se kush është organi që përfaqëson juridikisht tek të tretët PDSH-në, i cili është subjekti juridik që tërheq të drejtat në këtë gjykim. Gjykata e Apelit dhe pse kishte në dispozicion vendimin e Gjykatës së Lartë me Nr.768 datë 27.12.2023, parashtrimet tona të cilat e analizonin dhe shtjellonin qartësisht konkluzionet e arritura në VGJL përsëri nuk e ka kuptuar ende çështje ligjore se për të cilën është ngritur ky shqyrtim ligjor. Gjykata e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nuk e kuptoi në asnjë moment që nuk kemi të bëjmë me dy palë por vetëm me një palë dhe ajo është

Partia Demokratike e Shqipërisë, gjithë hetimi gjyqësor do të duhet të kryhej vetëm me faktin për të përcaktuar qartë se cili ishte organi që e përfaqësonte këtë person juridik/parti politike në marrëdhënie me të tretët.

211. Gjykata e Apelit nuk ka marrë në shqyrtim faktet dhe provat të cilat ajo vetë i ka administruar dhe i ka vlerësuar duke i dhënë fuqi provuese dhe më konkretisht po i referohemi vendimit numër 27, datë 16.03.2023 i KAS është lënë në fuqi me vendimin numër 5, datë 27.03.2023 të Kolegjit Zgjedhor duke i dhënë formën e gjësë së gjykuar dhe për pasojë të detyrueshme për çdo Gjykatë. Në vendimin e saj gjykata e apelit shprehet se: “Gjykata e apelit çmon se ankimi i paraqitur nga përfaqësuesi me autorizim deputeti z. Enkelejd Alibeaj, kundër vendimit nr.3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nuk plotëson parakushtet formale të pranueshmërisë, sipas përcaktimeve të nenit 450, pika 1, shkronja “ç” të KPC. Nëse gjykata e Apelit i ka pranuar si prova dhe i ka administruar si prova në gjykim vendimin e KAS dhe të Kolegjit Zgjedhor ajo në asnjë rast nuk do të duhet t’i referohet z. Enkelejd Alibeaj si Kryetari i Komanduar i Partisë Demokratike të Shqipërisë që prej datës 21.03.2022 sipas vendimarrjes numër 27, datë 16.03.2023 i KAS është lënë në fuqi me vendimin numër 5, datë 27.03.2023 të Kolegjit Zgjedhor.
212. Gjykata e apelit në vendimin nr.723 datë 11.06.2024 arrin në konkluzionin e gabuar dhe në kundërshtim me urdhërimet e VGJ nr.768 datë 27.12.2023 kur referon se: *“Përsa më sipër, duhet të jesh palë në gjykim/ose shqyrtim kërkesë, i cili ka konkluduar me vendimarrje, për të patur mundësinë që të ushtrosh ankim ndaj një vendimi gjyqësor. Ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë mund të paraqesin vetëm palët ose pjesëmarrësit në proces, me çfarëdo cilësie tjetër procedurale. Palë mund të jenë persona fizikë të cilët përfaqësohen personalisht ose ata juridikë të cilët përfaqësohen nëpërmjet organeve të tyre legjitime dhe përfaqësuesve të tyre të autorizuar. Pala ankuese nuk ka legjitimitet substancial për paraqitjen e ankimit, përsa kohë që nuk ka qënë palë dhe nuk ka patur asnjë cilësi procedurale në këtë proces. Gjykata e apelit çmon se nuk mund të bëhet “ankim” nga një palë e cila nuk është “palë” në proces.”.* Fatkeqësisht rezulton se gjykata e apelit nuk ka lexuar dhe nuk është orinetuar nga VGL por është mjaftuar të lexojë parashtrimet e Komisionit të Rithemelimit. Nuk ka dy palë në gjykim por është vetëm një palë dhe është Partia Demokratike e Shqipërisë dhe këtë konkluzion të arritur në VGJL, gjykata e apelit e ka pasur të detyrueshëm për zbatuar. Në vendimin ne saj me nr. 786 datë 27.12.2023 referon se: “36. Duke iu rikthyer mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se, referuar natyrës së mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, si dhe përcaktimit të interesit të ligjshëm për t’ju drejtuar gjykatës dhe për të iniciuar këtë proces gjyqësor, me të drejtë Gjykata e Apelit ka arritur në konkluzionin se, palë e interesuar në këtë gjykim është personi juridik PDSH, i cili, tërheq të drejtat e ligjshme nga ky proces...” arrin në përfundimin se në çështjen objekt gjykimi ka vetëm një palë e cila është subjekti juridik PDSH dhe se konflikti gjyqësor është se cilët përfaqësues të subjektit juridik kanë tagrat e përfaqsimit të këtij të fundit në Gjykatë. Siç shihet gjykata e apelit nuk e ka kuptuar themelin e gjykimit kush ka qënë dhe nuk është orientuar as në hapsirë dhe as në kohë se kush duhet të ishin detyrat për tu zbatuar sipas orientimit të VGJL.
213. Gjithashtu gjykata e apelit referon në mënyrë të gabuar aktet dhe rrethanat kur referon se: *“Në rastin konkret, kërkesa është paraqitur nga Komisioni i Rithemelimit dhe gjykata është investuar në një gjykim gracios, por vendimi i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë është ankimuar në shkallë të dytë gjykimi, nga Kryetari i PDSH z.Lulzim Basha, përfaqësuar me autorizim nga deputeti z. Enkelejd Alibeaj.”.* Së pari kërkesa në gjykatë është paraqitur nga subjekti politik Partia Demokratike e Shqipërisë të cilën pretendonte se e përfaqësonte Komisioni i Rithemelimit dhe jo e kundërta. Komisioni i Rithemelimit ka pretenduar

përfaqësimin e personit juridik Partia Demokratike e Shqipërisë dhe nuk është ai që i është drejtuar gjykatës. Fakti i dytë i gënjeshtërt është fakti ku pretendohet që ky vendim është ankimuar nga kryetari i PDSH-së Lulzim Basha. Në asnjë dokumentacion kjo nuk provohet dhe nuk ka asnjë akt që të mbështesi këtë pretendim. Ankimi është firmosur nga Enkelejd Alibeaj si përfaqësues me autorizim i Partisë Demokratike të Shqipërisë si dhe në cilësinë e Kryetarit të Komanduar të PDSH-së që prej datës 21.03.2022 sipas vendimarrjes numër 27, datë 16.03.2023 i KAS është lënë në fuqi me vendimin numër 5, datë 27.03.2023 të Kolegjit Zgjedhor.

214. Në mënyrë të çuditshme dhe krejt joligjore dhe të pashpjegueshme, Gjykata e Apelit gënjen dhe nuk referon saktë faktet dhe provat e administruara në gjykim dhe të cilat ju referuan qartësisht gjatë gjykimit dhe ky fakt mund të provohet qartësisht në momentin e dëgjimit të audiove të seancës gjyqësore. Në faqen 28 të vendimit të gjykatës së apelit referohet se: “Gjykata e apelit konstaton se Kryetari i PDSH z.Lulzim Basha, i cili pretendon se mbart të drejtat për të përfaqësuar PDSH tek të tretët, nuk rezulton që të ketë bërë kërkesë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për tu futur në këtë proces gjyqësor në formën e personit të interesuar (neni 189 dhe 190 i KPC), apo ndërhyrësit kryesor apo dytësor (neni 192 dhe 196 i KPC). Nuk rezulton gjithashtu i provuar fakti, që gjykata e shkallës së parë të ketë thirrur kryesisht në gjykim z.Lulzim Basha në cilësinë e Kryetarit të PDSH sipas nenit 193 të KPC, si dhe ta ketë legjitimuar atë nga pikëpamja formale dhe procedurale si palë në gjykim, edhe pse ky i fundit, i ka drejtuar gjykatës kërkesë me shkrim për përjashtimin e gjyqtarit të çështjes në shkallë të parë, si dhe pushimin e gjykimit të kërkesës për regjistrimin e vendimeve të marra në Këshillin Kombëtar të PDSH në datën 11.12.2021.... Me shkresën Nr. 168/1 Prot., datë 22.12.2021, ish-Kryetari i PDSH Lulzim Basha, ka njoftuar zyrtarisht gjykatën, “se ky grupim personash që i janë drejtuar gjykatës nuk kanë asnjë tagër përfaqësimi si persona të autorizuar për të përfaqësuar PDSH-në dhe për të bërë kërkesa të tilla” ...Kërkesa për të marrë pjesë në proces duhet të kishite ndjekur rregullat procedurale për ndërhyrje në gjykim, me kërkesë të regjistruar në sekretarinë e gjykatës. Gjykata e apelit vlerëson se me të drejtë shkresa e sipërcituar nuk është marrë në konsideratë nga gjykata e shkallës së parë, duke mos qënë mjet procedural i parashikuar nga dispozitat Kodit të Procedurës Civile dhe duke mos përbërë një kërkesë në kuptim të ligjit, e cila duhet të shqyrtohej dhe t’i nënshtrohej vendimarrjes nga ana e gjykatës.” Gjykata është në kushtet e lajthimit dhe të keqdashjes pasi në disa raste nga ana jonë në gjykim është referuar fakti që në dosjen gjyqësore ndodhet shkresa e datës 24.03.2022 në të cilën nga ana e PDSH-së është bërë kërkesë specifike për të marrë pjesë në gjykim pasi kishim interesa të ligjshme. Këtë fakt e kemi përmendur dhe në paragrafin 11 dhe 120 të parashtrimeve të depozituara në gjykatën e apelit. Gjithsesi i kemi referuar përsëri në paragrafët më sipër dhe po i ripërsërisim përsëri në këtë paragraf dhe më konkretisht kemi referuar se: “Gjithashtu me datë 24.03.2023, pasi ishim njohur me vendimin e Gjykatës për caktimin e seancës gjyqësore të datës 25.03.2023 me shkresën numër 2245 prot (faqe 102 dhe 116 e dosjes gjyqësore) PDSH ka vënë në dijeni gjyqtarin Zhukri për mosregjistrimin e ndryshimeve staturore të datës 17.07.2021, si dhe me kërkesën për t’u thirrur si subjekt i interesuar në procesin gjyqësor (faqe 103 e dosjes gjyqësore). Subjekti PDSH nëpërmjet përfaqësuesit të tij ka kërkuar shprehimisht thirrjen në procesin gjyqësor për shkak të interesit të ligjshëm. Bashkëlidhur kësaj kërkesë është ankimi i depozituar ndaj vendimit për regjistrimin e ndryshimeve staturore të datës 17.07.2021 si dhe autorizimet përkatëse të nënshkruesit të kërkesës. Në faqen e dytë të shkresës subjekti PDSH arsyeton se: “Gjithashtu duke qënë se jemi palë që kemi interesa në shqyrtimin e kërkesës nga ana Juaj kërkojmë që të thërritemi në këtë proces si palë e tretë në këtë gjykim pasi tërheqim interesa të ligjshëm dhe kjo e fundit pretendohet se është bërë në emër të Partisë Demokratike”. Pra rezulton e provuar që jo vetëm në mënyrë të tërthortë por edhe në mënyrë të drejtpërdrejtë PDSH nga njëra anë ka vënë në dijeni Gjykatën për

ekzistencën e një interesi të ligjshëm në procesin që zhvillohej, por edhe ka kërkuar përfshirjen në këtë proces në formë të shkruar. Pretendimi për shprehjen e interesit të ligjshëm dhe detyrimin e gjykatës së shkallës së parë për pushimin e gjykimit dhe orientimin e palëve drejt një gjykimi në themel të çështjes është arsyetuar edhe nga Gjykata e Lartë në vendimin e saj ku në pikën 55 arsyetohet se: “55. Në rast se Gjykata e Apelit ka arritur në konkluzionin se në themel të këtij gjykimi, qëndron përcaktimi se kush është juridikisht organi ligjor që përfuqëson tek të tretët subjektin juridik PDSH, kjo gjykatë, duhet të kishte vendosur pushimin e gjykimit, duke orientuar palët që të zhvillojnë një gjykim themeli mes tyre (gjykim kontencioz)”. Ky interpretim i Gjykatës së Lartë lidhet me interpretimin e saj se në këtë gjykim ka vetëm një palë e cila është subjekti juridik Partia Demokratike e Shqipërisë dhe se thelbi i konfliktit gjyqësor është e drejta e përfaqësimit të këtij subjekti. Në këtë drejtim, ky konflikt nuk mund të zgjidhet në kushtet e një gjykimi gracioz, shkak për të cilin me të drejtë gjykata arsyetohet se gjykimi duhet të ishte pushuar dhe palët duhet të ishin orientuar kah një gjykim kontencioz të pretendimeve të tyre.”

215. Gjithashtu gjykata e apelit referon se: “Kërkesa për të marrë pjesë në proces duhet të kishte ndjekur rregullat procedurale për ndërhyrje në gjykim, me kërkesë të regjistruar në sekretarinë e gjykatës. Gjykata e apelit vlerëson se me të drejtë shkresa e sipërcituar nuk është marrë në konsideratë nga gjykata e shkallës së parë, duke mos qënë një procedurë parashikuar nga dispozitat Kodit të Procedurës Civile dhe duke mos përbërë një kërkesë në kuptim të ligjit, e cila duhet të shqyrtohej dhe t’i nënshtrohej vendimarrjes nga ana e gjykatës...Kërkesa e paraqitur në gjykatë, është në diskrecionin e palës që ka investuar gjykatën dhe në asnjë rast, gjykata nuk mund të ndryshojë vullnetin e palës që e ka investuar atë. Në rastin konkret nuk ka një vendim të posaçëm nga kjo gjykatë për pranimin ose jo të kërkesave të futjes ose jo të tyre si palë ndërgjyqësore në këtë proces, në mënyrë që më pas, sipas përcaktimeve procedurale mbi të drejtën e ankimit të parashikuara nga neni 194/2, të K.Pr.Civile të mund të ushtrohej e drejta e ankimit.”. Gjykata e apelit është përsëri në kushtet e lajthimit dhe të mos orientimit në kohë dhe në hapsirë pasi jo vetëm nuk ka vlerësuar të gjitha kërkesat që i janë drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë por ka bërë dhe interpretime të zgjeruara në lidhje me formën procedurale që do të duhet të ketë shkresa që do të duhet të paraqesi pala që të merret në konsideratë. Ky qëndrim i gjykatës së apelit bie ndesh dhe në kundërshtim të hapur me Vendimin Unifikues të Gjykatës së Lartë me Nr.3 datë 29.03. 2012 në të cilin shprehet se: “31. Në zgjidhjen e mosmarrëveshjes gjykata paraqitet në rolin e një arbitri asnjansës, i cili vlerëson në mënyrë të paanshme pretendimet e palëve dhe në fund i shpall ato të bazuara apo jo. Palët kanë të drejtë të parashitrojnë para gjykatës interpretimin apo përcaktimin e tyre për faktet dhe të drejtat që lidhen me zgjidhjen e çështjes, por gjykata në ushtrim të pavarësisë dhe paanshësisë së saj, i çmon vetë këto çështje, e nëse i gjen të bazuara pretendimet e palëve i pranon, në të kundërt i rrëzon. Parimi iura novit curia në këtë rast do të thotë se gjykata nuk i merr si të mirëqena shpjegimet e palëve në lidhje me zbatimin e ligjit për çështjen konkrete, por si njohëse e ligjit, e zgjidh vetë mosmarrëveshjen, sipas formimit dhe bindjes së saj të brendshme, të bazuar në kriteret që parashikon Kushtetuta, Kodi i Procedurës Civile dhe ligjet e veçanta. Po ashtu, gjykata nuk lidhet as me përcaktimin që palët mund t’i bëjnë fakteve të çështjes, ndonëse ka detyrimin, konform nenit 10 të K.Pr.Civile, që të mbështesë vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit. Gjykata vërtet e mbështet vendimin tek faktet e paraqitura gjatë gjykimit, por vlerësimin e tyre e bën në mënyrë të pavarur, d.m.th. nuk i merr të mirëqena përcaktimet e palëve, por pasi analizon provat e marra gjatë gjykimit e vlerëson vetë ekzistencën e fakteve me rëndësi për zgjidhjen e çështjes. Gjykata madje ka të drejtë që të ftojë palët për të dhënë shpjegime mbi faktet që ajo i vlerëson të nevojshme për zgjidhjen e mosmarrëveshjes (neni 9 i K.Pr.C.). Pra, gjykata nuk lidhet me përcaktimin që bëjnë palët në lidhje me faktet apo me ligjin që zbatohet për këto fakte.”. Në

rastin konkret jo vetëm që është kërkuar në vetë të parë me anë të shkresës me nr.2245 prot datë 24.03.2022 (faqe 102 dhe 116 e dosjes) që të thërritet PDSH-së si palë në proces po dhe nëse nuk do ishte kështu përsëri me të gjithë shkresat e tjera dhe veprimet e ndërmarra nga pala ankuese do të vërtetohej që pala ka bërë kërkesa në mënyrë të vazhdueshme për të marrë pjesë në këtë gjykim dhe se ka qënë shkelje procedurale nga ana e Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë që nuk ka vendosur thërritjen e palës në gjykim si palë që ka interes të ligjshëm. Fakti që kjo gjykatë nuk ka marrë një vendim të ndërmjetëm për pranimin ose rrëzimin e kërkesës tonë për të marrë pjesë si palë e interesuar në gjykim na legjitimonte të kryenim ankim ndaj çdo vendimarrje dhe nëse nuk do të kishim të bënim me PDSH-së si palë kërkuese.

216. Përsëri për të disat herë konstatojmë që gjykata nuk orientohet në kohë dhe në hapsirë dhe se nuk ka zbatuar udhëzimet e VGJL si dhe nuk e ka lëxuar atë por është mjaftuar vetëm me leximin e parashtrësive të Komisionit të Rithemelimit. Në vendimin e saj gjykata referon se: *“Gjykata e apelit vlerëson se pala që ka paraqitur ankimin nuk ka legjitimitet procedural por edhe substancial që të kundërshtojë një vendim gjyqësor me natyrë deklarative, i cili ka dalë nga një gjykim, në të cilin, nuk ka qënë palë pjesamarrëse në pozicionin e personit të tretë. Vendimi i marrë sipas një gjykimi gracioz, nuk mund të ankimohet në një shkallë më të lartë gjykimi, nga një palë, e cila nuk ka qënë e legjitimuar as nga pikëpamja formale dhe as nga pikëpamja procedurale si palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor të zhvilluar në shkallë të parë... Gjykata e apelit çmon se në rast se ndonjë subjekt i tretë pretendon se cenohet nga regjistrimi i këtyre akteve për ndryshimet statutoare, ka detyrimin që të paraqesë padi themeli, në mënyrë që gjykata të vlerësojë themelin e mosmarrëveshjes dhe të përcaktojë në mënyrë përfundimtare se kush është subjekti që mbart të drejtën dhe kush ka tagrat e përfaqësimit ligjor të personit juridik ndaj të tretëve, si dhe të fshijë regjistrimet e kryera me nënvizim.”*. Gjykata e Apelit nuk e ka kuptuar në asnjë çast që nuk kishim disa palë në gjykim po kishim vetëm një palë dhe këtë konkluzion ja ka arritur Gjykata e Lartë në vendimin nr.768 datë 27.12.2023 në të cilin shprehet se: *“36. Duke iu rikthyer mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, Kolegji konstaton se, referuar natyrës së mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi, si dhe përcaktimit të interesit të ligjshëm për t’ju drejtuar gjykatës dhe për të iniciuar këtë proces gjyqësor, me të drejtë Gjykata e Apelit ka arritur në konkluzionin se, palë e interesuar në këtë gjykim është personi juridik PDSH, i cili, tërheq të drejtat e ligjshme nga ky proces...”* arrin në përfundimin se në çështjen objekt gjykimi ka vetëm një palë e cila është subjekti juridik PDSH dhe se konflikti gjyqësor është se cilët përfaqësues të subjektit juridik kanë tagrat e përfaqësimit të këtij të fundit në Gjykatë.” Për të disatën herë po referojmë që gjykata e apelit është konfunduar duke na cilësuar palë tjetër ndërkohë që në gjykim dhe në ankim është vetëm një palë dhe më konkretisht Partia Demokratike e Shqipërisë.

217. Në faqen 30 të vendimit nr.723 datë 11.06.2024 gjykata e Apelit referon se: *“Gjykata analizon elementët formal të ankimit, gjykata konstaton se ankimi është nënshkruar nga z.Enkelejd Alibeaj, në cilësinë e përfaqësuesit me autorizim të kryetarit të Partisë Demokratike të Shqipërisë. Autorizimi/Akti i Përfaqësimit i datës 15.09.2021, lëshuar nga Kryetari i PDSH-së për zotën Alibeaj, i ka dhënë këtij të fundit tagra të përgjithshme përfaqësimi të subjektit politik PDSH në të gjitha proceset gjyqësore. Ankimi kundër vendimit nr.3, datë 25.03.2023 është nënshkruar nga z.Enkelejd Alibeaj, si përfaqësues me autorizim i kryetarit të PDSH-së. Bashkëngjitur ankimit është dhe autorizimi i datës 15.09.2021 i lëshuar nga z.Lulzim Basha. Gjykata e apelit vlerëson se autorizimi i datës 15.09.2021, nuk ka pasur efekte juridike pas datës 21.03.2022, kur z.Lulzim Basha ka hequr dorë publikisht nga funksioni i kryetarit të PDSH-së. Në këto kushte përfaqësuesi i tij, z.Enkelejd Alibeaj, nuk ka patur tagrin për të hartuar e nënshkruar ankimin e datës 04.04.2022 për këtë çështje.”*. Me këtë qëndrim gjykata e apelit jo vetëm ka zhbërë Kodin Civil por dhe nuk e ka kuptuar sa ç’ka dashur të thotë në

arsyetimin e saj. Konstatimi i një fakti të tillë nga ana e kësaj gjykate ka ç' bërë mbi 30 vite praktikë gjyqësore si dhe dispozita të Kodit Civil dhe më konkretisht në paragrafin 79 të parashtrimeve tona në apel refrojmë se: "Neni 76 – Mbarimi i prokurës – Prokura mbaron kur: a) përfaqësuesi ka kryer veprimet juridike për të cilat ajo ishte dhënë; b) është plotësuar afati për të cilin ajo ishte dhënë; c) kur ka vdekur përfaqësuesi apo i përfaqësuari, ose kur njeri prej tyre ka humbur zotësinë për të vepruar; ç) ka mbaruar personi juridik përfaqësues apo i përfaqësuar; d) kur i përfaqësuari ka shfuqizuar prokurën ose përfaqësuesi ka hequr dorë prej saj. Pas mbarimit të prokurës përfaqësuesi, me kërkesën e të përfaqësuarit duhet t'i kthejë atij aktin e prokurës". Në rastin objekt shqyrtimi nuk jemi në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 76 i Kodit Civil. Veprimet që janë kryer dhe vazhdojnë të kryhen në përmbushje të tagrave të autorizimit jo vetëm nuk kanë përfunduar, por sikurse me të drejtë konstaton edhe KAS dhe Kolegji, kanë vazhduar të kryhen para dhe pas datës së depozitimit të ankimit në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë. Autorizimi i dhënë nga Kryetari i Partisë Lulzim Basha nuk ka një afat kohor dhe si tillë vijon të jetë i vlefshëm për sa kohë nuk është revokuar nga Kryetari i Partisë. Në kuptim të gërms (c) nuk rezulton që subjekti juridik Partia Demokratike e Shqipërisë (në cilësinë e të përfaqësuarit) të ketë pushuar së ekzistuari apo të ketë humbur zotësinë për të vepruar, fakt i cili rezulton i njëjtë edhe për përfaqësuesin. Vijimësia e ekzistencës juridike të personit juridik Partia Demokratike e Shqipërisë përjashton edhe mundësinë zbatimit të gërmës (ç) të nenit 76. Gërma (d) e nenit 76 parashikon mundësinë e përfundimit të prokurës (autorizimit) në rastin e shfuqizimit të prokurës apo të heqjes dorë prej saj. Autorizimi i datës 15.09.2021 i lëshuar nga Kryetari i Partisë Demokratike është një autorizim që ka për objekt të tij jo përfaqësimin e shtetasit Lulzim Basha në cilësinë e Kryetarit të Partisë Demokratike, por përfaqësimin e subjektit juridik Partia Demokratike e Shqipërisë si i tillë. Në këtë këndvështrim ky autorizim nuk lidhet me fatin apo me ushtrimin e detyrës nga shtetasi Lulzim Basha por me ushtrimin e të drejtës së përfaqësimit të subjektit juridik. Për të qënë në rastin e parashikuar nga gërma (d) e nenit 76 do të duhet të që autorizimi të shfuqizohej me akt të shkruar nga organi që tagrin e përfaqësimit të subjektit juridik ndaj të tretëve. Rasti i parashikuar në gërmën (d) është ai i revokimit/shfuqizimit të prokurës (autorizimit) akt i cili bëhet në mënyrë aktive dhe në formë të shkruar, për të tretët. Për sa kohë nuk ka një akt të shkruar me të cilin është revokuar autorizimi i datës 15.09.2021 ky i fundit vijon të prodhojë efekte juridike. Rezultoni se edhe përfaqësuesi i subjektit juridik Partia Demokratike e Shqipërisë nuk ka hequr dorë nga tagrat e dhëna me autorizimin e datës 15.09.2021, përkundrazi në vijimësi ka ushtruar këto tagra, fakt i konfirmuar ky edhe nga vendimi numër 27, datë 16.03.2023 i KAS dhe vendimi numër 5, datë 27.03.2023 i Kolegjit Zgjedhor.". Në rast se gjykata e apelit do të kishte pasur pak kohë të lexonte dhe parashtrimet tona në apel do t'i krijohej mundësia të lexonte dhe këto dispozita të Kodit Civil dhe nuk do të arrinte në marrëzira të tilla të shkruara në arsyetimin e vendimit.

218. Më e rëndë është situata në paragrafin vazhdues të arsyetimit të gjykatës në të cilën referon se: " Gjykata e apelit vlerëson se pavarësisht se dorëheqja e kryetarit të PDSH z. Lulzim Basha nuk është kryer në formën shkresore dhe as ka gjetur pasqyrim në regjistrin e partive politike, është një fakt i njohur botërisht dhe i pranuar dhe nga organe të tjera administrative dhe gjyqësore vendimarrëse në procesin zgjedhor. Sipas vendimit nr.27, datë 16.03.2023 të KAS të lënë në fuqi me vendimin nr.5 datë 27.03.2023 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, PDSH është përfaqësuar në zgjedhjet vendore të vitit 2023 me nën/kryetar z.Enkelejd Alibeaj, për shkak se është pranuar që kryetari z.Lulëzim Basha ka dhënë dorëheqje në datë 21.03.2022. Nga këto akte provuese, provohet se z.Lulëzim Basha nuk ka qënë organi që përfaqëson juridikisht tek të tretët PDSH-në, në momentin e rregjistrimit të ankimit 04.04.2022, pasi është njohur dorëheqja e tij në datë 21.03.2022." Sumë mirë që kjo gjykatë ka arritur në këtë konkluzion por pyetja që lind është: Kush është personi që u legjitimua si Kryetar i Komanduar i PDSH-së me anë të vendimit nr.27, datë 16.03.2023 të KAS të lënë në fuqi me vendimin nr.5



datë 27.03.2023 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor??? Mos është gjë ENKELEJD ALIBEAJ, i njëjti Enkelejd Alibeaj që ka firmosur ankimin??? Në këtë arsyetim gjykata e apelit kaloi nga faza e mosorientimit në kohë dhe në hapsirë në orientimin rreth orbitës së Komisionit të Rithemelimit duke mos analizuar as provat që administroi vetë.

219. Interesant është dhe argumenti tjetër i gjykatës së apelit e cila shprehet se: *“Me dorëheqjen publike të z.Lulzim Basha në datën 21.03.2022 autorizimi i lëshuar nga ky i fundit për z.Alibeaj ka mbaruar juridikisht dhe nuk ka qënë më i aftë të prodhojë asnjë pasojë juridike. Autorizimi i z.Lulzim Basha i datës 15.09.2021 nuk kishte më vlerë juridike pas datës 21.03.2022, pas dorëheqjes së tij publike. Gjykata e apelit vlerëson se z. Alibeaj nuk ka pasur legjitimitim procedural në përfaqësimin e ankuesit PDSH në gjykim dhe në paraqitjen dhe nënshkrimin e aktit “Ankim”. Në kushtet kur përfaqësuesi me autorizim z.Enkelejd Alibeaj, ka bërë ankim kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë pas mbarimit të efekteve juridike të autorizimit, ankimi/apeli i paraqitur nga ky përfaqësues konsiderohet si ankim i bërë nga një person që nuk legjitimohet, si përfaqësues pa tagra.”* Në këto momente situata bëhet tragjike pasi gjykata e apelit humbet në hapësirë dhe nuk asnjë fuqi gravitacionale që ta lidhë me ndonjë nga dispozitat e ligjit apo me provat e administruara. Po ja marrim të mirëqenë faktin që Z.Lulzim Basha ka dhënë dorëheqjen si Kryetar i PDSH-së, dhe për një moment po ja marrim përsëri të mirëqenë që Autorizimi i datës 15.09.2021 ka humbur fuqinë ligjore dhe vlerën juridike që kishte. Po me anë të vendimit nr.27, datë 16.03.2023 të KAS të lënë në fuqi me vendimin nr.5 datë 27.03.2023 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor që referon vetë kjo gjykatë a është zgjedhur Enkelejd Alibeaj si Kryetar i Komanduar i PDSH-së??? A i ka Z. Enkelejd Alibeaj tagrat për ta përfaqësuar partinë me të tretët që prej datës 21.03.2022, siç e pranon dhe vendimi nr.27, datë 16.03.2023 i KAS i lënë në fuqi me vendimin nr.5 datë 27.03.2023 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor??? Si ka mundësi vendimi nr.27, datë 16.03.2023 i KAS të lënë në fuqi me vendimin nr.5 datë 27.03.2023 të Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor është vlerësuar nga kjo gjykatë e apelit vetëm për të vërtetuar faktin e dorëheqjes së Z.Lulzim Basha dhe nuk është vlerësuar në lidhje me faktin që ka pranuar ligjërisht që prej datës 21.03.2022 Kryetar i Komanduar ka qënë Enkelejd Alibeaj. Gjithashtu kjo gjykatë e pranon dhe vetë kur referon që PDSH-në në zgjedhje e drejtoi dhe e përfaqësoi Enkelejd Alibeaj si Kryetar i Komanduar i PDSH-së. Konkluzionet e arritura nga ana e gjykatës së apelit janë dramatike në cilësinë e arsytimit dhe bien ndesh me vetë konkluzionet e mëparshme të nxjerra prej tyre si dhe krijojnë konfuzion duke treguar që nuk e kanë kuptuar qartë objektin e konfliktit gjyqësor dhe udhëzimet dhe orientimet e pasqyruara në VGJL.

220. Një arsyetim krejt origjinal dhe folklorik i ka bërë gjykata e apelit detyrës së lënë nga GJL në vendimin nr.768 datë 27.12.2023 me anë të cilit kërkonte që të vlerësonte dhe legjitimitetin e palë kërkuese dhe më saktësisht Komisioni i Rithemelimit si përfaqësues i PDSH-së. Në vendimin e saj gjykata e apelit shprehet se: *“Përsa i përket legjitimitit procedural të palës kërkuese, Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, si përfaqësues i PDSH-së. Në nenin 442/b KPC është parashikuar kuptimi i rekursit dhe në këtë nen thuhet: “Rekursi është akti me të cilin palët ose pjesëmarrësit e tjerë në proces parashitrojnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ose të gjykatës së apelit në Gjykatën e Lartë, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod”. Gjykata e apelit vlerëson se në kushtet kur Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim rekursin e Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit duke u shprehur për plotësimin e kushteve formale për paraqitjen e rekursit sipas nenit 474, 475 e 476 të K.Pr.Civile si dhe ekzistencën e shkaqeve ligjore për rekurs sipas nenit 472 të K.Pr.Civile, ka legjitimuar Komisionin e Përkohshëm të Rithemelimit si organ përfaqësues të subjektit juridik PDSH, duke i njohur në këtë mënyrë të drejtën që t’i drejtohet gjykatës së shkallës së parë me kërkesë për rregjistrimin e ndryshimeve statutore, dhe në varësi të vendimarrjes së gjykatave më të ulëta të ushtrij mjetet e ankimit, sikurse rekursi në rastin konkret. Pra kërkesa është paraqitur nga*

një subjekt i cili gëzon legjitimitet procedural për paraqitjen e kërkesës, si kusht i domosdoshme për të ushtruar të drejtat procedurale në të gjitha shkallët e sistemit gjyqësor.” Mundimi i gjykatës së apelit për të arritur në këtë konkluzion kalon vetëm imagjinetën e Komisionit të Rithemelimit. Në VGJL me nr.768 datë 27.12.2023 në paragrafin 60 dhe 61 të tij referohet qartësisht se: “...60. Kolegji vlerëson se, në arritjen e konkluzionit se kush është organi kompetent që përfaqëson në këtë rast PDSH, gjykata e apelit nuk duhet ta kufizonte dhe ngushtonte shqyrtimin gjyqësor, duke vlerësuar faktin nëse dorëheqja e kryetarit të PDSH z. Lulzim Basha është kryer në formën shkresore dhe a ka gjetur pasqyrim në regjistrin e partive politike. Për të pasur një gjykim të drejtë dhe të gjithëanshëm të çështjes, si dhe për të kuptuar drejtë natyrën e këtij gjykimi, Gjykata e Apelit duhet të merrte në shqyrtim dhe të analizonte nga pikëpamja e ligjit dhe e faktit se, çfarë vlere provueshmërie dhe juridike kanë: (i) aktet e miratuara në Kuvendin Kombëtar të PDSH në datën 11.12.2021 në lidhje me organet drejtuese të PDSH, për të cilat kërkohet regjistrimi në regjistrin e partive politike; (ii) aktet e prodhuara nga organet zgjedhore KOZ dhe KAS për aq sa ato mund të konsiderohen se ndikojnë në mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi; si dhe (iii) vendimet e marra nga Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, i cili është gjykatë dhe vendimet e dhëna prej tij janë vendime gjyqësore të formës së prerë. Vetëm pasi të merren në analizë të gjitha faktet dhe provat e nevojshme të administruara në dosje, gjykata do të kishte mundësi për të konkluduar definitivisht se kush është organi që përfaqëson juridikisht tek të tretët PDSH-në, i cili është subjekti juridik që tërheq të drejtat në këtë gjykim...” “61. Në këtë mënyrë, pavarësisht nga sa është arsyetuar edhe më sipër në këtë vendim në lidhje me zbatimin e rregullave proceduralë të gjykimit, Kolegji vlerëson se Gjykata e Apelit, nuk do ti jepte zgjidhje vetëm faktit nëse ankimi që e ka investuar atë në shkallë të dytë gjykimi plotëson parakushtet formale të pranueshmërisë apo jo, por do ti jepte zgjidhje edhe vetë themelit të kërimit, pra nëse kërkesa e paraqitur për regjistrimin e vendimeve të dala nga Kuvendi Kombëtar i PDSH, është paraqitur nga organi që ka cilësinë për të vepruar dhe për të përfaqësuar PDSH me të tretët (pra, pala kërkuese gëzon ose jo legjitimitet procedural për paraqitjen e kërkesës).” . Cilën nga këto detyra dhe udhëzime ka zbatuar gjykata e apelit gjatë rigjykimit??? Gjykata e apelit ka dhënë një argument ekstra ligjor për të justifikuar mungesën e legjitimitetit të përfaqësuesit dhe më saktësisht të Komisionit të Rithemelimit për të përfaqësuar PDSH-në. Argumenti që e ka legjitimuar GJL është i paligjshëm dhe i pavërtetë. Gjykata e Lartë e ka legjitimuar si palë në proces pasi ka qenë kjo palë që e ka investuar, ndërsa faktin nëse a legjitimohet ky përfaqësues për të përfaqësuar PDSH-në ja ka lënë detyrë qartësisht gjykatës së apelit si një nga detyrat që ajo do të duhet të zbatonte në rigjykim. Gjykata e Lartë nuk ka vlerësuar asnjë nga aktet e ngritjes së Komisionit të rithemelimit ndaj ja ka lënë detyrë gjykatës së apelit që të bënte një hetim të plotë dhe të gjithëanshëm të këtyre akteve por siç rezulton nuk ka asnjë hetim të kryer nga kjo gjykatë e cila ka refuzuar të zbatojë udhëzimet dhe orientimet e gjykatës së lartë në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në nenin 486 dhe 493 të Kodit të Procedurës Civile.

## XI. PEZULLIMI I EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT NR.723 DATË 11.06.2024 TË GJYKATËS SË APELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM.

221. Në zbatim të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile ne do të kërkojmë që ky vendim i marrë nga ana e gjykatës së apelit të pezullohet në dhënien e efekteve në zbatim të dispozitave ligjore dhe më konkretisht: “1. Gjykata e Lartë, pasi është paraqitur rekursi, me kërkesë të palës, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit kur: a) ekzekutimi i menjëhershëm i vendimit do të sillte pasoja të rënda e të pariparueshme; dhe/ose b) pala që ka bërë rekursin depoziton garanci materiale që siguron ekzekutimin vendimit.”. Siç është në dijeni kjo gjykatë Komisioni i Rithemelimit është një organ kolegjal dhe i përkohshëm dhe si i tillë do të

detyrohet që në një kohë të afërt t'i drejtohen Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për regjistrimin e statuteve të reja si dhe të organeve të reja të dala nga procese zgjedhore që nuk kanë qenë të mbikëqyruara nga organet partiake. Gjithashtu duke qenë se në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka një sërë kërkesash që janë në shqyrtim ku një prej tyre është e pezulluar dhe po gjykohet nga ana e gjyqtarit Niko Rapi si dhe faktit që kërkesa të tjera janë në gjykim në Gjykatën e Apelit Tiranë do të bënte të pavlefshëm çdo vendimarrje të këtyre gjykatave nëse nuk do të kishim një masë pezullimi nga ana e Gjykatës së Lartë. Duke pasur në konsideratë gjithashtu që nëse do të kishim dhe ndryshime të tjera përveç këtyre që janë pasqyruar nga vendimi i gjykatës së apelit do të detyronte palët që të shkonin me padi themeli për fshirjen e regjistrimeve të mëvonshme. Ndaj për të ndaluar regjistrime të tjera të cilat do të komplikonin situatën ligjore të PDSH-së dhe nuk do të mund të zgjidheshin ligjërisht në një kohë të shkurtër nga ana e gjyqësore kërkojmë nga kjo gjykatë që të pezullojë efektet deri në marrjen e një vendimi përfundimtar i cili në të gjitha rastet do të kërkojë një kohë prej 30 ditësh.

222. Nga vendimarrja e pezullimit nuk do të cënohej as Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit i cili do të vazhdonte të ushtronte të gjitha tagrat e tij si përfaqësuar i PDSH-së sipas vendimarrjes së gjykatës së shkallës së parë dhe as të apelit dhe rrjedhimisht nuk do të cënohej asnjë e drejtë e palëve. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit nuk sjell efekte për vendimarrjet e regjistruara tani më në regjistrin e partive politike por do të ndihmonte gjykatën e lartë që në marrjen e vendimit të saj mos të shprehej në lidhje me të tjera që nuk janë pjesë e këtij gjykimi të cilat mund të sjellin efekte nëse nuk do të ketë një vendim pezullimi të ekzekutimit të vendimit. Nëse kjo gjykatë nuk do të marrë masë për pezullimin e ekzekutimit të vendimit dhe nëse e pranon këtë rekurs do të duhet të shprehet në bazë të nenit 485/a të Kodit të Procedurës Civile dhe më konkretisht: *“ Kur vendimi i ri, që jepet pas prishjes, është i ndryshëm nga vendimi i parë, i cili është ekzekutuar, tërësisht ose pjesërisht, personi që ka përfutuar detyrohet t'i kthejë të gjitha përfitimet e marra nga ekzekutimi i vendimit.”*

## XII. KONKLUZIONE

Rezultoni që në këtë rekurs janë shkaqe nga ato të parashikuara nga pika a), b) dhe c) të pikës I të nenit 472 dhe më konkretisht:

- a) për zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, të një rëndësie themelore për njehsimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;
- b) kur vendimi i ankimuar është i ndryshëm nga praktika gjyqësore e Kolegjit Civil ose praktika e njehsuar e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
- c) ka shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurës së gjykimit, sipas nenit 467 të këtij Kodi

223. Gjykata e apelit ka gabuar gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor ku nuk ka vlerësuar në mënyrë të detajuar argumentat e paraqitura gjatë parashtrimeve në apel dhe nuk i ka vlerësuar si prova në rigjykim. Gjykata e Apelit ka vlerësuar gabim vlerën procedurale të kërkesave të depozituara si dhe të dispozitave të nenit 450 të Kodit të Procedurës Civile duke vlerësuar gabim faktin që kemi të bëjmë me palë ku qartësisht në gjykim kemi të bëjmë me vetëm një palë por ka qenë detyrë e saj të identifikonte se kush kishte tagra përfaqësimi.

224. Gjykata e apelit ka dhënë një interpretim të pa mbështetur në asnjë dispozitë ligjore në lidhje me mënyrën e përfundimit të tagrave të autorizimit duke mos u mbështetur në asnjë pikë të nenit 76 të Kodit Civil. Gjykata e apelit ka vlerësuar në mënyrë të gabuar dispozitat

proceduriale që kanë të bëjnë me ndërhyrjen si palë e interesuar në gjykim duke mos pasur në konsideratë përcaktimet e vendimit unifikues nr.3 datë 29.03.2012 të Gjykatës së Lartë.

225. Vendimi i ankimuar është i ndryshëm me praktikën gjyqësore pasi vendimarrja e vetë gjykatës së apelit si gjykatë rigjyqëse është e ndryshme nga ajo që ka kërkuar Gjykata e Lartë në vendimin me nr.768 datë 27.12.2023 duke mos zbatuar udhëzimet dhe orientimet e saj të cilat do të duhet të ishin zbatuar nga gjykata e apelit gjatë rigjyimit në zbatim të nenit 486 dhe 493 të Kodit të Procedurës Civile.
226. Gjykata e apelit nuk ka vlerësuar provat dhe nuk i ka marrë në shqyrtim ato, ka vlerësuar në mënyrë të gabuar rrethana dhe fakte si dhe ka marrë pjesërisht provat duke cunguar konkluzionin e arritur prej tyre. Duke qenë në këto kushte ne vlerësojmë që Gjykata e Lartë do të duhet ta shqyrtojë këtë çështje në seancë gjyqësore pasi gjykata e apelit dështoi të zbatonte detyrat, udhëzimet dhe orientimet e saj.
227. Ne mendojmë që kjo çështje mund të shërbejë dhe si nevojë për njësimin e praktikave të ngjashme në zbatim të pikës 1 të nenit 481 të Kodit të Procedurës Civile. Njësimi i praktikës do t'i shënbente dhe rasteve të ngjashme në trajtimin e tyre nga Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për rastet e OJF-ve apo dhe të subjekteve të tjera politike. Nëse kjo kërkesë nuk do të merret në konsideratë ne do të vlerësojmë që trupa gjyqësore të vlerësojë që ta kalojë në seancë gjyqësore këtë çështje pasi në vlerësimin tonë i plotëson të 2 kriteret e përcaktuara në pikën 1 të nenit 482/a të Kodit të Procedurës Civile dhe më konkretisht: *“a) çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; b) vlerësohet e nevojshme nga Kolegji Civil thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, sipas shkronjave “b” dhe “c” të nenit 472, si dhe paragrafit të dytë të nenit 473/a të këtij Kodi.”*. Siç referuam dhe më sipër kjo çështje ka rëndësi nga pikëpamja e njësimin dhe zhvillimit të praktikës gjyqësore si dhe siç dhe duket nga provat dhe kompleksiteti do të ishte shumë më e lehtë për gjykatën në arritjen e një konkluzioni të qartë e të plotë që kjo çështje të shqyrtohet në prezencën e palëve.
228. Gjithashtu rrethana dhe fakte të tjera që do të kërkonim që Gjykata e Lartë të kishte në konsideratë janë dhe konkluzionet si më poshtë:
- Rezulton e provuar që ankimi i paraqitur nga Nënkyetari i Partisë Demokratike të Shqipërisë Enkelejd Alibeaj i plotëson parakushtet formale për tu pranuar si një mjet ligjor si përfaqësues i subjektit Partia Demokratike e Shqipërisë.
  - Tagrat e përfaqësimit të Nënkyetarit Enkelejd Alibeaj nuk kanë mbaruar në asnjë moment në kuptim të nenit 76 të Kodit të Procedurës Civile.
  - Rezulton e pranuar gjyqësisht si në gjykimin në Apel dhe në Gjykatë të Lartë që kemi të bëjmë me një palë dhe konkretisht Partia Demokratike e Shqipërisë.
  - Rezulton e provuar gjyqësisht që tagrat e përfaqësimit të PDSH-së i kanë pasur Lulzim Basha dhe Enkelejd Alibeja në vijimësi dhe se KPR nuk ka pasur në asnjë moment të vetëm tagra për përfaqësimin e PDSH-së.
  - Rezulton e provuar që as në Statutin e PDSH-së të vitit 2018 të regjistruar në 13.07.2021 dhe në Statutin e PDSH të miratuar në 17.07.2021 dhe të pa pasqyruar në regjistrin e partive politike në momentin e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë nuk ka asnjë organ të emërtuar Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit.
  - Rezulton e provuar që mbledhja e “Kuvendit të PDSH-së” të datës 11.12.2021 është bërë në kundërshtim të hapur me dispozitat e Statutit të regjistruar të Partisë

Demokratike të Shqipërisë dhe më konkretisht atij të vitit 2018 dhe të regjistruar në 13.07.2021.

- Gjykata ka legjitimuar kërkuesin përpara se të vendoste për ligjshmërinë e mbledhjes së Kuvendit Kombëtar, Kuvend në të cilin është krijuar kërkuesi si organ statutor i ngritur në kundërshtim me dispozitat e të gjithë akteve staturore në diskutim në këto diskutime.
- Gjykata ka vepruar në kundërshtim të hapur me nenin 392 të Kodit të Procedurës Civile, ndonëse kishte dijeni për ekzistencën e interesit të ligjshëm të një pale tjetër në gjykimin për vërtetimin e faktit juridik.
- Përfaqësuesi i kërkuesit është legjitimuar në gjykim në kundërshtim me dispozitat e nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile.
- Akti i përfaqësimit të përfaqësuesit të KPR është lëshuar në kundërshtim me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka gjykuar pa pasur të administruar dhe pa u njohur me dosjen e regjistrimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë.
- Formularët mbi të cilët pretendohet së është bërë thirrja e Kuvendit Kombëtar, në momentin e nënshkrimit të tyre nuk kishin në brendësi të tyre datën dhe orën e thirrjes së Kuvendit Kombëtar: se këto të dhëna janë vendosur në një moment të mëpasshëm kohor në mënyrë mekanike të njëjtë për të gjithë formularët. Ky fakt çënon plotësimin e kushtit të vullnetit të kërkuesve për datën e thirrjes së Kuvendit Kombëtar.
- Nuk ka një organ administrues të procedurës së mbledhjes së formularëve, të hartimit të listës së përgjithshme të delegatëve, të lëshimit të mandateve të Kuvendit Kombëtar apo të drejtimit të fillimit të punimeve të tij.
- Propozimet që i janë adresuar Kuvendit Kombëtar janë në kundërshtim me dispozitat staturore që rregullojnë ndryshimet e statutit.
- Me miratimin e ndryshimeve staturore, pjesa e mbetur e vendimeve të marra nga Kuvendi Kombëtar nuk ishin më kompetencë e tij. Kuvendi i mbledhur duhet të shpërndahej e të mblidhej Kuvendi i ri sipas parashikimeve të Statutit të miratuar.
- Komisioni i Rithemelimit nuk ka tagra përfaqësimi në Gjykatë e për pasojë gjykata duhet të pushonte çështjen objekt gjykimi për mungesë legjitimiteti të kërkuesit.
- Komisioni i Rithemelimit i është drejtuar gjykatës si përfaqësues pa pasur tagra përfaqësimi pasi venimi nr.6 datë 11.12.2021 është ratifikuar në datën 19.12.2021 ndërsa kërkesa drejtuar gjykatës ka qënë në datën 15.12.2021.
- Gjykata nuk ka analizuar provat nga ana e formës dhe përmbajtjes dhe relaton në vendim fakte të cilat nuk përputhen me provat që i janë nënshtruar gjykimin apo fakte të cilave nuk u gjendet burimi i marrjes dijeni nga gjykata.

229. Për sa më sipër kërkojmë pranimin e ankimit sipas objektit duke vendosur:

- Pezullimin e ekzekutimit të vendimit numër 3, datë 23.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Prishjen e vendimit numër 3, datë 23.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë,
- Prishjen e vendimit numër 723, datë 11.06.2024 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë
- Pushimin e gjykimin.

Av. Indrit Sefa

Përfaqësues

Av. Rezart Kthupi